



Hëna e Re

Viti XXXIII | Nr.349 | Tetor 2020 | Safar - Rabi'ul-Awwal 1442 | Çmimi 50 den



Pjesë nga shtëpia e Pejgamberit (a. s.), sipas ekspozitës së hapur më 19 shkurt 2014 në Jeddah, Arabi Saudite.

PËR BFI-në, ME TALAT XHAFERIN

Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 20 tetor, 2020, vizitoi Kuvendin e RMV dhe aty u takua me Kryetarin Talat Xhaferi, në zyrën e tij në Parlamentin.

Fillimisht, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e uroi Kryeparlamentarin z. Xhaferi për mandatin e tij të dytë në udhëheqjen me pushtetit legjislativ në vend dhe i dëshiroi shëndet dhe punë të mbarë në mandatin e ardhshëm katërvjeçar.

Të dy palët biseduan rreth çështjeve që kanë të bëjnë me Bashkësinë Fetare Islame dhe me kërkesat aktuale që i ka institucioni fetar islam në vend, me qëllim të azhurnimit dhe çuarjes drejt realizimit të tyre. Temat më të rëndësishme të diskutimit ishin çështja e denacionalizimit dhe ajo e institucioneve fetare arsimore,



siç janë Medreseja Isa Beu dhe Fakulteti i Shkencave Islame.

Kreu i BFI, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu,

në një takim në rrjetet sociale këtë takim e vlerësoi “mjaf konstruktiv, për të mirën e të gjithëve”.

REISI NË DETYRË TAKOHET ME KRYEMINISTRIN ZAEV

Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 9 tetor, 2020, u takua me Kryetarin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Zoran Zaev, dhe me Zëvendëskryeminstriin e parë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, z. Artan Grubi. Në këtë takim Kreun e BFI e shoqëronte h. Muhamer ef. Veseli, Drejtor i Agjencisë për Hallall-Certifikata në kuadër të Ba-

shkësisë Fetare Islame.

Në takimin dhe pritjen mjaft optimiste mes Kryetarit të BFI dhe Kryeministrit Zaev dhe Zv/kryeministrit Grubi, për të cilin u konstatua se është mjaft konstruktiv dhe shpresëdhënës, u bisedua rreth denacionalizimit të pronave të Bashkësisë Fetare Islame, akreditimit të Medresesë Isa Beu dhe shumë çështje të tjera të cilat e tangojnë Bashkësinë Fetare Islame dhe të gjithë myslimanët e Maqe-

donisë së Veriut.

Dialogu, mbi të gjitha, është e vetmja rrugë e cila mund të çojë përpara të gjitha proceset e nisura dhe të bëhet afrues mes palëve, të cilat kanë pikësynim të përbashkët në ngritjen e vlerave të drejta, demokratike dhe evropiane – u tha me këtë rast.

Ky takim – ka shkruar në faqen e vet në Facebook Shaqir ef. Fetahu të njëjtën ditë - na bëri përshtypje të një takimi serioz, të sinqertë dhe shpresëdhënës.

XHEPÇISHT: ZVICERANI KALON NË ISLAM

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin...” (El-En’am: 125)

Kështu fillon komunikata publike e Xhamisë së Xhepçishtit (Tetovë) në Facebook, e cila bën të ditur se Nancho Motzer, nga qyteti i Winterthur-it, Kantoni Zurich, i lindur më 31.10.1989, me profesion: producent filmi, ka kaluar në Islam dhe tash e tutje do të quhet Muhamed.

Më 16 tetor, 2020 (e xhuma), në ambientet e Xhamisë së Xhepçishtit z. Nancho (Muhamedi), 31- vjeçar nga Zvicra, para nëpunësve fetarë dhe xhematit deklaroi pranimin e fesë islame. Në rrëfimin e tij potencoi edhe shkaqet e pranimit të Islamit, ku mes tjerash ishte udhëzimi i Allahut fuqplotë, por edhe shoqërimi me disa besimtarë të rinj, në mesin e të cilëve edhe Fitim Rustemi nga Xhepçishti, me punë të përkohshme në Zvicër.

Për mirënjohje ndaj Fitimit, z. Nancho (Muhamedi) kishte vendosur që dëshminë e kalimit në fenë islame ta bëjë në xhaminë e fshatit të tij – thuhet në njoftim.

Kjo ngjarje ishte një gëzim i madh për nëpunësit fetarë dhe



gjithë xhematin. Rasti i z. Nancho (Muhamedi) dëshmon ndikimin e një myslimani shembullor në prezantimin e drejtë dhe të duhur të Islamit para tjerëve.

Në shenjë kujtimi, nga Imami i Xhamisë, Amir ef. Ameti, në emër të Këshillit të Xhamisë Muhamedi iu dhurua Kurani famë-lartë – thuhet në komunikatën publike të Xhamisë së Xhepçishtit.

Burimi: <https://www.facebook.com/xhamiaxhepcisht>

EDITORIAL

MUHAMEDI (A. S.), VLERË UNIVERSALE

Në natën e dymbëdhjetë të muajit hixhrij Rebiul Evvel, që sivjet përkoi në mes të natës së njëzetetë dhe njëzetentë të muajt tetor të këtij viti, myslimanët anembanë botës përkujtuam lindjen e të dërguarit të Allahut (xh. sh.), Muhamedit (a. s.), lindje kjo e cila në jetë solli njeriun të cilin Krijuesi i Gjithësisë e zgjodhi për të Dërguar të Tij, me mision të qartë për njerëzimin.

Andaj, kjo nuk është një lindje e një njeriu të rëndomtë, por kjo, në fakt, është lindje e një epoke të re, lindje së cilës iu gëzua gjithë çka ka në tokë dhe në qiell, lindje e cila shkëlqeu mbi errësirën e injorancës shekullore, lindje të cilën e ndoqën shumë ngjarje që lanë gjurmë në historinë njerëzimit, lindje e cila në këtë botë solli njeriun që përgjithmonë mbetet vlerë dhe shëmbëlltje universale.

Pra, kjo lindje solli në jetë njeriun i cili, si i dërguar i Krijuesit të Gjithësisë, praktikisht bëri të qartë kufirin mes së mirës dhe së keqes, mes dritës dhe errësirës, mes dijes dhe injorancës, mes moralit dhe amoralit... Ai për një kohë të shkurtër i zhdukua padrejtësitë shoqërore; në radhë të parë, ato që i bëheshin gjinisë femërore, padrejtësi e cila i privonte femrat nga të gjitha sferat e jetës; madje, ato varroseshin për së gjalli, vetëm e vetëm pse i takonin gjinisë femërore. Po ashtu, i zhdukua edhe padrejtësitë që bëheshin në baza racore dhe sociale dhe në mesin e shoqërisë e ktheu dinjitetin e çdo njeriu, pavarësisht përkatësisë gjinore, etnike dhe ngjyrës së lëkurës.

Kjo lindje në jetë e solli Muhamedin (a. s.), personalitetin e të cilit e gjejmë në një harmoni të përsosur midis materies dhe shpirtit, respektivisht midis trupit dhe shpirtit, aftësisë dhe diturisë, dëshirës dhe mundësisë, sjelljeve dhe etikës njerëzore. Në këtë ekuilibër qëndrojnë karakteristikat themelore të vetes, të misionit dhe të praktikës së Muhamedit (a. s.), që sot është model dhe shëmbëlltje për tërë botën, gjë që neve myslimanëve na bën krenarë. Ndërkaq, injorantët në personalitetin e tij shohin shëmtimin e vetvetes, gjë e cila i nxit ata që ta shajnë!

Me rastin e lindjes së tij, ne i përkujtojmë porositë dhe mësimet e tij të shumta dhe kuptimplote, me vlera shumë dimensionale dhe universale, të cilat nuk mbyllen në vetvete - as në kohë, as në hapësirë. Duhet theksuar se për porositë dhe mësimet e këtij Mësuesi të Madh nuk kanë nevojë vetëm myslimanët, por i tërë njerëzimi, sepse: duke e ndjekur rrugën e tij, do të krijojmë një shoqëri të shëndoshë, pa anomalitete e sëmundje të llojeve të ndryshme, të cila pa mëshirë i kanë kapluar shoqëritë tona të ashtuquajtura shoqëri moderne.

Sot me thëniet dhe mësimet e tij, që kanë të bëjnë me sfera të ndryshme të jetës dhe të shkencës, krijojnë shumë elaborate shkencore, të cilat vijnë në përfundim se Muhamedi (a. s.) e ka folur të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Ky fakt shpeshherë bëhet shkak që shumë shkencëtarë jomyslimanë të konvertohen në fenë islame.

Gëzuar, o Pejgamber!

Te personaliteti i Muhamedit (a. s.) gjejmë një harmoni të përsosur midis materies dhe shpirtit, respektivisht midis trupit dhe shpirtit, aftësisë dhe diturisë, dëshirës dhe mundësisë, sjelljeve dhe etikës njerëzore. Në këtë ekuilibër qëndrojnë karakteristikat themelore të vetes, të misionit dhe të praktikës së Muhamedit (a. s.), që sot është model dhe shëmbëlltje për tërë botën, gjë që neve myslimanëve na bën krenarë. Ndërkaq, injorantët në personalitetin e tij shohin shëmtimin e vetvetes, gjë e cila i nxit ata që ta shajnë!

Q. Osmani



PËRMBAJTJA




9-10

DITA MË E MIRË E JAVËS: ELHAMDULILAH

ËSHTË SHEKULLI 21 SHEKULLI I RELIGJIONEVE?

14



22-23

LINDJA E MUHAMEDIT (A. S.) - MEVLUDI

RAPORT NGA TERRENI: MYFTINIA E SHIPTIP

28



35-41

RINIA, BEGATIA MË E ÇMUESHME E NJË POPULLI

PLAGËT TONA DHE SHËRIMI I TYRE

59-62



5	KREU I BFI-SË HAP VITIN AKADEMIK NË FSHI
6	PO VIJNË HAFËZLLARËT...
11	NIS NËDËRTIMI I VAKËFIT NË STRUGË
12	NGUSHËLIME TE FAMILJA BIZATI NË LADORISHT
12	NGUSHËLIME TE FAMILJA ADEMI
13	SHAQIR EF. FETAHU, ANËTAR I KËSHILLIT BOTËROR TË KOMUNITETEVE MYSLIMANE
13	TAKIM FETAHU-GRUBI
13	KREU I BFI NDOQI PREZANTIMIN E KOMISIONERIT EVROPIAN
15	MACRON SHPALL PLANIN PËR TË LUFTUAR 'SEPARATIZMIN ISLAMIK'
15	TIMONIE TAKON MYFTI NESIMIN
16	HUMANITARIA FRANCEZE E KTHYER NGA MALI DEKLARON KALIMIN NË ISLAM
16	BIK, DEKLARATË PËR OPINION
18	TURQIA PËRGJIGJET ME SHKRIM
19	NJË TENTATIVË POPULISTE PËR TË FITUAR ZGJEDHJET
19	SHABAN MURATI: NJË SHPIQJE E PRESIDENTIT MAKRON
20	HYJNIA E SHPIRTIT TË SHENJTË
23	MYFTINIA E SHKUPIT SJELL MEVLUDIN NË GJUHËN SHOQPE
23	HATME NË NEGOTINË
24	NDIHMJA E ALLAHUT (XH. SH.) KËRKOHEM QË TË MBROHEMI NGA DJALLI
26	PA IDEOLOGJI DOGMATIKE
31	"TIKA" VIZITON BFI-NË
32	MYFTINIA E SHKUPIT: "GARA KURANORE 2020"

32	PËR ZBATIMIN ZYRTAR TË GJUHËS SHOQPE NË RMV
33	BANESAT E "IBNI PAJKOS" I KA SHITUR SHTETI PA PËLQIMIN E BFI-SË!
33	ZV/MINISTRI I KULTURËS NË BFI
34	NË FORUMIN NËDËRKOMBËTAR BOSHNJAK
34	KËNAQ BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E FINANCAVE
34	PËRVJETORI I SHOQATËS "SOS VITA"
34	GESAB NË SHKUP
39	POPULLSIA MYSLIMANE SOT DHE NESËR
41	SI POPULLI, ASHTU EDHE HOXHA
42	XHAHILIJETI SHPËRFAQ LARGIMIN NGA ALLAHU
44	BOTË MË E MIRË BËHET ME NJË NJERI MË TË MIRË
46	KUR SHEJTANI E ZGJIDH GOMARIN...
47	SI U SHËMB XHAMIA E ÇARSHISË NË TETOVË
49	BASHKË PËR GJUHËN E ZEMRËS
50	KOHA E VLERAVE TË MIRËFILLTA
51	MES PROFANES DHE INFRASTRUKTURËS SAKRALE
52	MESAZHE NGA HIRA
53	LUMTURIA NË VEPRAT E TË URTËVE
54	DOBITË E MËSIMIT TË KURANIT
55	POPULLI SHQIPTAR I KOSOVËS NË SHPIRT E KA BESIMIN NË ZOT
57	FITRA DËSHMUESE E FUQIZON NJOHJEN E REALITETIT
63	"MUHAXHIRËT, DOSJA BRITANIKE" NGA BEJTULLA DESTANI

KREU I BFI-SË HAP VITIN AKADEMIK NË FSHI

Më 1 tetor, 2020, në ambientet e Fakultetit të Shkencave Islame, në presencën e stafit akademik të këtij fakulteti, Dekanin **prof. dr. Shaban ef. Sulejmani**, studentëve aktualë dhe të rinj të këtij fakulteti, Zëvendësministrit të Arsimit dhe të Shkencës **prof. dr. Arafat Shabani**, Drejtorit të Institutit për Trashëgimi Kulturor Shqiptarë **dr. Skender Hasani** dhe të punonjësit të tij **prof. dr. Zeqirija Ibrahim**, Drejtorit të Medresesë Isa Beu **prof. Ibrahim ef. Idrizi**, Shefit të Kabinetit të Rejisit **dr. Selver ef. Xhemaili**, si dhe mysafirëve të tjerë, Kryetari në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, shpalli të hapur vitin akademik 2020/2021 në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

"Më lejoni që në këtë ditë solemne t'ju përsënder me përsënderjeten islame: **Esselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu - Paqja, mëshira dhe begatitë e të Madhit Zot qofshin mbi të gjithë ju.** Kjo ditë, që po e përjetojmë tani, në këtë organizim tejet të bukur, është një ditë e madhe për të gjithë ne, e në veçanti për studentët dhe studentet e këtij fakulteti. Ky solemnitë ka domethënien formale: e para që del në shesh është serioziteti i stafit akademik, në krye me Dekanin, për punën që i pret në të ardhmen, studentët dhe studentet e këtij fakulteti. Në këtë vit akademik janë regjistruar një numër i konsiderueshëm i studentëve dhe kjo dëshmon se ky fakultet vazhdon të mbajë standardin sipas nevojave të vendit. E treta, që është shumë



me rëndësi, jep përkrahjen, jep inspirimin e stafit akademik, pa marrë parasysh situatën në të cilën po rrezikohemi nga sëmundja Covid-19, stafi akademik është i paluhatshëm që ta vazhdojë punën në nivelin më të lartë si deri më tani, pa marrë parasysh pengesat me të cilat ballafaqohen institucionet e ndryshme, pra edhe institucioni FSHI."

Më tej ai tha: "Më kujtohen ditët e para kur, unë dhe prof. Muhamed Mustafa, ishim anëtarë të Këshillit Themelitar të FSHI, e besoni se na duhej të gjenim pesë tituj (shkencorë). Ishte shumë vështirë, sepse nuk i kishim. Sot, falë Zotit, jemi krenarë dhe të lumtur që ky fakultet i shkencave islame i ka të gjithë titujt me përvojë të jashtëzakonshme, me aftësi të jashtëzakonshme dhe stu-

dentët vërtet duhet të jenë krenarë që janë pjesë e këtij fakulteti dhe që do të ndjekin procesin e mësimdhënies pikërisht në këtë fakultet. Ky fakultet vepron dhe është aktiv gati në tërë botën. Në Evropë - po se po. Në të gjitha shtetet evropiane studentët e FSHI, në mënyrën më të bukur, në mënyrën më të mirë shpjegojnë fjalën e Kuranit dhe prezantojnë Islamin në nivele ndërkombëtare. Të prezantosh sot Islamin në Evropë, nuk është punë e lehtë. Evropa është vend i kulminacionit shkencor, vend i kulminacionit ekonomik, është vend i kulminacionit kulturor, vend ku takohen kultura e besime të ndryshme. Një ndër to që ka pozicionin e vet dhe që është aktual në botën moderne është edhe Islami. Prandaj, ky fakultet sot është ai që përmes kuadrove që ka nxjerrë, sot e prezanton Islamin në nivele ndërkombëtare, botërore dhe atë në mënyrën më të lartë. Sot studentët e FSHI në mënyrën më të mirë e shpjegojnë dhe prezantojnë Islamin, duke filluar nga prezantimi shkencor, prezantimi i tolerancës, i paqes, i solidaritetit, i humanitetit, i afrit ndaj njerëzve, i shërbimit ndaj njeriut, që të gjitha këto janë synimet kryesore të Islamit dhe sot Islamin e bëjnë të jetë pjesë e Evropës dhe e botës në përgjithësi. Të jeni të bindur se ky fakultet është shumë i madh dhe me këtë duhet të na rritet edhe serioziteti, edhe puna", tha mes tjerash Kreu në detyrë i BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

URIM ME RASTIN E VITIT TË RI SHKOLLOR

"Sot filloi viti i ri shkollor. Dija është vlera më e lartë e njeriut, andaj edhe gëzimi është i madh për të gjithë fëmijët, prindërit, arsimtarët dhe të gjithë ne. Me gjithë vështirësitë e fillimit nga sëmundja Covid-19, shpreh urimet e sinqerta për një proces edukativo-arsimor të mirëfilltë, duke u munduar që edhe në këto kushte të jepet maksimumi i të gjithë faktorëve që sadopak të arrihet ajo që mund të arrihet. Qoftë bekimi i Zotit mbi të gjithë ju" - thuhet në urimin e Kryetarit në detyrë të BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (1.10.2020)



PO VIJNË HAFËZLLARËT...

ARBESA ALITI, HAFËZE NGA SLLUPÇANI

Më 4 tetor, 2020, në fshatin Sllupçan, komuna e Likovës (Kumanovë), është promovuar hafizja e re **Arbesa Aliti** nga i njëjti fshat. Provimin e hifzit ajo e ka dhënë para Komisionit profesional të Myftinisë së Kumanovës, të përbërë nga: **hfz. Bajram ef. Ajeti** (kryetar); **hfz. Ibrahim ef. Ilazi** (anëtar); **hfz. Shaqir Memedi** (anëtar).

Kanë qenë të pranishëm: Kreu në detyrë i BFI, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, Myftiu i Kumanovës **h. Abedin ef. Imeri**, Myftiu i Tetovës **prof. dr. Qani ef. Nesimi**, Myftiu i Strugës **mr. Salim ef. Sulejmani**, Myftiu i Shtipit **mr. Nasir ef. Rexhepi**, Sekretari i Përgjithshëm i BFI **Irsal ef. Jakupi**, Shefi i Kabinetit të Reisit **dr. Selver ef. Xhemaili**, bashkë me drejtorët e sektorëve të BFI, profesorë të Medresesë Isa Beu dhe të Fakultetit të Shkencave Islame, pastaj Kryetari i Komunës së Likovës **z. Erkan Arifi**, ulematë islame dhe shumë besimtarë e

besimtare.

Të dhënat për hafizen e re i prezantoi Kryetari i Komisionit të Hifzit, **Bajram ef. Ajeti**, i cili punën e hafëzes së re e vlerësoi me notë të shkëlqyer. Pastaj me fjalë përshëndetëse u paraqit Myftiu i Kumanovës, i cili u dëshiroi mirëseardhje mysafirëve dhe gjithë të pranishmëve, në mënyrë të veçantë përshëndeti Reis'ul-Ulema **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, ndërsa hafëzes së re i dëshiroi shëndet dhe suksese në jetë.

“Më lejoni që përzemërsisht t’ju përshëndes me përshëndetjen islame: **Esselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu – Paqja, mëshira dhe begatitë e të Madhit Zot qofshin mbi të gjithë ju**. Vëllezër e miq të dashur, Kurani është muxhize, është mrekulli. Muxhize (El-Muxhize) do të thotë ‘vepër që nuk është në aftësitë dhe mundësitë e njeriut’. Pra, është vepër mbinatyrore e Allahut fuqiptotë, si argument për pejgamberinë e njeriut më të dashur në historinë e njerëzimit - Muhamedit (a. s.). Kurani është muxhize, mrekulli mbinatyrore, nga dy

segmente: segmenti i parë është përmbajtja e Kuranit famëlartë. Mund të zhvillohet mendimi njerëzor, të gjitha shkencat, deri në Ditën e Kiametit, ndërsa Kurani për nga përmbajtja mbetet si një oqean që gjithmonë jep e nuk shteret. Pa marrë parasysh ngritjet e zhvillimit njerëzor. Këtë sot e vërteton shkencë moderne. Segmenti i dytë, që e vërteton se është mrekulli, muxhize, është vetë renditja e germave, forma e tij, ajetet dhe krejt komplet Kurani famëlartë. Për nga forma është muxhize. Se vërtet është muxhize, mrekulli mbinatyrore, sot është argument hafëzja e re Arbese, e cila ka arritur ta mësojë krejt Kurandin për mendsh. Vetë fakti se Kurani arrihet të futet në memorien e njeriut, tregon se është muxhize, vepër e Allahut fuqiptotë” – ka thënë Kryetari i BFI, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**.

Duanë e Hifzit e ka bërë Myftiu i Tetovës. Kryetari i BFI-së dhe Myftiu i Kumanovës bënë dorëzimin e diplomës. Myftiu i Kumanovës hafëzes i dhuroi disa libra dhe një shumë simbolike të hol-

lash. Dhuratë simbolike në të holla ajo pati edhe nga Rijaseti i BFI të RMV.

HAFËZE SARA ALITI, NGA DOBROSHTI

Më 14 tetor, 2020, në Dobrosht të Tetovës, Xhamia e Epërme, u organizua manifestimi: Dua hifzi për hafëzen e re **Sara Emin Aliti**. Hafëzja është e lindur më 5.07.1998 në fshatin Dobrosht të Tetovës, hifzin tek muhafizi **Mahmud ef. Asllani** e ka filluar më 6.08.2017, kurse e ka përfunduar më 31.03.2020. Provimin e hifzit e ka mbrojtur para komisionit profesional të Myftinisë së Tetovës, të përbërë nga: **hfz. Abdurahim ef. Murati** (kryetar); **hfz. Abdubaki ef. Kasami** (anëtar); **hfz. Havzi ef. Ramadani** (anëtar).

Pjesëmarrës në këtë ceremoni hivzi ishin Kreu i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, Myftiu i Tetovës **prof. dr. Qani ef. Nesimi**, Myftiu i Shkupit **dr. Qenan ef. Ismaili**, Myftiu i Kumanovës **h. Abedin ef. Imeri**, Myftiu i Shtipit **mr. Nasir ef. Rexhepi**, Sekretari i Myftinisë së Kërçovës **Qamil ef. Rushiti**, Prodekani i FSHI në Shkup **prof. dr. Ziber Lata**, Shefi i Kabinetit të Reisis'ue-Ulemasë dhe Drejtori për Diasporë **dr. Selver ef. Xhemaili**, Kryetari i organizatës humanitare “Hilal” **h. Fadil ef. Ramadani**, Drejtori i Institutit të Hifzit në Gostivar **mr. Eljesa ef. Hasani**, Myftiu i mëparshëm i Tetovës **Alifekri ef. Esati**, imami i Xhamisë **Amdiarif ef. Xhemi**, ish-Kryetari i Kuvendit të BFI **h. Haki ef. Agushi**, profesorë nga FSHI - Shkup, profesorë nga medreseja “Isa Beu”, hoxhallarë të Tetovës me rrethinë, si dhe një numër shumë i madh i xhematit dhe i mysafirëve.

“E nderuara dhe shumë e respektuara hafëze Sara Aliti. Ti që sot na tubove me veprën e madhe të hifzit, të nderuar ulema islamë që jeni prezentë këtu, të gjithë të lumtur e të gëzuar; shumë të respektuar vëllezër besimtarë e xhematlinj, të nderuara nëna dhe motra që jeni prezente këtu, më lejoni që përzemërsisht dhe shumë i gëzuar t’ju përshëndes me përshëndetjen e të madhit Zot: ‘Paqja, mëshira dhe begatitë e të Madhit Zot qofshin mbi të gjithë ju’. Të gjithë e dimë se kjo vepër që prezantohet e promovohet sot është një ngjarje e madhe, e papërshkruar, sepse fjala e njeriut nuk ka fuqi ta thotë vlerën e kësaj veprë. Sot këtë vepër e di vetëm zemra dhe shpirti. Shpirti dhe zemra janë masa kryesore që mund ta definojnë këtë vepër madhore,

sepse shpirti dhe zemra dalin jashtë asaj që quhet mendore dhe fizike”, tha Kryetari në detyrë i BFI të RMV.

“Se sa e madhe është kjo vepër e Sarës sot, më shkoi mendja kush ka qenë hafëzi i parë. Hafëzi i parë ka qenë pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi (a. s.); pastaj Katër Hulefai Rashidinët: hazreti Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu; tri hafezet e para: hazreti Aishja (r. a.), hazreti Hafsa (r. a.), hazreti Ummi Seleme (r. a.) dhe pastaj të gjithë as’habët, tabiinët dhe etbaitiinët, gjeneratë pas gjenerate. Pra, Sara sot me veprën e saj jeton dhe na çon neve të jemi me Muhamedin (a. s.), të jemi me as’habët e Muhamedit (a. s.), t’u tregojmë me gëzimin më të madh se ne - o i Kërkuari i Allahut, edhe pas 1400 vjetësh jemi në rrugën tënde, në praktikimin e Islamit, e në veçanti në kryerjen e hifzit të Kuranit famëlartë. Prandaj, mendoj se kjo sot është një ngjarje e madhe në fshatin Dobrosht. Prezenca jonë sot këtu, dëshmon se jemi vetëm për të treguar respektin tonë ndaj fjalës së Allahut fuqiptotë, ndaj fjalës së Kuranit famëlartë, të tregojmë respekt ndaj Hifzit të Kuranit famëlartë”, tha **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**.

Ceremoninë e hifzit e udhëhoqi **mr. Xhemil ef. Sadiki**, ndërsa të dhënat për hafëzen e re i prezantoi Kryetari i Komisionit të Hifzit, Referenti për Arsim Fetar në Myftininë e Tetovës, **hfz. Abdurahim ef. Murati**.

Pas fjalës përshëndetëse, Kreu i BFI-së hafëzes së re si dhe familjes së saj u shprehu urime për hifzin e kryer, me dëshirën për shëndet, lumturi dhe suksese në jetë. Ky manifestim përfundoi me duanë e Myftiut të Shkupit dhe dhënie të diplomës nga ana e Kryetarit të BFI-së dhe Myftiut të Tetovës. Në shenjë respekti, Rijaseti i BFI, Myftinia e Tetovës,

FSHI, si dhe Këshilli i Xhamisë së Epërme hafëzes së re i ndanë nga një dhuratë simbolike.

ADNI DEMA-HAFËZI I RI NGA SHKUPI

Më 15 tetor, 2020, në xhaminë “Bedër” të lagjes Butel u promovua edhe një hafëz i ri nga Myftinia e Shkupit - **hafëz Adni Dema**. Në këtë ceremoni, në një ambient gëzimor, xhamia Bedër lagjja Butel prezentë ishin Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, Myftiu i Shkupit **dr. Qenan Ismaili**, Myftiu i Tetovës **prof. dr. Qani ef. Nesimi**, Myftiu i Shtipit dhe i Maqedonisë Lindore **mr. Nasir Rexhepi**, Myftiu i Manastirit **h. Hamit ef. Rasimi**, Myftiu i Ohrit **h. Samet ef. Ajdari**, Shefi i Kabinetit të Reisit **dr. Selver ef. Xhemaili**, Kryetari i OH “Hilal” **Fadil ef. Ramadani**, përfaqësues nga Myftinia e Kërçovës, profesorë nga FSHI dhe Medreseja Isa Beu dhe shumë mysafirë e besimtarë.

Tubimin e përshëndeti nikoqiri, Myftiu i Shkupit **dr. Qenan ef. Ismaili**, i cili falënderoi të pranishmit për prezencën e tyre në këtë ceremoni hifzi.

Kreu në detyrë i BFI, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, në fjalën e tij të rastit uroi hafëzin e ri dhe familjen e tij, me dëshirën për suksese të reja. “Familja Dema”, tha ai me këtë rast, “tregoi një modesti të madhe: ata dëshen që gëzimin e madh që djali i tyre e ka mësuar tërë Kurandin për mendsh të mos e mbajnë vetëm për vetëm, në gjirin e tyre familjar, po atë gëzim ta ndajnë me miq e me mysafirë, me shokë, e në veçanti me përfaqësues të Bashkësisë Fetare Islame, përfaqësues të myftinive të gjithë Republikës së Maqedonisë së Veriut”.



ARBESA ALITI, HAFËZE NGA SLLUPÇANI



HAFËZE SARA ALITI, NGA DOBROSHTI



ADNI DEMA-HAFËZI I RI NGA SHKUPI

donisë së Veriut dhe ulematë islame të vendeve të ndryshme. Prandaj, ju falënderojmë shumë që na e dhatë këtë rast, që ta përjetojmë këtë gëzim kaq të madh bashkërisht. A thua pse është kaq i madh ky gëzim? Është i madh, sepse pas 1400 vitesh këtu, në këtë nënqiell, në këtë vend ku ne jetojmë vazhdojmë suksesshëm ta realizojmë jetën fetare islame - të jetojmë sipas Islamit, ta zhvillojmë Islamin, ta prezantojmë Islamin. Por, ajo që është shumë e rëndësishme është akti që përjetojmë sot: edhe ta mësojmë përmendsh Kuranin famëlartë, në mesin tonë të kemi hafëze dhe hafëzllarë të cilëve Allahu fuqplotë u ka dhënë një titull shumë të madh: njerëz që do ta mbrojnë Kuranin famëlartë me mendjet e tyre, me trupin e tyre, me zemrat e tyre, me shpirtin e tyre. Dikush do të pyetet ‘pse me zemrat e me shpirtin e tyre?’. Është e vërtetë se Kurani famëlartë mësohet me mendje, mësohet me tru, mësohet me logjikë, mirëpo truri është i paralizuar nëse nuk ka shpirt dhe zemër, nëse rrënjët nuk i ka në shpirtin dhe në zemrën e njeriut. E, në zemër e në shpirt është një burim i madh, që e forcon mendjen e njeriut, e ai është: imani, besimi tek Allahu fuqplotë. Allahu fuqplotë thotë se ky libër, Kurani famëlartë, është udhëzues, pa pikë dyshimi, për ata që i besojnë Allahut fuqplotë. Atij që nuk i beson të Madhit Zot - sa të duash shpjegoja Kuranin me argumente fetare, shkencore, sociologjike e psikologjike - kot e ke, sepse ai tru është pa shpirt, pa zemër, pa iman. Dikush do të pyet: ‘hoxhë efendi, ku fillojnë sevapet dhe gjynahet?’ Sevapet dhe gjynahet fillojnë prej momentin kur njeriu fillon e beson në të Madhin Zot. Nëse nuk ka iman, besim - nuk ka as gjynahe e as sevape. E, ‘si është e mundur: nuk ka iman e nuk ka as sevape e as gjynahe?’ A e dini pse? Sepse, ai është momenti kur më nuk i shënohet asnjë send. Është një katran i zi; nuk merr më as sevape e as gjynahe. Ai është si kompjuteri kur është i fikur - nuk luan, sepse është i fikur; nuk ka dritë - sepse nuk ka vend ku mund të shënohen as sevapet e as gjynahet. Për këtë arsye, vëllezër të dashur, hifzi i Kuranit famëlartë buron nga imani i paluhatshtëm që e ka ai që e ndjen dhe ai që e nis hifzin e Kuranit famëlartë. Në kohën e Muhamedit (a. s.) as’habët kanë lexuar Kuran në familjet e tyre, në afërsitë e tyre, në rrugët e tyre; pandërprerë kanë lexuar Kuranin famëlartë. Kur ke kaluar nëpër rrugë, është dëgjuar leximi i Kuranit famëlartë, sepse Kurani ka qenë në gojën e tyre, në zemrat e tyre, në shpirtin tyre, në sytë e tyre, në trupin e tyre dhe, ja - elhamdulillah

lah - edhe ne e përjetojmë atë që Kurani të njihet në mesin tonë. Të mësosh hifzin e Kuranit famëlartë nuk është vetëm çështje besimi, e dashuri ndaj Kuranit. Ka shumë e shumë vlera në momentin kur e mëson Kuranin përmendsh”, tha mes tjerash Kreu i BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Duanë e bëri Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, ndërsa namazin e iqindisë e udhëhoqi mr. Nasir Rexhepi, myfti i Shtipit. Hafizit të ri iu nda certifikata e hifzit dhe iu dhanë dhuratat të ndryshme nga Myftinia e Shkupit dhe nga Rijaseti i BFI.

AMRA ISMAILI, HAFËZJA NGA SELLARCA

Më 18 tetor, 2020, xhemati i Tetovës pati fatin që të përjetojë gëzimin e manifestimit të duasë së hifzit të hafëzes së re **Amra Muhamed Ismaili**, të kryer pranë Imamit të Xhamisë së Rinisë, **hfz. Ibrahim ef. Alija**.

Hafëzja është e lindur më 4.07.2003 në Tetovë, hifzin e ka filluar më 19.10.2017, kurse e ka përfunduar më 16.09.2020. Ndërkaq, provimin e hifzit e ka mbrojtur para komisionit profesional të Myftinisë së Tetovës, të përbërë nga: **hfz. Abdurahim ef. Murati**, kryetar; **hfz. Abdulbaki ef. Kasami**, anëtar; **hfz. Shafi ef. Ajdini**, anëtar.

Në këtë manifestim, të cilin e moderoi **mr. Xhemil ef. Sadiki**, mori pjesë: u. d. Kryetari i BFI-së Reis’ul-Ulema **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, Myftiu i Tetovës **prof. dr. Qani ef. Nesimi**, Myftiu i Shkupit **dr. Qenan ef. Ismaili**, Myftiu i Strugës **mr. Salim ef. Sulejmani**, Myftiu i Shtipit **mr. Nasir ef. Rexhepi**, përfaqësues nga Myftinia e Gostivarit, përfaqë-



AMRA ISMAILI, HAFËZJA NGA SELLARCA

sues nga Myftinia e Dibrës, Shefi i Kabinetit të Reis’ul-Ulemasë dhe Drejtori për Diasporë **dr. Selver ef. Xhemaili**, Myftiu i mëparshëm i Tetovës **Alifekri ef. Esati**, Imami i Xhamisë **Xhelal ef. Xhemaili**, profesorë nga FSHI, profesorë nga medreseja “Isa Beu”, hoxhallarë të Tetovës me rrethinë, si dhe një numër shumë i madh i xhematit.

Të dhënat për hafëzen e re i prezantoi Kryetari i Komisionit të hifzit, Referenti për arsim fetar në Myftininë e Tetovës, **hfz. Abdurahim ef. Murati**.

Pas fjalës përshëndetëse të Myftiut të Tetovës, fjalën e rastit e mbajti u.d. Kryetari i BFI-së Reis’ul-Ulema **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**. Ai hafizes së re, si dhe familjes së saj, u shprehu urime për hifzin e bërë, duke u dëshiruar shëndet, lumturi dhe suksese në jetë.

Ky manifestim përfundoi me duanë e bërë nga Myftiu i Shkupit dhe dhënien e diplomës nga ana e Kryetarit të BFI-së dhe Myftiut të Tetovës.

Në shenjë respekti, Rijaseti i BFI-së dhe Myftinia e Tetovës hafëzes së Re i ndanë nga një dhuratë simbolike, ndërsa në namazin e drekës priu Myftiu i mëparshëm i Tetovës – thuhet në komunikatën për shtyp të Myftinisë së Tetovës.

Promovimi i hafëzes së re Amra Ismaili nga fshati Sellarcë, të bijës së **h. Muhamed ef. Ismailit**, kaloi me pjesëmarrje të shumë ulemave islame dhe besimtarëve në një ambient të këndshëm. Në fjalën time të rastit përzemërsisht urova hafëzen e re për veprën madhore të saj. Organizimi - i nivelit të lartë, ka shkruar në faqen e vet të Facebook-ut **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, Kryetar në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

DITA MË E MIRË E JAVËS: ELHAMDULILAH



REISI FAL XHUMANË NË DIBËR



Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, xhumanë e fundit të muajit shtator (25.09) e fali në Dibër, bashkë me xhematin dibran. Në një atmosferë të ngrohtë e vëllazërore, Kreu i BFI shoqërohej nga myftinjtë e BFI: **mr. Salim ef. Sulejmani** – Myfti i Strugës, **Samet ef. Ajdari** – Myfti i Ohit, **Nasir ef. Rexhepi** – Myfti i Shtipit dhe i Maqedonisë Lindore, **dr. Selver ef. Xhemaili** - Shef i Kabinetit dhe Drejtor për Diasporë, **Irsal ef. Jakupi** - Sekretar i Përgjithshëm i BFI, **Qamil Rushiti** - Sekretar i Myftinisë së Kërçovës, pastaj drejtorë të sektorëve dhe bashkëpunëtorë të tjerë të BFI, në organizimin e Myftiut të Dibrës së Madhe, **Reshat ef. Kaçallniku** dhe operativës së kësaj myftinie.

Ata vizituan Xhaminë e Sahatit, apo siç e njohin dibranët Xhaminë e Myftiut, e cila thirret ashtu për nder të ish-Myftiut të ndjerë të Dibrës, dhe njëherësh ish-Kryetar i këtij qyteti, **mr. Ruzhdi ef. Lata**.

Me këtë rast, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu** mbajti një ligjëratë për rëndësinë e Islamit në këto troje dhe tha: “Vëllezër të dashur besimtarë, miq e mysafirë të nderuar. Është kënaqësi e veçantë që ndodhem këtu sot, në këtë moment, në xhaminë më të bukur që ka Dibra dhe që ka territori i Maqedonisë së Veriut. Është kënaqësi e veçantë që sot jemi drejtuar drejt Kiblës, i jemi drejtuar Qabesë dhe të dëshmojmë me namazin tonë se e duam Allahun, jemi pjesëtarë të Islamit dhe kryejmë urdhrin e Allahut fuqplotë, pra namazin e xhumasë. Ne shpeshherë themi *elhamdulillah* që jemi pjesëtarë të Islamit. Dhe, duhet ta themi, por ta themi duke e kuptuar këtë fjalë: ‘falënderojmë Zotin që jemi pjesëtarë të Islamit’ dhe duke e futur në zemrat dhe në trupin tonë. Kjo fjalë: *elhamdulillah* – falënderojmë Zotin, duhet të futet në zemrat tona, në mendjen tonë dhe në jetën tonë të përditshme, në familjen tonë e në shoqërinë tonë.”

Më tej ai vazhdoi: “Nuk erdhi Islami rastësisht deri në kohën tonë. Dikush e ka mendjen për ta sakrifikuar Islamin, natë e ditë; dikush e dha pasurinë e vet, që Islami të zhvillohet; dikush e dha edhe jetën e vet që Islami të vijë deri këtu në kohën

ku jetojmë. Ju e dini se jetojmë në një kohë moderne, në kohën e teknologjisë, të mjeteve të informacionit. Sot, pra, nuk ka komb në botë ku s’ka Islam; nuk ka vend, nuk ka kontinent, ku nuk është prezent Islami dhe kjo sot është shumë aktuale në botë. Por, kur e analizojmë historikun e Islamit, shohim mundin që kanë dhënë gjeneratat para nesh në të katër anët e botës, e menjëherë na parashtrohet pyetja: e ne, si duhet ta kuptojmë? Së pari duhet ta kuptojmë se ky Islam, të kohës së sotme, e kemi amanet nga i Madhi Zot. A e dini çka do të thotë amanet? Kur dikush ka diçka të shtrenjtë, shumë të shtrenjtë e ta jep në besim”, tha mes tjerash Kreu në detyrë i BFI të RMV.

Më pas, Kreu i BFI udhëhoqi me faljen e namazit të xhumasë.

Vizitës i parapriu një takim zyrtar dhe një pritje madhështore nga Kryetari i Dibrës, **dr. Hekuran Duka** dhe stafi i kësaj komune, ku u bisedua rreth kujdesit të Kryetarit Duka dhe ekipit të tij për kujdesin e qytetit të Dibrës, kontributin e drejtpërdrejtë që jep kjo komunë në organizimin e jetës fetare, duke u parë për së afërmi edhe të gjitha kontributet dhe aktivitetet që i bën Myftiu i Myftinisë së Dibrës, Reshat ef. Kaçallniku. Me Kryetarin Duka, gjithashtu u bisedua edhe për bashkëpunimin e ndërsjellë në të ardhmen mes Bashkësisë Fetare Islame dhe Komunes së Dibrës.

NAMAZ NË XHAMINË ALI PASHA NË OHËR



Në kuadër të premtimit që bëri Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, në momentin kur e mori udhëheqjen me institucionin fetar islam, se “xhamitë janë zyrat tona”, 2 tetor, 2020, ai bashkë me operativën e Rijasetit dhe i shoqëruar nga disa myftinj të BFI fali xhumanë në xhaminë më të famshme të Ohrit, “Ali Pasha”, e cila ndodhet në qendër të qytetit.

Fillimisht, një fjalim të shkurtër pati nga Myftiu i Myftinisë së BFI-Ohër, **h. Samet ef. Ajdari**, i cili përshëndeti të pranishmit:

Kreun e BFI-së, Myftiun e Shkupit **dr. Qenan ef. Ismaili**, Myftiun e Strugës **mr. Salim ef. Sulejmani**, Myftiun e Manastirit **Hamit ef. Rasimi**, Shefin e Kabinetit të Reisit dhe Drejtorin për Diasporë **dr. Selver ef. Xhemaili**, Sekretarin e Përgjithshëm të BFI **Irsal ef. Jakupi**, Drejtorin e Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe **h. Ismet ef. Ademi**, mysafirin special **hfz. Egzon ef. Ibrahim**, i cili lexoi disa ashere nga Kurani famëllartë para fillimit të faljes së namazit, si dhe mysafirët e tjerë dhe xhematin e qytetit të Ohrit.

Në fjalimin e tij përshëndetës, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu tha: “E Xhumaja është ditë feste për myslimanët e këtij nënqielli, por edhe në gjithë botën. Falënderoj Allahun fuqplotë që nëpërmjet ftesës së myftiut tuaj të respektuar, h. Samet ef. Ajdari, sot të jemi këtu pranë këtij xhemati të respektuar të qytetit të Ohrit. Kënaqësinë më shumë e shtoi fakti se xhumanë do ta falim në bukuroshen e këtij qyteti, në Xhaminë e Ali Pashës, e cila së pari i zbukuroi zemrat tona, shpirtat tanë, e ngriti lart krenarinë tonë, dinjitetin tonë, por kjo xhami na tha të gjithëve: ‘nuk jam vetëm e juaja; jam e gjithë qytetit, këtij qyteti që është multietnik, multikonfesional’ dhe i tregoi gjithkujt në Ohër, e më tej, se xhamitë janë vlera të të gjithëve, ato janë objekte të Allahut, shtëpitë e të madhit Zot, që i japin gëzim çdokujt, i hapin rrugën drejt Zotit çdokujt dhe janë simbole që e ngrenë lart edhe vendin ku janë ndërtuar. Edhe pse gjatë javës kemi shumë angazhime dhe obligime, në programin tonë e kemi caktuar që çdo javë t’i vizitojmë Myftinitë, xhematat tona, kudo që janë, sepse ne duhet të jemi sa më pranë xhemateve tona e t’u themi se ne jemi ju - e ju jeni ne. T’u tregojmë se: ne dhe asgjë më tepër; t’u tregojmë se besimtarët tanë meritojnë t’u jemi shërbëtorë, t’u tregojmë se kudo që janë besimtarët i drejtohen Allahut fuqplotë me pasuritë dhe trupin e tyre, se besimtarët i mirëmbajnë xhamitë e objektet fetare - mbi 700 në Maqedoninë e Veriut. Ju dhe besimtarët mbarë Maqedonisë mbani Medresenë me fitrat tuaja, me zeqatin tuaj, me anëtarësinë tuaj, me pasurinë tuaj, ashtu siç e kanë mbajtur fenë as’habët bashkë me Muhamedin (a. s.). Andaj, ky popull, këta besimtarë, që bëjnë vepra kaq madhore në vendin e tyre, e meritojnë prezencën tonë, meritojnë të jemi bashkë me ta...”

Faljes së namazit të xhumasë i parapriu Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup, **dr. Qenan ef. Ismaili**, ndërsa hytben e xhumasë e paraqiti Myftiu i Myftinisë së Strugës, **mr. Salim ef. Sulejmani**.

PËRKRAH BESIMTARËVE NË XHAMINË MURAT PASHA

Më 16 tetor, 2020, Kreu në detyrë i BFI të RMV, **h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**, i shoqëruar nga Myftiu i Myftinisë së Shkupit, **dr. Qenan ef. Ismaili** dhe operativa e Rijasetit dhe e Myftinisë falën xhumanë në një nga xhamitë më të vjetra të qytetit të Shkupit - Xhaminë Murat Pasha.

Dita e xhuma – sipas Reis’ul-Ulemasë - është një nga ditët më të mira dhe më të qëlluara për t’u takuar me besimtarët, për të qëndruar me ta, për të folur me ta, për t’i dëgjuar hallet e tyre, si dhe për t’i udhëzuar sipas parimeve islame të Kuranit famëllartë islame dhe sipas mësimëve të Pejgamberit (a. s.). Transmetohet nga Ebu Hurejra - Allahu qoftë i kënaqur me të - se Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Dita më e mirë në të cilën ka lindur dielli është dita e xhumasë. Në këtë ditë është krijuar Ademi (alejhi-selam), në këtë ditë është futur në xhenet, në këtë ditë është nxjerrë nga xheneti dhe nuk do të bëhet kiameti vetëm se në këtë ditë.” (Muslimi)

Një ditë madhështore sikur xhumaja pa dyshim se përmban jo buqetë, por thuar lirisht: kopshte urtësishe, të cilat janë vërtet shumë mbresëlënëse dhe përçojnë vetëm humanizëm - tha në fjalimin e tij para xhematit të Shkupit, në Xhaminë Murat Pasha, Kreu i BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe vazhdoi: “I nderuar Myftiu i Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, i nderuar Këshilltar për Çështje Fetare pranë Ambasadës Turke z. Murat Alkan, i nderuari Shef i Kabinetit dhe Drejtor për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, shumë i nderuar imam i kësaj xhamie të mirënjohur h. Sulejman ef. Baki, të nderuar dhe shumë të respektuar vëllezër e mysafirë, më lejoni t’ju përshëndes me përshëndetjen islame: *Paqja dhe be-*

gatitë e Allahut qofshin me të gjithë ju! Sot kemi dalë bashkë me Myftiun që ta falim namazin e xhumasë, sepse në programin e Bashkësisë Fetare Islame ditën e xhuma ia kemi lënë vetëm faljes së namazit të xhumasë, ua kemi lënë gjithë besimtarëve kudo që janë dhe kudo që ndodhen. Unë jam shumë i kënaqur dhe u lumtur që Myftiu dhe Imami më dhanë rastin të gjendem në këtë xhami, sepse të gjitha xhamitë kanë rëndësi të njëjtë. Por, kjo xhami ka një simbolikë tjetër - kjo xhami është qindra vjet e vjetër. Kjo xhami na përkujton periudhën, historinë e artë të myslimanëve me Perandorinë Osmane, kur kemi formuar besimin, kulturën dhe Islamin tonë në përgjithësi. Për këtë shkak, kjo është kënaqësia ime e madhe që sot të ndodhem në këtë xhami. Falënderoj imamin, **h. Sulejman ef. Baki**, që na mundësoi t’ju them disa fjalë e t’ju falënderoj juve, të nderuar besimtarë, për gjithë mbështetjen dhe përkrahjen që jepni jo vetëm për këtë xhami, por për gjithë fenë islame; për përkrahjen që jepni për shpjegimin e fesë islame në kohën në të cilën ne jetojmë. Ju jeni ata që e mbani Islamin me pasurinë tuaj, me trupin tuaj, me trupin tuaj, me mundin tuaj dhe me shumë punë dhe me këtë vërtetë se i qëndrojmë besnik rrugës së Muhamedit (s.a.v.s.) edhe pas 14 shekujve, edhe atë këtu, në vendin tonë, në Ballkan dhe Evropë. Prandaj, lirisht mund të them se ne jemi ambasadorë të Islamit këtu, në këtë nënqiell dhe mu për këtë, vlera jonë tek i Madhi Zot, të jeni të bindur se është shumë e lartë. Lusim Allahun fuqplotë që të na i pranojë të gjitha veprat, të gjitha punët që i bëjmë, me qëllim që nesër të fitojmë kënaqësinë e Allahut fuqplotë e të Muhamedit (a. s.)”

Hytben e xhumasë e mbajti Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, ndërsa faljes së namazit të xhumasë i priu Kreu i BFI-së, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.



NIS NDËRTIMI I VAKËFIT NË STRUGË



Më 24 shtator, 2020, Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të selisë së Myftinisë së Strugës, tek i vetmi vakëf i qytetit të Strugës, në qendër të qytetit.

Ceremonia modeste u udhëhoq nga Myftiu mr. Salim ef. Sulejmani dhe në të ishin edhe: Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri, Myftiu i Ohrit h. Samet ef. Ajdari, Myftiu i Velesit Nejazi ef. Murati, Myftiu i Manastirit Amit ef. Rasimi, Myftiu i Dibrës Reshat ef. Kaçallniku, Myftiu i Prilepit Shefket ef. Imeri, përfaqësues nga Myftinia e Kërçovës, Shefi i Kabinetit të Reis’ul-Ulemasë dhe Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, Sekretari i Përgjithshëm i BFI Irsal ef. Jakupi, drejtorë të sektorëve në kuadër të Rijasetit të BFI, profesorë të Medresesë Isa Beu dhe të Fakultetit të Shkencave Islame, besimtarë dhe dashamirë të Islamit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i BFI-Strugë foli rreth historikut të këtij objekti, i cili ishte nacionalizuar në kohën e monizmit. Pas një punë të pandërprerë e të palodhur, Myftinia, me në krye mr. Salim ef. Sulejmanin, arriti që ta kthejë në pronësinë e Myftinisë së Strugës në vitin 2013.

Kreu i BFI, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu,

në fjalimin e tij përveç tjerash tha: “Kudo që veprojmë, ne jemi një dhe çdo ndërtesë që bëhet për hir të Allahut, është e të gjithë neve dhe kjo pjesëmarrje këtu tregon se do të jemi pjesëmarrës në ndërtimin e saj. Kjo është ndërtesa e Allahut fuqplotë, është vakëf, është burim i të mirave materiale për të shpjeguar fjalët e Allahut fuqplotë dhe se kjo do të jetë një bazë që do të nxit edhe më fuqishëm formimin e vakëfeve në territorin e Myftinisë së Strugës. Kjo vepër është me vlerë shumë të madhe. Nëse më pyetni - sa e madhe është? - nuk do të dija t’ju tregoj, nuk do të dija t’i numëroj vlerat e kësaj, sepse vepra e Allahut fuqplotë nuk është brenda matematikës njerëzore, ajo është jashtë numrave të matematikës së kësaj bote, prej së cilës kanë dobi të gjallët e kësaj bote: ka dobi shpjegimi i Islamit; ka dobi forcimi i Islamit; ka dobi prezantimi i Islamit; ka dobi mbajtja e Islamit si amanet në kohën në të cilën ne jetojmë. Për shkak se Islamin e kemi amanet nga Allahu fuqplotë, e kemi amanet nga gjeneratat që dhanë gjithçka - mendjet e tyre, pasuritë e tyre, trupin e tyre, jetën e tyre që Islami të kalojë dhe transferohet këtu në Ballkan, këtu në Maqedoninë e Veriut, këtu në Strugë. Dhe, për këtë Islam kanë sakrifikuar gjeneratat para nesh dhe e kemi obligim që ta mbrojmë. Prandaj,

ndërtimi i kësaj ndërtese të vakëfit është një ndër detyrat që kryejmë sot për ta mbajtur këtë amanet këtu në Ballkan dhe në Evropë. Popujt që kaluan para jush, do të kenë atë që ata ndërtuan, atë që ata fituan, atë që ata zhvilluan; ju do ta keni atë që në kohën tuaj do ta ndërtoni dhe do ta zhvilloni. Ju nuk do të pyetni për atë që kanë punuar të parët tuaj - ju do të pyetni: sot çka jeni duke punuar?, ju sot çka punoni? Ju sot ringjallni vakëfin e atyre që punuan dhe ju sot iu thoni atyre - ata janë zgjuar sot, ata janë gëzuar sot, sepse ju ringjallni, ju e rritni dhe e forconi veprën e atyre që kaluan para jush. Dhe, ju u tregoni atyre se ne nuk ngelim vetëm në atë që ju keni vepruar; ne vazhdojmë të ndërtojmë rrugës tuaj, ashtu siç e keni filluar, siç e keni zbatuar. Ne vetëm mund ta rrisim, ta zbukurojmë dhe ta fuqizojmë, me qëllim që të jemi bartës dhe prezantues të denjë të Islamit.”

Në fund, duanë e gurthemelit e bëri Myftiu i BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili.

Gjithashtu, në protokollin e hedhjes së gurthemelit të ndërtesës së re të Myftinisë së Strugës ishte edhe vizita e Xhamisë Lulishte, e cila është në përfundim e sipër - bukuri e rrallë, e punuar në mënyrën më të mirë, ku mysafirët falën edhe namazin e drekës.

NGUSHËLLIME TE FAMILJA BIZATI NË LADORISHT

Reis'ul-Ulema hafëz efendi Shaqiri, i shoqëruar nga myftinjë dhe bashkëpunëtorët, si dhe nga dy hoxhallarët e fshatit Ladorisht, vizituan familjen e rahmetliut, dashamirit të Myftinisë dhe të fesë, haxhi Xhevdet Bizati.

Krerët e BFI-së u mikpritën nga djemtë e rahmetliut, afaristë të mirënjohur nga Struga, z. Kamberi dhe z. Nasufi.

Reisi dhe Myftiu i Strugës, në emër të të gjithëve që ishin të pranishëm, i shprehën ngushëllime familjes për babanë e tyre, duke lutur Allahun e madhërisëm që rahmetliun ta mëshirojë, ndërsa djemve dhe familjes së tij t'u japë shëndet dhe suksese në aktivitetin e tyre – thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Strugës. (24.09.2020)



NGUSHËLLIME TE FAMILJA ADEMI

Një vizitë ngushëllimi te familja Ademi në fshatin Drogomisht të Kërçovës, me rastin e ndërrimit të jetës të hoxhës së mirënjohur Ali ef. Ademi, një imam, hatib, mualim dhe aktivist i mirënjohur i Myftinisë së Kërçovës dhe BFI të RMV. Në këtë takim isha i shoqëruar nga Shefi Kabinetit dhe Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, Drej-

tori për Marrëdhënie me Botën e Jashtme h. Ismet ef. Ademi, Referenti i Myftinisë së Gostivarit z. Sabahudin ef. Zendeli, mysafiri i mirënjohur nga Kosova z. Egzon ef. Ibrahim i dhe afaristi z. Refet Fetai. Në këtë vizitë ngushëllimi na udhëhoqën z. Qamil ef. Rushiti, Sekretar i Myftinisë së Kërçovës dhe imami i Zajazit, Muhamed efendiu. Pas fjalëve

ngushëlluese që i përcolla te familja Ademi, Egzon ef. Ibrahim i lexoi një ashere nga Kurani famëllartë për shpirtin e rahmetliut. Rahmetli hoxhën tonë të nderuar Allahu e mëshiroftë me xhenet, ndërsa familjes Zoti i dhashtë sabrin e paluhatshtëm – ka shkruar h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në profilin e tij në Facebook. (3.10.2020)



SHAQIR EF. FETAHU, ANËTAR I KËSHILLIT BOTËROR TË KOMUNITETEVE MYSLIMANE

Kryetari në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 6.10.2020 është zgjedhur anëtar i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, me seli në Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe.

Sipas informatave të këtij këshilli, Shaqir ef. Fetahu është zgjedhur anëtar i plotë i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, ndërsa përzgjedhja e tij është bërë duke u bazuar në punën e palodhshme dhe kontributin e dhënë gjatë tërë jetës së tij në të mirë të institucionit islam në vend, pra Bashkësisë Fetare Islame të RMV, në shpjegimin e Islamit dhe të kulturës islame në përgjithësi dhe në mbështetjen e besimtarëve myslimanë.

Që në moshën e re, 14 vjeç – bën të ditur njoftimi - h. hfz. Shaqir ef. Fetahu



انضمام مفتي جمهورية مقدونيا الشمالية إلى الأمانة العامة للمجلس العالمي للمجتمعات المسلمة

e kreu hifzin, e më pas kontributin e tij e dha si: imam, mualim, mësime në SHM Medreseja Isa Beu, si anëtar i Këshillit Themeltar të Fakultetit të Shkencave Islame-Shkup, si udhëheqës i suksesshëm i disa drejtorive në Rijasetin e BFI, si iniciator i themelimit të Medresesë për vajza në Gostivar, si iniciator i themelimit të Institutit të Hifzit dhe bu-

kurleximit të Kuranit famëllartë “Hfz. Hasan ef. Zendeli”, si pjesëmarrës i suksesshëm në shumë konferenca dhe simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare, si autor dhe publicist i 6 veprave dhe mbi 300 artikujve të botuar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme në vend dhe jashtë vendit në gjuhë të ndryshme, si fitues i shumë dekoratave nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, në informacionet e Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane përmendet edhe kontributi i madh që h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka dhënë për plot 18 vjet si Myfti i Myftinisë së BFI-Gostivar në mirë organizimin e jetës fetare, kthimin e pronave të vakëfit dhe krijimin e kushteve dhe objekteve të reja me qëllim të organizimit sa më të mirë të jetës fetare në këtë Myftini dhe më gjerë. (7.10.2020)

TAKIM FETAHU-GRUBI

Zëvendëskryeministri i parë dhe Ministri për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, z. Artan Grubi, ka takuar ushtruesin e detyrës Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, z. Shaqir Fetahu.

Gjatë këtij takimi Grubi i ka thënë Fetahut se Qeveria në vazhdimësi bën përpjekje për kultivimin e harmonisë ndërfaqetare në Maqedoni të Veriut dhe se Qeveria me vëmendje trajton dhe do të vazhdojë t'i trajtojë çështjet të cilat janë me rëndësi për Bashkësinë Fetare Islame dhe për bashkësitë e tjera fetare në vend.

Nga ana e tij, u.d. Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Shaqir Fetahu, i ka thënë Zëvendëskryeministrit të parë se pjesëtarët e Islamit bashkëtojnë në një harmoni të dalluar me pjesëtarët e besimeve të tjera, duke i dhënë kështu vendit ngjyrën e një shteti tolerant dhe të përkushtuar në zhvillimin social, ekonomik etj.



Të dy bashkëbiseduesit diskutuan rreth aktiviteteve të Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së dhe takimet e tyre me organizatat simotra, si dhe në kultivimin e marrëdhënieve të mira ndërnjerëzore, ndërfaqetare dhe ndërnacionale.

Bashkëbiseduesit gjithashtu kanë këmbyer mendime lidhur me orientimin propeëndimor të vendit dhe thellimin e bashkëpunimit të Qeverisë me Bashkësinë Fetare Islame, bashkë edhe me përcaktimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në krijimin e një shoqërie të barabartë për të gjithë. (7.10.2020)

KREU I BFI NDOQI PREZANTIMIN E KOMISIONERIT EVROPIAN

Kryetari në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 7 tetor, 2020, në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut mori pjesë në prezantimin e Komisionerit të BE-së për zgjerim dhe fqinjësi të mirë Oliver Varhei, i cili e dorëzoi Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020.

Komisioneri Evropian në Parlament, me një fjalim, iu drejtua të zgjedhurve të popullit dhe prijësve të Bashkësive Fetare, duke e cilësuar kështu fjalimin e tij njëjtë sikur t'i ishte drejtuar tërë popullit



të Maqedonisë së Veriut.

Ai gjithashtu foli edhe për zhvillimin ekonomik të vendit tonë në veçanti dhe të tërë rajonit në përgjithësi, si një nga prioritetet e BE në të ardhmen. Plani ekono-

mik i prezantuar nga Komisioneri Evropian Oliver Varhei dhe plani për investimet për Ballkanin Perëndimor synojnë të inkurajojnë rimëkëmbjen ekonomike afatgjatë në rajon synon përshtetimin e integritet në BE, por që aktualisht pengohet nga pandemia Covid-19. Plani i paraqitur konfirmon se e ardhmja e të gjithë rajonit, megjithatë, është në Bashkimin Evropian dhe Brukseli tregon qartë se rajoni është përparësia e tij gjeostrategjike.

Të pranishmit falënderuan Komisionerin Varhei për angazhimin dhe mbështetjen.



ËSHTË SHEKULLI 21 SHEKULLI I RELIGJIONEVE?



Shihet qartë se pse Macron doli në opinion me idenë e strukturimit të Islamit dhe të reformës iluministe të Islamit në Francë. A do të vazhdojë të qeverisë me platformën e saj pas zgjedhjeve të ardhshme parlamentare në vitin 2022 "Republika në Ecje", do të varet shumë edhe nga qëndrimi i Macron-it ndaj imigracionit, myslimanëve etj. etj.

Shkruan: Muhamed Halili
(Enkas për HeR)

Ngjarjet të cilat viteve të fundit e tronditën civilizimin perëndimor sikur e vërtetojnë thënien e novelistit të madh francez Andre Malraux (1901-1976), pak përpara vdekjes së tij në vitin 1976, se "shekulli 21 do të jetë religjioz ose nuk do të jetë fare".

Samuel Huntington, politolog i shquar amerikan, profesor për marrëdhënie ndërkombëtare dhe këshilltar politik i disa qeverive në Amerikë, në revistën prestigjioze "International Affairs" në vitin 2004 shkroi kolumnën "Përplasja e civilizimeve", ku theksoi se me përfundimin e Luftës së Ftohtë "bota kthehet në hapësirën ku do të dominojnë civilizimet, ku konfliktet do ta kenë rrënjën në përplasjet midis civilizimeve".

Pas akteve terroriste të 7 korrikut 2005 në Londër kryeministri i atëhershëm britanik Tony Blair deklaroi se këto akte ishin të drejtuara kundër vlerave britanike, siç janë: demokracia liberale, të drejtat e njeriut (ku bënë pjesë edhe barazia midis femrës dhe mashkullit), shteti i së drejtës, multikulturalizmi dhe liria e fjalës. Çështja kryesore për të analizuar ishte si është e mundur që katër të rinj myslimanë, të lindur dhe të edukuar në Britaninë e Madhe, të ngrënë dorë kundër atdheut në të cilin u lindën dhe kundër shtetit që i edukoi dhe u dha besim të edukojnë gjeneratat e reja.

ÇKA ËSHTË E LEJUAR, ÇKA ËSHTË E NDALUAR

Në religjionin e krishterë karikataturimi i Jezu Krishtit është i lejuar dhe nuk ndjell ndonjë mllef të posaçëm të të krishterët po qe se dikush e karikaturon Krishtin. Te myslimanët, përkundrazi, karikaturimi i profetit Muhamed (s.a.v.s.) është i ndaluar dhe shkakton indinjatë të besimtarët.

Në emër të lirisë së shprehjes, një karikaturist i njohur danez në të përditshmen



Jyllands Posten më 30 shtator 2005 botoi 12 karikatura ku fyhej profeti Muhamed dhe Islami si religjion. Kjo shkaktoi protesta të mëdha të grupeve islame në Danimarkë dhe në tërë botën, me ç'rast u dogjën disa ambasada në shtete të ndryshme evropiane.

Pasi javorja satirike franceze "Charlie Hebdo" kishte publikuar 12 vizatimet e botuara në Jyllands Posten të Danimarkës, vëllezërit Said dhe Sherif Kuashi më 7 janar 2015, të armatosur, hynë në selinë e javores dhe vranë 12 persona dhe plagosën shumë të tjerë. Kjo ngjarje solli indinjatë të madhe në tërë botën demokratike.

Më 16 tetor 2020, një prind mysliman i një nxënësje të një kolegji në Ivelines, në periferi të Parisit, ia hoqi kokën me thikë mësuesit të histori-gjeografisë pasi u kishte ligjëruar nxënësve për lirinë e shprehjes nëpërmjet një vizatimi ku profeti Muhamed paraqitet lakuriq.

Ngjarja edhe kësaj radhe e tronditi Francën. Në vend të ngjarjes shkoi edhe presidenti francez Macron dhe prej atje deklaroi: "Obskurantizmi nuk do të kalojë. Ata nuk do të na ndajnë. Ata këtë e dëshirojnë".

Kështu në vitin 2005 deklaroi edhe Toni Bler. Gazetat britanike në ballinë e kishin botuar një fotografi ku një zezak dhe një nga raca e bardhë, të përgjakur, iknin dorë për dorë nga vendi i ngjarjes.

"Islami është në krizë, duhet ta struk-

turojmë"?! Kohë më parë, më 2 tetor, në një ligjëratë për separatizmin religjioz të mbajtur në Yvelines, lagje afër Parisit, presidenti francez Emanuel Macron deklaroi siç vijon: "Atë që ne duhet ta sulmojmë është separatizmi islamik. Është një projekt i ndërjegjshëm, i bazuar teoretikisht, politiko-religjioz, i cili konkretizohet nga shmangiet e përsëritura me vlerat e Republikës."

Lufta e tij kundër separatizmit bazohet në pesë shtylla. Ai e ka vënë në spikamë neutralitetin e shërbimit publik, duke i kundërshtuar orët e rezervuara për femrat në pishinat komunale, si dhe meny të konfesionale në kantinat e ushqimit.

PROPOZIMLIGJI PARASHTROHET NË DHJETOR

Duke e shpjeguar tekstin e propozimligjit, i cili në dhjetor të këtij viti do t'i parashtrohet Këshillit të Ministrave, presidenti Macron deklaroi: "Ajo që ky propozimtekst do të mundësojë, është se në mënyrë shumë konkrete do të theksohet se obligimi i neutralitetit do të aplikohet në administratën publike (...) dhe do të shtrihet edhe te nëpunësit e ndërmarrjeve".

Më tej Presidenti deklaroi se asociacionet të cilat nuk do t'i respektojnë rregullat e Republikës, do të çregjistrohen dhe financimi i tyre do të kontrollohet. Macron me këtë ligjëratë paralajmëroi

strukturimin e Islamit në Francë, duke u shprehur se «do të ndërtohet në Francë një Islam i Iluminizmit». Pra, edhe Macron, njësoj sikurse Sarkozy vite më parë, konsideron se është domosdoshmëri të ruhen vlerat republikane, duke siguruar se ajo do t'i mbajë premtimet për barazi dhe emancipim. Propozimet e Macron-it synojnë shpalljen e një lufte kundër individëve dhe asociacioneve të cilët kërcënojnë vlerat laike të Republikës franceze, në radhë të parë kundër Islamit radikal.

Macron konsideron se laiciteti është çimentoja e Francës unike dhe se «...obligimi i tyre është të luftojnë kundër atyre që shqetësojnë në emër të religjionit duke i mbrojtur ata të cilët besojnë në Islam dhe janë qytetarë me të drejta të plota të Republikës».

Në fjalimin e tij të mëtuqjeshëm Macron ka deklaruar se shteti francez është përgjegjës për getoizimin e komuniteteve, ku radikalët islamikë kanë zënë rrënjë, sepse atyre nuk u është kushtuar kujdes i posaçëm. Atje ku ne jemi larguar, kanë intervenuar ata, vazhdon ai. Macron në fund pranon se historia e kolonializmit ka lënë plagë që asnjëherë nuk janë shëruar.

Cila ishte nevoja e Macron-it që në vitin 2022 t'u kthehet vlerave republikane dhe laicizmit francez?

Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2017 kandidati i dytë për president të Francës ishte Marine le Pen me afër 23% të votave të përgjithshme. Ajo është kryetare e partisë «Bashkimi Kombëtar», parti e cila e mbante emrin Fronti Nacional në kohën e të atit të saj Jean-Marie le Pen, një antiislamik i përbetuar.

PËRBALLJE ME VALËN ULTRA TË DJATHTË

Në shumë vende të Perëndimit me traditë të gjatë demokratike, si dhe me standarde, deri më sot bëhet një debat i ashpër rreth definimit të multikulturalizmit dhe identitetit kombëtar. Dhjetëvjetëshin e fundit civilizimi europërendimor përballet me një valë të lëvizjeve politike ultra të djathta, të cilat përqipen që t'i shtyjnë anash partitë socialdemokrate, socialiste, liberale dhe konservative dhe dalëngadalë të bëhen faktorë aktivë politik në përbërjen e qeverive.

Në Francë sinonim për krijimin e kombit dhe të kulturës së pastër franceze ishte më parë Jean-Marie le Pen, i cili tash ndiqet nga e bija e tij Marine le Pen. Ai e arriti kulmin e famës së tij politike kur në presidencialet e vitit 2002 e mundi kandidatin e njohur socialist Lionel Jospin dhe në rundin e dytë me 17,50% të votave humbi nga Jacques Chirac.

Platforma politike e kryetarit të Frontit Nacional Jean-Marie le Pen ishte antiislamike, duke bërë një dallim mes "myslimanëve të huaj" (të ardhur në Francë nga vendet e Maghrebit) dhe "myslimanëve francez", të cilët asnjëherë nuk kanë synuar francezëve t'ua imponojnë kulturën e tyre, asnjëherë nuk kërkuar të ndërtojnë atë që kërkojnë tash (xhami me minare të larta-shënimi im) "myslimanët e huaj", deklarohet ai, dhe tash Evropa përballet me rrezikun të vërshehet nga valët e imigrantëve.¹⁾

Jean-Marie le Pen i përkrah idetë politike të ultranacionalistit të njohur holandez Geert Wilders, të cilat janë: respekti i zakoneve të vendit, dokeve dhe kulturës dhe gjuhës së tyre. Kjo është edhe kërkesa e Le Pen, sepse "kur ai e viziton ndonjë vend islam si turist, ai i respekton doket dhe kulturat e tyre".

Megjithatë, kanë një dallim të madh vizitat e Le Pen-it vendeve islamike si turist dhe respektimit të dokeve dhe zakoneve franceze nga "francezët e rinj", gjenerata të dyta, të treta dhe të katërta të myslimanëve të lindur në Francë nga epoka postkoloniale, kur si rezultat i politikave diskriminatore ata nuk kanë arritur të integrohen në shoqëritë e tyre, por megjithatë janë shtetas francez të diskriminuar, të cilët në vete e bartin mllefin e së kaluarës, kur francezët të parët e tyre i kanë eksploatuar fizikisht dhe ekonomikisht.

Për këtë Macron konstaton se kolonializmi ka lënë vragë të thella në shoqërinë franceze, gjë që reflektohet në marrëdhëniet ndërkonfesionale tash. Francezët e rinj dhe me pasaportë janë shtetas të Francës, por statusi i tyre shoqëror është: myslimanë ose imigrantë, njerëz të ardhur nga Maroko, Tunizia, Libani etj., pra njerëz të padëshirar në qytetet franceze.

Strukturimi i Islamit në Francë, sipas Macron-it, në vija të shkurtra do të thotë: afrim i pozicioneve liberaliste franceze me ato ultranacionaliste të Jean-Marie le Pen-it dhe bijës së tij Marine le Pen, sepse ideja e integritetit të myslimanëve në Francë, ku jetojnë mbi 6 milionë myslimanë është e pamundshme dhe e perealizueshme sipas këtij koncepti: nuk ka forcë e cila mund t'i detyrojë myslimanët të ushqehen në ndërmarrjet publike apo private në kuzhina të përbashkëta, ku përgatiten ushqime të ndaluar nga kultura dhe gastronomia myslimane. Nuk ka mundësi të realizohet në përpikëri larja e përbashkët meshkuj dhe femra në pishina, sepse në vendbanimet ku shumica e popullatës është myslimane ata e kanë ndërtuar edhe infrastrukturën e tyre, që nga restorantet, shkollat dhe institucionet kulturore. Myslimanët në Francë, në Belgjikë, në Mbretërinë e Bashkuar je-

tojnë në lagje të veçuara, të getoizuar, të diskriminuar; një pjesë e madhe e tyre edhe të papunë. Të gjendur jashtë proceseve shoqërore, ata janë të detyruar të jenë objekt i mashtrimeve të ndryshme dhe fitimit të parasë në mënyra jashtëinstitucionale; në raste të shpeshta, duke u marrë edhe me veprime terroriste.

"FRANCA ËSHTË BASHKËSI VLERASH"

Vështtrimet politike për identitetin nacional francez dallojnë nga mendimet e Jean-Marie le Pen dhe bijës së tij Marine le Pen. Franca me shekuj është sinonim i ndërtimit të shtetit sipas konceptit jakobinist të shtetit-kombit, ku përcaktohet se të gjithë qytetarët e tij janë francezë, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre gjeografike, etnike e religjioze.

"Franca nuk është një racë, nuk është bashkësi etnike. Franca është bashkësi vlerash (...) Franca është një union atdhesh, që bashkohet dhe japin një atdhe të madh" - deklaronte dikur në zgjedhjet presidenciale ish-presidenti francez Nikola Sarkozy.²⁾

Edhe pse konceptonet politike midis ultranacionalistëve dhe demokratëve e liberalëve dallojnë shumë për nga esenca dhe filozofia e zhvillimit ekonomik, kulturor e politik, herë pas here afrohen aq shumë, sa është vështirë të dallosh se cili kamp politik është autor i konceptioneve të njëjta për nga përmbajtja, varësisht nga konteksti kur ato plasohen në opinion. Po qe se këto ide plasohen pas zgjedhjeve (qofshin komunale, rajonale apo parlamentare ose presidenciale), vokabulari politik është më i butë, ndërsa kur prononcohen para zgjedhjeve, fjalori i tyre politik është shumë më i ashpër, nuk dalton nga provenienca politike.

Nga kjo shihet qartë se pse Macron doli në opinion me idenë e strukturimit të Islamit dhe të reformës iluministe të Islamit në Francë. Në zgjedhjet lokale në mars dhe qershor të këtij viti partia e tij "Republika në Ecje" pësoi disfatë në zgjedhjet lokale, ku kandidatët e saj ishin në vendin e dytë, të tretë apo të katërt. Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2017 ultranacionalistja Marine le Pen e ndoqi hap pas hapi presidentin Macron.

A thua në vitin 2022 "Republika në Ecje" do të vazhdojë të qeverisë me platformën e saj pas zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, do të varet shumë edhe nga qëndrimi i Macron-it ndaj imigracionit, myslimanëve etj. etj.

¹ Jean-Marie le Pen visionnaire: l' Islamisation de la France, Youtube, 21.04.2007, www.youtube.com

² Nicolas Sarkozy, www.youtube.com

MACRON SHPALL PLANIN PËR TË LUFTUAR 'SEPARATIZMIN ISLAMIK'

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka shpallur planin për ligje më të ashpra për të trajtuar atë që ai e quajti "separatizëm islamik" dhe për të mbrojtur vlerat laike të shtetit.

Në një fjalim, Macron tha se ekziston rreziku që një pakicë prej gjashtë milionë myslimanësh që jetojnë në Francë të formonin një "kundër-shoqëri", transmeton BBC.

Propozimet e tij përfshijnë mbikëqyrje më të rreptë të shkollimit dhe kontroll mbi financimin e huaj të xhamive.

Ai ka qenë nën presion për të adresuar çështjen e radikalizmit për shkak të frikës së sigurisë.

Por, komentet e tij u dënuan nga disa aktivistë myslimanë, të cilët e akuzuan atë për përpjekjen për të shtypur Islamin në vend.

Sipas parimeve të rrepta të laicizmit të Francës, qeveria ndahet me ligj nga institucionet fetare.

Ideja është që njerëzit me fe dhe besime të ndryshme janë të barabartë para ligjit.

Franca gjithashtu ka popullsinë më të madhe të myslimanëve në Evropën Perëndimore.

Duke folur jashtë Parisit, presidenti Macron tha se Islami radikal ishte një rrezik për Francën, sepse zbaton ligjet e veta para të gjitha ligjeve tjera dhe "shpesh rezultojnë në krijimin e një shoqërie kundër shoqërisë".

Ai tha se kjo formë e sektarizmit shpesh ilustrohet me fëmijë që ndalohen të shkojnë në shkollë dhe përdorimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe tjera të komunitetit si një "pretekst për të më-

suar parime që nuk përputhen me ligjet e republikës".

"Islami është një fe që është në krizë në të gjithë botën sot; ne nuk po e shohim këtë vetëm në vendin tonë", tha Macron.

Legjislacioni i propozuar nga Macron pritet të paraqitet në Parlament përpara fundit të vitit.

Masat e reja do të përfshijnë: një monitorim më të rreptë të organizatave sportive dhe shoqatave të tjera, në mënyrë që ato të mos bëhen një hapësirë për mesimet islame; ndaljen e dërgimit në Francë të hoxhallarëve nga jashtë; mbikëqyrje e përmirësuar e financimit të xhamive dhe kufizimin e mundësisë së shkollimit në shtëpi.

(Radio Evropa e Lirë, 2.10.2020: <https://www.evropaelire.org/a/30870954.html>)

HUMANITARJA FRANCEZE E KTHYER NGA MALI DEKLARON KALIMIN NË ISLAM

Pas gati katër vjet në Mali - rrëmbimi dhe robëria e së cilës u përdor nga publiku francez, veçanërisht nga e djathta franceze dhe Presidenti Macron pikërisht për të sulmuar Islamin - punëtorja humanitare franceze Sophie Petronin, 75 vjeçe, më në fund u la e lirë. Ajo u kthye në Francë, ku përveç familjes së saj u mirëprit edhe nga Presidenti Macron.

Por, ky i fundit u befasua kur Sophie i tha atij se ishte bërë myslimane dhe se Maria (Merjeme) po qëndronte para tij në vend të Sophie Petronin.

Faqja franceze në internet Révolutionpermanente citoi Sofinë të thoshte se ajo "veçanërisht do t'i lutej Allahut të bekojë shtetin e Malit dhe banorët e tij".

Ngjan ironik fakti që kjo befasi për Macron-in vjen bash në kohën kur ai po tenton të fut në veprim një projekt kundër atij që e quan "separatizëm islamik", një term i panjohur deri më sot dhe i pamundur për t'u zbërthyer se ç'kuptim ka. Krahas kësaj, ai tha se "Islami ishte në krizë kudo sot". Kjo deklaratë ngjalli reagime të shumta në botën islame, duke iu



argumentuar se nuk njihet krizë e Islamit.

Lirimin e Pétronin Macron synonte të shpallte një fitore personale të tij, nënkupto dhe ndaj Islamit, ndërkohë që tashmë ajo është bërë myslimane.

Sophie Pétronin është e njohur për ndihmën ndaj jetimëve dhe fëmijëve që vuajnë nga kequshqyerja. Ajo drejtoi misionin bamirës zviceran Aid to Gao.

Pétronin u arrestua në 2016 dhe tre persona të tjerë u lanë të lirë së bashku me të – ish-lideri i opozitës në këtë vend, Soumaïla Cissé dhe dy shtetas italianë, njoftuan autoritetet e këtij vendi. (10.10.2020)

Burimi: <http://tesheshi.com/cast-i-veshtire-per-macron-humanitarja-franceze-e-kthyer-nga-mali-i-deklaron-kalimin-ne-islam-video/>

TIMONIE TAKON MYFTI NESIMIN

Ambasadorin e Francës në Maqedoninë e Veriut, Kristian Timonie, në largim, më 11 tetor, 2020, realizoi një takim lamtumirës me Myftiun e Tetovës, z. Qani Nesimi. Gjatë takimit u konstatua cilësia e dialogut ndërfeetar, si dhe përkushtimi i përfaqësuesve fetarë për të ardhmen evropiane të Maqedonisë së Veriut.

Ky takim, njëherësh, ishte edhe rast i volitshëm për të prezantuar fjalimin e fundit të presidentit të Francës, z. Macron, në lidhje me luftën kundër tendencave separatiste dhe respektimin e shekullarizmit, e cila mbetet çimentoja e një France të përbashkuar, ku myslimanët e kanë vendin e tyre, duke mos i lënë që të tërhiqen në grackën e amalgamës, të vendosur nga polemistët dhe nga ekstremet që mëtojnë stigmatizimin e kësaj bashkësie – bëhet e ditur në komunikatën e Ambasadës së Francës në Shkup (Ambassade de France à Skopje) të publikuar në rrjetet sociale.



L'ambassadeur a pris congé du mufti de Tetovo, M. Qani Nesimi. A été constatée la qualité du dialogue interreligieux et l'attachement des représentants religieux à l'avenir européen de la Macédoine du Nord. L'entretien a été l'occasion de présenter le tout récent discours du président Macron, sur la

lutte contre les tendances séparatistes et le respect de la laïcité, qui reste le ciment de la France unie, où les Musulmans ont toute leur place, sans se laisser entraîner dans le piège de l'amalgame tendu par les polémistes et par les extrêmes consistant à stigmatiser cette communauté.

BIK, DEKLARATË PËR OPINION

Më 19 tetor, 2020, Bashkësia Islame e Kosovës ka dalë me një deklaratë për opinion, në të cilën thuhet: Në fillimin e muajit të datëlindjes së Pejgamberit tonë të dashur Muhamed, kur ne dhe mbarë bota islame ka filluar manifestimet për të përkujtuar, lexuar e studiuar biografinë e tij të ndritshme dhe mesimet e tij të shenjta, na vjen publikimi i karikaturave që ofendojnë pejgamberin Muhamed (a. s.) nga ambasadori ynë në Francë z. Qëndrim Gashi.

Për ne si Bashkësi Islame ky akt është i papranueshëm, i dënueshëm dhe një veprim i tillë vetëm sa e rrit mosdërimin, urrejtjen e mosbesimin ndërnjerëzor, ngase cenimi, ofendimi dhe atakimi i tjetrit, e sidomos kur kjo ka të bëjë me çështjen e besimit, nuk paraqet asnjë vlerë.

Populli ynë njih për vlerë kultivimin e tolerancës, mirëkuptimin, ba-



ambasadori ynë, z. Qëndrim Gashi, e jo të bëjë të kundërtën dhe me veprimet e tij t'i kontribuojë mosdërimin e urrejtjes me bazë fetare.

Kërkojmë nga Ministria e Jashtme që të distancohet nga veprimi i Ambasadorit Gashi, ngase konsiderojmë që me veprimin e tij ka atakuar vlerat dhe parimet mbi të cilat populli ynë me shekuj ka ngritur e kultivuar harmoninë e bashkëjetesës ndërfeetare.

Po ashtu dënojmë aktin kriminal ndaj mësuesit francez dhe në të njëjtën kohë angazhohemi që besimet tona mos të përdoren për urrejtje e mosdërim, por për bashkëjetesë, njohje, respekt e dashuri – përfundon Deklarata për opinionin e nënshkruar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës.

shkëjetesën e harmoninë ndërfeetare, që është shembull edhe për popujt tjerë. Harmonia ndërfeetare që ne kultivojmë me shekuj mund të jetë shembull i mirë edhe për popujt dhe shoqëritë tjera.

Këtë shembull të mirë e vlerë të kombit tonë do të duhej ta ndiqte edhe

Burimi:

<https://www.facebook.com/birk2015>

TURQIA PËRGGJIGJET ME SHKRIM



Përmes një komunikate të shkruar të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Turqia ka reaguar ndaj një p/ligji të përgatitur në Francë, duke thënë se ‘nuk i takon askujt që ta përdorë Islamit si subjekt të qasjeve të gabuara dhe shtrembëruara’.

Presidenti i Francës **Emmanuel Macron** njoftoi se me projektligjin mbi “luftën kundër separatizmit”, i cili do t’i paraqitet Këshillit të Ministrave më 9 dhjetor 2020, në Francë “do të ndërtohet një Islam iluminist”, thuhet në komunikatën me shkrim.

Nuk i takon askujt ta përdorë fenë tonë të shenjtë, që do të thotë ‘paqe’, për qasjet e gabuara dhe të shtrembëruara nën pretekstin e ‘ndriçimit’. Ne besojmë se mentaliteti, i cili përbën themelin e këtij projektligji, do të sjellë pasoja serioze, në vend të zgjidhjes së problemeve të Francës në këtë fushë.

Të supozosh se dikush mund të disiplinojë komunitetet e emigrantëve duke paraqitur koncepte të tilla si ‘Islami evropian’ dhe ‘Islami francez’, nën pretekstin e të ashtuquajturit ‘ndriçim’ të fesë islame, nënkupton në fakt të vepruarit në drejtim të kundërt me konsideratat humanitare dhe ligjore, vijon komunikata.

Shtetet nuk kanë të drejtë të përcaktojnë me ligj shërbimin fetar, që do të marrë gjithsecili gjatë praktikimit të besimit të tij dhe botëkuptimin fetar që ai ka përvetësuar. Ky mentalitet, i shkaktuar nga një keqlexim i fakteve sociologjike dhe historike, përpiqet të ushqejë më tej ksenofobinë, racizmin, diskriminimin dhe islamofobinë në rritje, të cilat janë problemet kryesore në Evropë dhe në Francë, si një burim me interes të përbashkët jo vetëm për shoqëritë e tyre, por edhe për të gjithë njerëzimin (është zgjidhja e tyre), thekson më tej komunikata.

Në vend që t’i shikojmë njerëzit dhe çështjet fetare vetëm nga perspektiva e sigurisë, ne besojmë se do të ishte më e drejtë dhe e dobishme të adoptojmë **retorika konstruktive**, që do të promovojnë në mënyrë dinjitoze nevojat shoqërore që kanë të bëjnë me **vlerat fetare dhe morale**. Duke ndjekur nga afër procesin në lidhje me këtë projektligj, ne do të vazhdojmë të sjellim në rend të ditës të metat e këtij p/ligji në platformat bilaterale dhe multilaterale me Francën. (5.10.2020)

Burimi: <https://www.trt.net.tr/shqip/turqia/2020/10/05/turqia-reagon-ndaj-p-ligjit-francez-per-luften-kunder-separatizmit-1502922>

DAGI: “ISLAMI S’MUND TË JETË NË KRIZË”

Si reagim ndaj deklaratave të presidentit francez Macron, Sekretari i Përgjithshëm i Unionit Botëror të Dijetarëve Myslimanë, **dr. Ali al-Kurre Dag**, shkroi sa më poshtë në mesazhin e tij drejtuar presidentit francez:

“Zotëri Macron, mos u shqetësoni për fenë tonë, Islamit, sepse Islami kurrë nuk është mbështetur tek autoritetet ose ta ketë ngritur shpatën e tij kundër kujtdo që refuzon ta pranojë atë, në mënyrë që t’i imponojë flamurin e tij me forcë.

Islami është një e vërtetë e përgjithshme, ekzistenciale, që zgjidh probleme që janë të pazgjidhshme nga autoritetet.

Është feja e Allahut, e jo një sistem qeverisje bazuar në gjendjen shpirtërore të elektoratit dhe falsifikimin e votave.

Islami është prania e vazhdueshme e arsyes, e argumenteve dhe mbrojtja e jetës dhe dinjitetit të njeriut. Ku ka liri, Islami është i mirë, dhe ku ka dhunë dhe tirani, Islami po përhapet gjithnjë e më shumë, pavarësisht tiranëve.

Macron, besimi ynë nuk po kalon, dhe as nuk do të kalojë ndonjë krizë, sepse Islami nuk është një shpikje njerëzore që të kesh frikë nga mangësitë, dëmtimet dhe pasimet e dobëta. Ai është Islam dhe kjo është e mjaftueshme. Islami ekziston përkundër intrigave të të tjerëve dhe përkundër islamofobisë.

Ne nuk kemi frikë për besimin tonë dhe as nuk është nevoja të kemi frikë, zoti President, për ata që flasin për ekzistencën e një krize.

Në vend të kësaj, ne ju themi: E ardhmja i përket Islamit! Ne kemi frikë vetëm për të ardhmen e atyre shoqërive që u janë nënshtruar feve të njerëzve...Kemi frikë për shoqëri të tilla me qeveri që varen nga krijimi i armiqve.

Na vjen keq për sundimtarin që nuk ndalet së jetuari krizë dhe që sheh luftërat fetare të Mesjetës, edhe pse jetojmë në shekullin e 21-të. Nëse ekziston një krizë e vërtetë, kjo është për shkak të standardeve të dyfishta të disa udhëheqësve politikë perëndimorë.

Ne duam t’ju kujtojmë se frenat e fuqisë dhe autoritetit në botën arabe dhe islame, në shumicën e vendeve, mbahen nga ata që krijuan ju, ose kryen grusht shteti që morën bekimin tuaj për të ardhur në pushtet përmes kufomave të njerëzve të pafajshëm.

Presidenti Macron, ju jeni në një krizë të çoroditjes morale, njerëzore dhe politike dhe Islami nuk mund të mbajë përgjegjësinë, as të mbajë barrën e liderëve të rremë dhe kukullave që krijuan kriza me sponsorizimin tuaj.”

Dijetari i lartë mysliman e mbyll mesazhin e tij ndaj Macron-it duke cituar një sure të Kuranit: “Gjykimi i përket vetëm Allahut dhe Ai ka urdhëruar që ju ta adhuronit vetëm Atë. Është e vetmja fe e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Jusuf: 40) (4.10.2020)

Burimi: <http://tesheshi.com/nje-reagim-ndaj-macron-e-di-ti-se-ceshte-islami-mesoje-z-president-eshte-feja-e-zotit/?fbclid=IwAR3OZ4BVjVkc42leKfihhg2cqrKAbp0awoTKhil5vYUZXEjjuWb7t-41wCQ>

NJË TENTATIVË POPULISTE PËR TË FITUAR ZGJEDHJET

Islami as është në krizë, as që mund të njolloset, të dobësohet, apo të ndryshohet... Përkundrazi, ai ka dy tipare vitale, edhe atë: kur sulmohet, forcohet; e kur lihet rehat, zgjerohet...E këtu ka qenë, është dhe do të jetë kjo fe hyjnore deri sa të jetë jeta...

Shkruan: Sali Shasivari
(Enkas për HeR)

Fjalimin e fundit të Presidentit francez **Emanuel Makron** në lidhje me Islamit si fe duhet analizuar dhe trajtuar mirëfilli. Ngase, tajmingu, rrethanat, përmbajtja dhe toni i fjalimit të bën të kuptosh se bëhet fjalë për urrejtje të thellë, frustracion të skajshëm dhe paranojë ekstreme të një “burrë shtetasi”, e cila, si e tillë, qet hije të rëndë mbi të tashmen e këtij populli dhe vendi konform nostalgjisë për të kaluarën. Nga Papa Urbani II e deri te Napoleon Bonaparta.

Siç e dimë, kryqëzatat u nxitën nga Papa francez Urbani II gjatë fjalimit të tij famëkeq në Këshillin e Klermontit (Concile de Clermont), që u mbajt në vitin 1095 në Francë, u nisën nën parullat e pastimit të Tokës së Shenjtë nga “paganët” dhe “barbarët”. Në këtë kontekst, mjafton të lexosh kronikat e murgut francez Robert Lemoine (i cili mori pjesë në Këshillin e Klermontit) me titull ‘**Historia Hierosolymitana**’ (Historia e Jerusalemit), në të cilat përshkruhen detajet e fjalimit të Papës Urbani II, si dhe kronikat e **Foucher de Chartres** (priftit francez i cili mori pjesë në Kryqëzatën e Parë), për të kuptuar se për çka, në të vërtetë, bëhet fjalë...

Më vonë, ‘ekspeditat ushtarake’ të Napoleon Bonapartës në Lindjen e Mesme (Egjypt, Siri dhe Palestinë) u zhvilluan nën pretendimin e lirisë, të drejtave dhe të riptëritjes së fesë së vërtetë. Kështu, në deklaratën e drejtuar popullit të Egjiptit në korrik të vitit 1798, Napoleoni mes tjerash ka thënë: “Njerëz të Egjiptit, juve ju

është thënë që unë kam ardhur këtu vetëm për të shkatërruar fenë tuaj; kjo është një gënjeshtëri; mos e besoni; tregojuni atyre se unë erdha të rivendos të drejtat tuaja dhe të ndëshkoj uzurpatorët; dhe se unë e respektoj Zotin, profetin e Tij dhe Kurandin më shumë sesa memlukët.” (Shih: *Wikisource – Declaration du general Bonaparte au people egyptien*, 1798)

Dhe, ja, nën ‘retë kolonialiste franceze’, Presidenti francez paraqitet në stilin e një Napoleoni të ri dhe me gjuhën e Papës Urbani II shpall ‘kryqëzatë’ të re ndaj myslimanëve, ndaj Islamit si fe, e cila, sipas tij, ‘përjeton krizë në të gjitha vendet ku është prezente’ dhe se e njëjta ‘duhet ristrukturuar dhe ndryshuar’!

Normalisht, përmes hapjes së këtij fronti të ri Presidenti Makron po luan rolin e ‘gjuetarit të shtrigave’, duke u munduar që përmes kësaj mendësie ta defokusojë vëmendjen e opinionit vendor dhe ndërkombëtar nga roli destruktiv i politikave aktuale franceze përkritazi me ngjarjet e ndryshme anekënd globit (si: në Siri, në Libi, në Mali, në Egjipt, në Algjeri, në Mesdhe, në ish-kolonitë e saj, në konfliktin aktual armeno-azerbejxhanas etj.), me ç’rast Franca del të jetë rreshtuar në anën e kundërt të vlerave demokratike dhe njerëzore, edhe atë duke përkrahur ashiqare diktatorë, puçistë, terroristë, agresorë etj.

Për më tepër, ai përmes këtij fjalimi mundohet ‘të hedhë pluhur syve’ karshi dështimit të tij - dhe vendit të tij - në planin politik, ekonomik dhe social; duke u munduar të gjejë ‘fajtor kujdestar’... gjithmonë në suaza të tentativave populiste për përfitimin e masave dhe fitimin e zgje-

dhjeve; ‘fajtor kujdestar’ ky i cili zakonisht nënkupton Islamit dhe myslimanët.

Një retorikë e këtillë nuk guxon të kalojë pa u demantuar publikisht dhe pa u ndëshkuar ligjërisht nga të gjitha institucionet relevante, si dhe nga të gjitha shtresat shoqërore, pa dallim kombi, feje apo race... Kjo, ngase fjalimet e këtuila shoviniste dhe fashiste nxisin urrejtje dhe konflikte me përmasa të paparashikueshme, pasojat e të cilave do t’i ndajnë të gjithë... sidomos në këto kohëra në të cilat jemi dëshmitarë të faktorizimit gjithnjë në rritje të së ‘dhatës ekstreme’, si dhe pasojat fatale që i ka shkaktuar ky faktorizim ndaj të huajve në përgjithësi, si dhe ndaj myslimanëve në veçanti, pasoja këto të cilat manifestohen - ditë e më tepër - me sulme të ndryshme verbale dhe fizike ndaj myslimanëve, simboleve të tyre, grave me mbulesë, fatoreve etj.

Sa i takon Islamit si fe universale, bisedat e këtuila as nuk e dëmtojnë e as që do të arrijnë ta ndryshojnë atë...Islami është bindje e ngulitur thellë në natyrën e pastër njerëzore, si dhe fe e shpallur dhe e garantuar nga Krijuesi i Gjithësisë...Ai (Islami) mund të akuzohet dhe të keqpërdoret me të padrejtë, por si i tillë ai as është në krizë, as që mund të njolloset, të dobësohet, apo të ndryshohet... Përkundrazi, ai ka dy tipare vitale, edhe atë: kur sulmohet, forcohet; e kur lihet rehat, zgjerohet... E këtu ka qenë, është dhe do të jetë kjo fe hyjnore deri sa të jetë jeta...

(Autori është studiues i politikave ndërkombëtare dhe jeton në Londër, Britani e Madhe)

SHABAN MURATI: NJË SHPIKJE E PRESIDENTIT MAKRON

Presidenti francez Makron më 2 tetor 2020 mbajti një fjalim, ku, siç njofton gazeta prestigjioze amerikane “Nju-Jork Tajms” e 2 tetorit, shpalli planet “për të zhvilluar një Islam të Francës”. Presidenti Makron brenda dy muajsh do të paraqesë edhe një ligj për këtë qëllim, sepse, siç shkruan revista e madhe amerikane “Nju-zuik”, “Makron don të krijojë ‘Islamit francez’”. Në fjalën e tij në 2 tetor presidenti francez nuk bëri të ditur nëse ai përveç “Islamit francez” ka plane për të

zhvilluar edhe katolicizmin francez, protestantizmin francez, ortodoksizmin francez, judaizmin francez etj.

Klasifikimi i fesë sipas emrave të shteteve qysh në pamjen e parë është idiotizëm, por përtej kësaj zbulon qëllimin e vërtetë të atyre udhëheqësve, kur shpallin se do të shtetëzojnë dhe do t’i venë emrin e shtetit vetëm një feje, asaj për të cilën kanë fobi.Emërtimi i fesë sipas emrave të shtetit është një idiotizëm, të cilin e kanë shumë qejf edhe levantinët në Shqipëri

dhe në Kosovë, që pretendojnë broçkullën “Islam shqiptar”. Nuk flasin dhe nuk pretendojnë kurrë për katolicizëm shqiptar, për ortodoksizëm shqiptar, për protestantizëm shqiptar, për judaizëm shqiptar etj. Islamofobia u dikton levantinëve shqiptarë klasifikimin me emrin e shtetit vetëm për fenë islame. Le të presin sa ta krijojë presidenti Makron modelin e “Islamit francez” dhe ta kopjojnë prej tij, që të bëhen tamam levantinë.

(Fcb, 6.10.2020)

HYJNIA E SHPIRTIT TË SHENJTË

Njeriu nuk vjen në këtë botë si mëkatar, por ai vjen me disa përgjegjësi dhe kjo është përgjegjësia e tij personale. Kjo është edhe në Kuran. Këtë pikëpamje e mbështet edhe arsyeja, se do të ishte padrejtësi e madhe të gjykohej e gjithë gjinia njerëzore për një mëkat të kryer mijëra vjet më parë, nga prindërit e parë.

Shkruan: Ibrahim Selmani

Sa i përket Shpirtit të Shenjtë, ai nuk është çështje e vendimit të Këshillit të Nikesëⁱ por mësimi në lidhje me të bazohet në tekstin e vendimit ku thuhet: “Njerëzit lihen të lirë të vendosin për Shpirtin e Shenjtë”. Për shkak të kësaj lirie, për të vendosur në lidhje me çështjen e Shpirtit të Shenjtë, dolën në pah dy tendenca të kundërta:

- njëra tendencë, që mbështeti idenë e trinitetit, duke pretenduar se të gjithë botën e drejtojnë tri fuqi: E para është Krijuesi; Intelekti (biri i Zotit) dhe Shpirti i Shenjtë. - tjetra tendencë, që tregon se Shpirti i Shenjtë nuk ka natyrë hyjnore, por është i krijuar dhe i tërhequr. Këto divergjencia ishin arsyeja për formimin e një këshilli të ri, në të cilin do të plotësohet dhe do të shpallet triniteti.ⁱⁱ

Prandaj, perandori e thirri këshillin në Kostandinopojë në vitin 381, ku morën pjesë rreth njëqind e pesëdhjetë kryepeshkopë. Në këtë vendim të këshillit në fjalë, i cili u mbajt në atë kohë, thuhet siç vijon:

“Shpirti i Shenjtë te ne nuk ka kurrfarë kuptimi tjetër përveçse shpirti i Zotit, kurse shpirti i Zotit nuk është asgjë tjetër përveçse jeta e Tij. Pra, nëse themi se Shpirti i Shenjtë u krijua, ne kemi thënë në të njëjtën kohë se edhe shpirti i Zotit u krijua. Nëse do të themi se shpirti i Zotit u krijua, ne kemi thënë se edhe jeta e Tij u krijua gjithashtu. Nëse do të themi se jeta e Tij u krijua, në këtë mënyrë do të mendonim se Ai nuk është gjallë. Nëse do të mendonim se Ai nuk është gjallë, atëherë Atë e kemi mohuar. E ai që e mohon Atë pa dyshim është i mallkuar.”ⁱⁱⁱ

NJË SERI TEOREMASH

Nga seria e këtyre teoremave shihet qartë postulati i Vendimit dhe besimi i

domosdoshëm në atë se Shpirti i Shenjtë është shpirt i Zotit, por kjo teoremë u hodh poshtë, sepse shumica e njerëzve nuk u pajtuan me të, sepse përfaqësuesi i saj nuk arriti ta arsyetojë atë me argumente të vlefshme. Nëse do të pranohej që Shpirti i Shenjtë është i përjetshëm, njëjtë si edhe Zoti At, kjo nënkupton se Shpirti i Shenjtë është person tjetër hyjnor dhe kështu mohohet hyjnia e Jezusit. Në këtë këshill nuk u dha asnjë mendim, e as që u mblodhën këshilltarët që më shumë të polemizojnë, por ata morën një vendim të prerë dhe të pandryshueshëm, dhe prandaj nuk është për t’u habitur se pse morën një vendim në lidhje me hyznizimin e Shpirtit të Shenjtë dhe mallkimin e atij që e kundërshton atë.^{iv}

Jezu Krishti, për të kryer misionin e tij dhe veprën e tij shpëtimtare, thonë të krishterët, e dërgoi Shpirtin e Shenjtë nga Ati, i cili veproi edhe para Krishtit, kurse ai zbriti në shpirtat e apostujve për të qëndruar me ta, duke thënë: “Nuk do t’ju lë që të mbeten jetimë; unë do të vij te ju”. (Ivani 14:16) dhe i flet të gjitha gjuhët e njerëzve përmes dashurisë, i cili në këtë mënyrë mbizotëron të gjitha gjuhët e njerëzve.^v

Gjithashtu, veprat e apostujve filluan, thonë të krishterët, ashtu siç filloi zanafilla e Krishtit, me zbritjen e Shpirtit të Shenjtë mbi virgjëreshën Maria. Dhe, kjo u bë kur Jezusi, përpara se të sakrifikojë vullnetarisht jetën e tij në këtë botë, bëri shërbesën apostolike dhe premtoi se do të dërgojë Shpirtin e Shenjtë që të dy të bashkohen në vepra ashtu që gjithmonë dhe kudo ta bëjnë atë të frytshëm.^{vi} Për këtë Ivani në ungjillin e tij predikon:

“Shpirtin e së Vërtetës, të cilin bota nuk mund ta pranojë, nuk e sheh dhe nuk e pranon kush. Ju e njihni atë, sepse te ju ai qëndron dhe është brenda jush”. (Ivani 14:17)

“Më në fund, kur erdhi dita e Rrëshaj-

jave, të gjithë u patën bërë bashkë në të njëjtin vend. Dhe ja, papritmas bubullimë nga qielli, njëjtë siç ngrihet era e fortë. E mbushi tërë shtëpinë ku ata ishin dhe iu shfaqën atyre si disa gjuhë të zjarra të copëtuara, kështu që zbriti nga një për çdonjërin prej tyre. Të gjithë u mbushën me Shpirtin e Shenjtë dhe filluan të flasin me gjuhë të tjera, ashtu siç iu jepte leje, tashmë, Shpirti, që të flasin.” (Veprat apostolike 2:1-4)

Ja, pra, në këtë mënyrë, këta këshilla i dhanë vetes të drejtë të krijojnë zota.

MËKATI I PARË DHE E KRYQËZIMIT TË Jezu KRISHTIT

Në Krishterim, mëkati i parë e ka prejardhjen nga Adami. Mëkatin i tij e kanë trashëgim të gjitha qeniet njerëzore, dhe prandaj kërkesa e drejtësisë së Zotit që ky mëkat i parë duhet patjetër të paguhet. E vetmja gjë që mund të fshijë mëkatin është derdhja e gjakut. Shën Pali thotë në lidhje me këtë:

“Dhe pothuajse të gjitha gjërat sipas Ligjit pastrohen me gjak, dhe pa derdhur gjak nuk ka falje” (Hebrenjve 9:22), por ky gjak duhet të jetë i përkryer, pa mëkate dhe i paprishur.

Në këtë mënyrë Jezu Krishti, “biri i Zotit”, i cili erdhi nga qielli, e derdhi gjakun e tij të shenjtë të pa mëkatuar, duroi vuajtjet e papërshkrueshme dhe u dashtë patjetër të bën shpengimin e çmimit të mëkateve njerëzore. Ngase Jezusi ishte Zot i pamatshëm dhe ai vetë e shpengoi çmimin e pamatshëm të mëkatin njerëzor. Askush nuk mund të shpëtojë nëse nuk e pranon Jezu Krishtin dhe shpengimin e tij. Çdonjëri është i gjykuar të durojë vuajtje të rënda në ferr nga e keqja e natyrës së tij mëkatore vetëm nëse ai nuk pranon shpengimin e mëkateve të tij nga ana e Jezusit dhe nga derdhja e gjakut të tij.^{vii}

Doktrina mbi mëkatin e trashëguar



nuk ka bazë në fjalët e Jezuit ose në fjalët e profetëve që kaluan para tij. Ata mësonin se çdo njeri do të jetë përgjegjës për veprat e bëra të tij, fëmija nuk mund të dënohet për mëkatet e babait.

Në librin e profetit Jeremi thuhet:

“Në ato ditë më nuk do të flitet: Etërit hanin rrush të thartë, e bijtë po i mpijnë dhëmbët”, por secili do të vdesë për mëkatin e tij; Kushdo që han rrush të thartë, secilit do t’i mpihen dhëmbët. (Libri i profetit Jeremi 31:29-30)

Profeti Ezekiel gjithashtu hedh poshtë dogmën e mëkatin të trashëguar me fjalë të ngjashme:

“Përsëri na erdhi fjala e Zotit, duke thënë: Çfarë dëshironi ju që tregoni rrëfimin mbi tokën e Izraelit, duke thënë: Etërit hanin rrush të thartë, e bijtë po u mpiheshin dhëmbët? Kështu unë isha gjallë, flet Zoti, ju nuk do t’i tregoni më këto rrëfime për Izraelin. Shikoni, të gjithë shpirtat janë të mitë - si shpirti i babait, ashtu edhe shpirti i të birit janë të mitë; e ai shpirt që gabon, ai do të vdesë”. (Libri i profetit Ezekiel 18:1-4)

Po, edhe vetë Jezusi i shikon fëmijët si të pafajshëm, e jo si të lindur në mëkat, thuhet qartë në fjalët e transmetuara:

“Duke revokuar këtë, Jezusi u zemërua dhe u tha atyre: Lërin fëmijët e vegjël të vijnë tek unë; mos i pengoni, sepse të tillët janë mbretëria e Zotit! Me të vërtetë, po ju them juve, kush nuk i pranon

mbretëritë e Zotit si fëmijë, jo, nuk do të hyjë në të assesi.” (Marku 10:14-15)

ISLAMI: FËMIJËT, PA MËKATE QË NGA LINDJA...

Islami e dënon dogmën mbi mëkatin e parë dhe fëmijët i konsideron të pastër dhe pa mëkate që nga lindja. Mëkati, thotë Islami, nuk është i trashëguar, por ai është diçka që secili e fiton për vete, nëse e bën atë që nuk guxon ta bëjë dhe nëse nuk e bën atë që duhet ta bëjë.

“E kush e punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë; e kush punoi ndonjë të keqe sa grimca, atë do ta gjejë.”^{viii}

Njeriu nuk vjen në këtë botë si mëkatar, por ai vjen me disa përgjegjësi dhe kjo është përgjegjësia e tij personale. Kurani në lidhje me këtë thotë:

“Thuaj: ‘A të kërkoj zot pos Allahut, e Ai është Zot i çdo sendi (ekzistues) dhe dëmi i secilit person është kundër vetes. Askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit. Mandej, kthimi juaj është te Zoti juaj; e Ai ju njofton për atëⁱ që përçaheshit.’^{ix}”

Këtë pikëpamje e mbështet edhe arsyeja, se do të ishte padrejtësi e madhe të gjykohej e gjithë gjinia njerëzore për një mëkat të kryer mijëra vjet më parë nga prindërit e parë. Mëkati është shkelje me vetëdije e dispozitës hyjnore, do të thotë, të dispozitës së të mirës dhe së të keqes.

Përgjegjësia ose faji duhet patjetër të bie vetëm mbi ata persona që e kanë bërë mëkatin, e assesi mbi fëmijët e tyre.

Është padrejtësi dhe hipokrizi e madhe të konsiderohen fëmijët mëkatarë që nga lindja, sa i padrejtë dhe mizor është njeriu pasi mund të besojë në dogmën e mëkatin të trashëguar. Për këtë dëshmon deklarata teologjike e Shën Augustinit, se çdo fëmijë i sapolindur i papagëzuar është i gjykuar të digjet në zjarr dhe ferr. Deri vonë fëmijët e sapolindur të papagëzuar nuk janë varrosur në tokën e shenjtë kishtarë, sepse besohej se kishin vdekur me mëkatin e parë.

Besojnë se njeriu e trashëgoi mëkatin e Adamit, dhe për këtë shkak Zoti e dërgoi “Birin e Tij të vetëm”, Jezu Krishtin, për ta shpenguar këtë mëkat, edhe atë me kryqëzimin e tij në kryq.

(Vazhdon)

ⁱ Këshilli i Nikesë u mbajt në vitin 325. Në këtë këshill u konstatua natyra hyjnore e Jezusit.

ⁱⁱ Dr. Ahmed Shelebi, vepër e cituar, fq. 121.

ⁱⁱⁱ Dr. Ahmed Shelebi, vepër e cituar, fq. 152.

^{iv} Po aty, fq. 152.

^v Dokumenti, Drugi Vatikanski Koncil, vepër e cituar, fq. 497.

^{vi} Po aty, fq. 498.

^{vii} Lexoni Ungjillin e Mateut 27:25-30; Ungjillin e Ivanit 3:16; Fletushkën Për romakët 3:23-25 e më tej 5:10.

^{viii} Ez-Zilzal: 7-8.

^{ix} El-En’am: 164.

NGA HESHTJA E PAFILLIMËSISË LIND MALLËNGJIMI HYJNOR

Do të ishte mirë që ne të ktheheshim në "shtëpitë tona", por shtëpia nuk ekziston deri sa nuk rikthehet shkalla e vlerave në personalitetin tonë, që u rrit me gjeneratat më të shkëlqyera myslimane dhe se njohja detyrimisht duhet të jetë segmenti kryesor për rikthimin tonë në arenën qytetëruese, me të cilën do të kemi mundësi që të prezantojmë dhe të reflektojmë primordialitetin e pejgamberit tonë të dashur.

Shkruan: Dr. Husein Rizai

Pejgamberi, si themelues i Islamit dhe i dërguari i shpalljes së Zotit për gjithë njerëzimin, është interpretuesi më i mirë i librit të Zotit. Hadithet dhe Sunneti i tij janë, pas Kuranit, burimi më i rëndësishëm i traditës islame. Për ta kuptuar Pejgamberin nuk është e mjaftueshme të studiohet vetëm këndvështrimi historik, por duhet që t'i tejkalojmë përmasat historike dhe të futemi në botën tejhistorike perreniale (- të përjetshme), që të krijojmë ekuilibrin e prototipit njerëzor me dimension metafizik.

Jeta shpirtërore e Pejgamberit është e fshehur pas natyrës njerëzore, pas detyrimeve të tij si udhëzues i njerëzve dhe lider i bashkësisë. Është funksion i pejgamberit të qenit jo vetëm guidë shpirtërore, por gjithashtu edhe organizator i një rendi të ri shoqëror me gjithçka që një funksion i tillë nënkupton. Është pikërisht ky funksion i qenies së tij, që e fsheh dimensionin e tij të pastër shpirtëror nga sytë e jomuslimanëve. Jomuslimanët e kanë kuptuar gjenialitetin e tij politik, oratorinë e tij të lartë, aftësinë e lartë të udhëheqjes, por pak prej tyre kanë kuptuar se si mund të jetë ai drejtues shpirtëror dhe fetar dhe se si mund që jeta e tij të merret si model nga ata të cilët synojnë shenjtërinë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në botën moderne, në të cilën religjioni shihet si i ndarë nga jeta publike dhe ku shumica e njerëzve modernë e kanë të vështirë ta imagjinojnë se si mund të përfshihet një qenie shpirtërore në aktivitetet intensive politike dhe shoqërore.

Në jetën shoqërore, në kuptimin e plotë të fjalës



Pejgamberi ka marrë pjesë në jetën shoqërore në kuptimin e plotë të fjalës. Ai u martua, ishte një kryefamiljar, ishte një baba, e mbi të gjitha ai ishte një udhëheqës dhe gjykatës që mori pjesë në shumë luftëra, në të cilat përjetoj prova të mëdha. Por, pavarësisht nga të gjitha këto veprimtari, zemra e tij mbeti gjithnjë në kënaqësi me hyjnore; ai vazhdoi së brendshmi të prehej në paqen hyjnore. Në fakt, pjesëmarrja e tij në jetën shoqërore e politike kishte si synim pikërisht integrimin e kësaj sfere në qendrën shpirtërore. Pejgamberi, gjithsesi, nuk kultivonte asnjë ambicie politike të kësaj bote. Ai ishte për nga natyra soditës. Para se të zgjidhej si pejgamber atij nuk i pëlqente të merrte pjesë në grumbullimet dhe aktivitetet shoqërore. Ai udhëhoqi

një karvan nga Meka për në Siri, duke kaluar përmes heshtjes madhështore të shkretëtirës, "pafundësia" e të cilit i nxit njerëzit drejt meditimit. Shpesh ai kalonte kohë të gjata në shpellën Hira në vetmi dhe meditim. Ai nuk e shihte veten se ishte për nga natyra një njeri i kësaj dynjaje, apo një nga ata kurejshitet e prirur drejt kërkimit të pushtetit politik, apo të kërkimit të famës shoqërore në rrethet e Mekës, ndonëse ai vinte prej një familje fisnike. Në fakt, ishte shumë e vështirë dhe e mundimshme për atë të pranonte barrën e përgjegjësisë së profetësisë, e cila nënkuptonte jo vetëm themelimin e një feje të re, por gjithashtu edhe themelimin e një rendi të ri politiko-shoqëror. Të gjitha burimet tradicionale dëshmojnë mundimet e mëdha që kaloi Pejgamberi

duke u përzgjedhur të marrë pjesë në jetën aktive në formën e saj më të lartë.

Në këto cilësi, të cilat ai i ka përfaqësuar në formë kaq të lartë, profeti është njëkohësisht prototipi i përsosmërisë njerëzore, shpirtërore dhe qytetëruese, përmes së cilit promovohet përgjegjësia universale si ummet-bashkësi, siç thuhet edhe në Kuran: "Ju jeni popull më i mirë i dalë për njerëzimin..."

Zoti, përmes këtij ajeti, bën një standardizim të përgjithshëm dhe unifikues të vlerave tejkohore dhe tejhapsinore.

Standardi i parë përmban: thirrje drejtuar myslimanëve që të jenë pararojë shpirtërore e qytetërim njerëzor, të cilët i detyron që ta udhëheqin këtë qytetërim njerëzor tashmë të pjekur frymërisht dhe për t'i treguar qytetërimin standardet më shkencore, më kulturore dhe më qytetëruese të jetës njerëzore. Që ta kryejnë këtë mision në mënyrë dinjitoze, myslimanët duhet të jenë dhe të mbeten në kulmin shkencor, kulturor dhe civilizues të botës, duhet të jenë "qyteti i ndritur i urtësisë dhe diturisë", në mënyrë që qytetërimi njerëzor të dijë se cila rreze e dritës duhet të jetë udhëzuese për jetën e tij.

Standardi i dytë është se myslimanët janë kultura dhe qytetërimi i Librit, sepse si një vulosës, Muhamedi (a. s.) ka sjellë formën e përkryer të botëkuptimit monoteist, që mbulon çdo aspekt të jetës njerëzore dhe në plotësi është sipas masës së jetës njerëzore, si dhe Muhamedi (a. s.) myslimanëve, si avangardë e tyre, u ka bërë të qartë se Islami nuk është vetëm një kulturë fetare, por edhe një kulturë shkencore.

Standardi i tretë është se botëkuptimi fetar islam apo "vetënjohja galaktike" e qytetërim njerëzor, e cila vazhdimisht duhet të rritet, të zhvillohet dhe të përqendrohet shpirtërisht, tregon se një gjë e tillë nuk është e mundur pa njohuri. Si rrjedhojë, ndërgjegjësimi është vlera e parë e Islamit, nga e cila burojnë të gjitha vlerat tjera.

Standardi i katërt është ai që i Dërguari i Zotit, i cili është edhe

vula e fundit, pret të ftuarit e Krijuesit në tryezën kuranore, sepse ajo solli të gjitha fjalët e Zotit, që do të thotë, në bazë të Logosit (ligjëritimit) gjithëpërfshirës të Zotit, ai përmes gjuhës njerëzore artikuloi botën primordiale të qytetërim njerëzor.

Standardi i pestë, i fundit, është se myslimanët gjenden në botë, por ende nuk janë 'qytetarë të botës' dhe se Zoti myslimanët nuk i bëri vetëm avangardë shpirtërore; ai i ka bërë ata edhe "qytetarë të botës".

MYSLIMANËT, SI "NDËRGJEGJE E BOTËS"

Sepse, Fjala gjithëpërfshirëse e Zotit nuk i përshtatet askujt si atij, të cilin Zoti e quan qytetari më i mirë i botës, mrekullia më e bukur. Myslimanët janë në botë, por bota ende nuk i pranon ata, përkundrazi, bota i dënon, i poshtëron, i fyen dhe i përndjek. Ata nuk ndikojnë në botën ose nuk flasin me botën. Ata nuk janë 'subjekt', 'personalitet', 'ndërgjegjja e botës'. Ata nuk kishin aftësinë për të arritur praninë në botë me vlerat dhe identitetet e tyre; bota e vodhi 'botën' e tyre, e mbingarkoi gjeografinë e tyre dhe ngriti mure që myslimanët mos t'i qasen asaj nga askund.

A munden myslimanët të kthehen në "shtëpitë e tyre", në qytetin e tyre të lindjes dhe në vendin e tyre, ashtu si Pejgamberi ynë u kthye në qytetin e tij - është një pyetje për të gjithë. Unë mendoj se do të ishte mirë që ne të ktheheshim në "shtëpitë tona", por shtëpia nuk ekziston deri sa nuk rikthehet shkalla e vlerave në personalitetin tonë, që u rrit me gjeneratat më të shkëlqyera myslimane dhe se njohja detyrimisht duhet të jetë segmenti kryesor për rikthimin tonë në arenën qytetëruese, me të cilën do të kemi mundësi që të prezantojmë dhe të reflektojmë primordialitetin e pejgamberit tonë të dashur.

Ditëlindja e Muhamedit (a. s.) është mundësia më e mirë për t'i kujtuar këto standarde dhe mënyrën se si zbatohen ato nëpërmjet traditës dhe ortopraktikës pejgamberiane.

MYFTINIA E SHKUPIT SJELL MEVLUDIN NË GJUHËN SHQIPE

Myftinia e Shkupit sjell për besimtarët islamë Mevludin në gjuhën shqipe, të kënduar nga hafëzi i mirënjohur i Shkupit, hafëz Emri ef. Hirda. Falë përkushtimit të stafit të vet, ky projekt i veçantë për nga forma e realizimit ofrohet me titrim dhe ilustrim artistik, për t'i bërë më të qarta, më të kuptueshme e më të kapshme vargjet që lexohen.

Mevludi që lansohet nga Myftinia e Shkupit është marrë për bazë nga mjeshtri i penës Tahir ef. Popova.

Në një komunikatë me shkrim, Myftinia e Shkupit ka thënë se pjesët e plota të Mevludit do të lansohen si premierë në faqen zyrtare të TVMyftinia pjesa e I e Mevludit: <https://www.facebook.com/myftiniashkuptv/videos/333327281289298/>


(11.10.2020)

HATME NË NEGOTINË

Në Xhaminë Qendrore të fshatit Negotinë të Pollogut 35 nxënës kanë përfunduar leximin në tërësi të Kuranit famëlartë. Më 11 tetor, 2020, me namazin e drekës, u mbajt solemniteti i hatmës, i përgatitur nga mualimi hfz. Muhamed ef. Hebibi. Diplomati i ndanë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe referentët e Myftinisë së Gostivarit. Duanë e bëri prof. Sherif ef. Deari, kurse programin e udhëhoqi referenti h. Sabahudin ef. Zendeli. Ky program u përcoll nga një numër i madh i besimtarëve dhe besimtareve.



NDIHMA E ALLAHUT (XH. SH.) KËRKOHEM QË TË MBROHEMI NGA DJALLI



Istiadheja (kërkimi i mbrojtjes) është një ndjenjë që e liron besimtarin islam nga të gjitha çështjet që i urren - qofshin fetare apo jetësore. Kërkimi i ndihmës dhe mbrojtjes nga Allahu (xh. sh.) zakonisht bëhet për të gjitha gjërat prej të cilave frikësohet njeriu, jo vetëm nga djalli.

Shkruan: Jusuf Zimeri

Çështja e parë, për të cilën na udhëzon dhe urdhëron Pejgamberi [alejhis-selam], që ta përdorim si mjet shumë të fuqishëm dhe efikas për mbrojtjen tonë, është kërkimi i ndihmës nga Allahu fuqiptotë, që në terminologjinë e Islamit njihet me nocionin “**el istiadhe**”. Përmes kësaj thënie besimtari islam kërkon mbështetje dhe mbrojtje ekskluzive prej Allahut (xh. sh.), që ta mbrojë nga të gjitha dëmtimet e mundshme, pavarësisht nga e kanë gjenezën ato. Përmes kësaj shprehje besimtari islam kërkon mbrojtje të sigurt për jetën e vet, për shëndetin e vet, për fenë e vet dhe për çdo gjë që është në dobi dhe interes të qenies njeri.

Istiadheja (kërkimi i mbrojtjes) është një ndjenjë që e liron besimtarin islam nga të gjitha çështjet që i urren - qofshin fetare apo jetësore. Kërkimi i ndihmës dhe mbrojtjes nga Allahu (xh. sh.) zakonisht bëhet për të gjitha gjërat prej të cilave frikësohet njeriu, jo vetëm nga djalli.

PËR MBROJTJE MJAFTON ALLAHU (XH. SH.)

Pra, përmes istiadhes besimtari islam praktikisht demonstroi besimin dhe bindjen e tij se për mbrojtjen e tij mjafton Allahu (xh. sh.) dhe atë që krijuesi e ka përfshirë në mbrojtjen e Tij, nuk ka mundësi që ta sfidojë ndonjë krijesë as nga bota e xhindeve, as nga bota e njerëzve. Përmes kësaj shprehje besimtari islam lirohet nga të gjitha energjitë negative. Kjo shprehje është mbrojtja më efikase e myslimanit nga ndikimi i djallit, nga xhindet dhe nga të gjitha forcat tjera të errëta, andaj atij i mbyllën të gjitha shtigjet e veprimtarisë dhe të manipulimit me shqiptuesin e kësaj fjale dhe nuk ekziston mundësia që ta pengojë nga zbatimi i urdhrave të Krijuesit absolut. Përmes kësaj shprehje Allahut (xh. sh.) e mësoi njeriu se, nëse dëshiron mbrojtje nga djalli, e vetmja mënyrë është ndihma dhe mbështetja tek Ai, andaj e urdhëroi njeriun duke i thënë:

وَأِمَّا يَنْزَغَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

“E nëse ty të ngacmon ndonjë ngacmim prej djallit, ti kërko mbrojtje prej Allahut, se vërtet Ai është dëgjuesi, i dijsmi!” (Fusilet: 36), ose ajeti:

وَقُلْ رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيَاطِينِ

“Dhe thuaj: ‘O Zot i im, unë mbrohem me Ty prej cytjeve të djajve!’” (Mu’minun: 97)

Përmes këtyre dy ajeteve kuranore Allahu fuqiptotë e mëson njeriun për mënyrën e mbrojtjes nga armiku i përherëshëm dhe i përjetshëm i tij, sepse ky armik nuk njihet gjuhë tjetër për komunikim me të e as mirësi. Kjo nënkupton se, kur njeriu kërkon ndihmën e Allahut (xh. sh.), do të jetë më i fuqishëm, edhe pse është i dobët; do të jetë më i mundshëm, edhe pse është i pamundshëm.

Besimtari duhet të jetë i durueshëm dhe i qëndrueshëm; nuk guxon që të bie në grackën e djallit dhe të hidhërohet për pak e për shumë dhe të nevrifikoset, sepse një gjë e tillë është prej djallit të mallkuar. Në lidhje me këtë, në transmetimin nga Ebu Hurejra (r. a.) thuhet që i dërguari i Allahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] ka thënë:

“Nuk është i fuqishëm ai që fiton në mundje (dyluftim), por i fuqishëm është ai që e mban (zotëron) veten në momentet e hidhërimit.” (Buhariu dhe Muslimi)

Në hadithin tjetër, të transmetuar nga

Sulejman ibn Suredi, thuhet: “Isha duke ndenjur me Pejgamberin [alejhis-selam], kur dy burra u shanë mes vete. Njërit prej tyre iu skuq fytyra dhe iu frynë venat. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] tha:

“Vërtet, unë di një fjalë, e cila, po të shqiptohet, do t’i shkojë (do t’i kalojë) ajo që ndjen.” I thanë atij: “Cila është ajo fjalë?” Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] tha: “Kërko mbështetje (ndihmë) nga Allahu, që të të mbrojë prej djallit të mallkuar.” (Buhariu dhe Muslimi)

I dërguari i Allahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] ka thënë: “Vërtet, hidhërimi është prej shejtanit, e shejtani është i krijuar prej zjarrit; vërtet, zjarri fiket me ujë, andaj, nëse ndonjëri prej jush hidhërohet, le të marrë avdes.” (Ebu Davudi)

Istiadheja (kërkimi i mbrojtjes), përveç se është armë mbrojtëse e besimtarit islam, ajo konsiderohet edhe pastrim për gojën dhe gjuhën e tij nga ndyrësit që i ka përbijë njeriu duke folur fjalë të liga apo që nuk i takojnë t’i flasë një besimtari islam. Përmes istiadhes, praktikisht shprehet njohja e Fuqisë Absolute dhe mbështetja tek ajo fuqi; ndërsa në anën tjetër, njeriu pranon dobësinë dhe pamundësinë e tij për t’u përballuar anomalive të përhershme gjatë jetës. Njeriu si krijesë e përsosur jeton mes frymëzimit engjëllor dhe pëshpëritjes së djallit, andaj detyrimisht duhet të marrë qëndrim dhe të përcaktohet për njërën palë, prandaj me përcaktimin e tij që të kërkojë ndihmën e Allahut, e pamundëson pëshpëritjen dhe cytjen e djallit, duke mos i dhënë qasje atij.

ISTIADHEJA, ME NDIKIM TË MADH FRYMËZUES

Istiadheja ka ndikim të madh frymëzues në mendjen dhe shpirtin e njeriut dhe, si e tillë, ajo shkakton një siguri psikike dhe qetësim shpirtëror në momentet e hidhërimit. Në lidhje me këtë, Imam Nisaiju në koleksionin e tij regjistron një hadith të transmetuar nga Ubeje b. Ka’bi, i cili ka thënë: U fjalosën dy njerëz te Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] dhe njërit prej tyre nga hidhërimi i ishte skuqur edhe hunda. I dërguari i Allahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] në këtë rast tha: “Unë e di një gjë, të cilën, po ta thotë i hidhëruari, do t’i ikë ajo që e ka kapluar (hidhërimi). Ta thotë fjalën: ‘Eudhu bil-lahi mineshejtanir-raxhim.’” (Nesaiju)

Në një hadith tjetër, ndërkaq, të regji-

struar tek Imam Buhariu, i transmetuar nga Sulejman b. Sardi, thuhet se ka thënë: Derisa ne ishim ulur te Pejgamberi [alejhis-selam], u ofenduan dy njerëz mes vete dhe njëri, i skuqur nga inati dhe hidhërimi, e ofendoi (shau) tjetrin. Pejgamberi [alejhis-selam] në këtë rast tha: “Vërtet unë e di një fjalë, të cilën, po ta thotë ai (i hidhëruari), do t’i shkojë hidhërimi: ‘Eudhu bil-lahi mineshejtanir-raxhim.’” Të pranishmit që ishin, i thanë njeriut të hidhëruar: A nuk po e dëgjon çka po flet i dërguari i Allahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme]? Mirëpo ai, i inatosur, tha: Unë nuk jam i çmendur.

Imam Muslimi në sahihun e tij regjistron ngjarjen e Othman b. Ebu As Eth-thekafiut, i cili kishte ardhur te Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] dhe i kishte thënë: O i dërguar i Allahut, vërtet shejtani më është paraqitur mes meje dhe namazit tim dhe ma ngatërronte leximin e Kuranit. I dërguari i Allahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme] i tha: “Ai është shejtani, i cili quhet Hanzeb dhe kur të ndiesh se të është afruar, kërko mbrojtje nga Allahu prej tij, dhe pështyje tri herë në anën e majtë.” Othmani tha: Unë e bëra këtë që më mësoi i Dërguari (a. s.) dhe Allahu (xh. sh.) e largoi prej meje.

Përveç kësaj që u theksua, istiadhen Pejgamberi [alejhis-selam] shpeshherë e përdorte edhe për mbrojtje nga punët e liga, që e dëmtojnë besimtarin islam. Pejgamberi [alejhis-selam] shpeshherë i citonte këto lutje: “O Zoti im, vërtet unë kërkoj mbrojtje prej Teje, që të më mbrosh nga varfëria, nga pakësimi dhe nënçmimi; po ashtu kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos dëmtohem ose mos të dëmtoj.” (Ebu Davudi, Nesaiju dhe Ibni Maxheh) Pastaj lutja: “O Zoti im, unë kërkoj mbrojtjen tënde nga pamundësia dhe përtacia, nga frika dhe pleqëria, nga ndëshkimi i varrit; kërkoj mbrojtje nga fitneja e jetës dhe e vdekjes.” (Buhariu dhe Muslimi)

Istiadheja është edhe një formë e lutjes, pavarësisht se ajo bëhet për të shoqëruar të mirat, apo për t’u mbrojtur nga të ligat dhe të këqijat. E vërteta e kërkimit të mbrojtjes nga Allahu (xh. sh.) është ajo kërkesë që në vete përmban kuptimin e besimit dhe të bindjes në Zot. Kërkimi i ndihmës shkon drejt vetëm nëse kjo kërkesë me bindje dhe besim i drejtohet Allahut (xh. sh.), me mbështetje të plotë, sepse Allahu (xh. sh.) i pranon nën mbrojtjen e Vet ata që i binden Atij, që besojnë vetëm Allahun dhe që u nënshtrohen urdhrave të Tij.

PA IDEOLOGJI DOGMATIKE

Pjesa e ajetit “pa sjellë për ta (për zotat e rrejtshëm) ndonjë argument të qartë”, flet për tendencën e banorëve të shpellës për të prekur gjënë më të rëndësishme në proceset e ndryshimit - paradigmen e të menduarit, pra, në një mënyrë ata u thoshin se kjo formë e të menduarit është gabim, prandaj ata insistonin që të ndryshojë paradigma e të menduarit dhe atëherë besimi natyrisht do të depërtojë në zemrat e tyre. Fatkeqësisht, sot shumë popuj përpiqen të bëjnë ndryshime rrënjësore e përparimtare me mentalitet dhe mendësi të përfunduar.

Shkruan: Dr. Ziber Lata

﴿هُؤُلَاءِ قَوْمًا اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ ءَالِهَةً لَوْلَا يَأْتُونَ عَلَيْهِم بِسُلْطٰنٍ بَيِّنٍ فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ افْتَرَىٰ عَلَىٰ آلِهَةٍ كَذِبًا﴾
“Këta, populli ynë, morën në vend të Tij zota tjerë, pa sjellë për ta ndonjë argument të qartë. E kush është më zullumqar se ai që trillon ndaj Allahut gënjeshtër?”

Pjesa nismëtare e këtij ajeti “Këta, populli ynë” tregon se ata qëndrimet e tyre i paraqitën në prani të popullatës, jo nëpër skuta apo vende të mbyllura. Ata hulumtuan dhe menduan gjatë për ta arritur këtë ditë. Ky çast përbënte momentin kyç të jetës së tyre, sepse tani i gjithë populli do të dëgjonte për besimin e tyre. Kjo, gjithashtu, flet për një kriter tjetër të pranimit apo të refuzimit të ideve. Nëse ato pranohen nga masa, atëherë mund të jenë funksionale; nëse refuzohen, atëherë janë jofunksionale. Pra, banorët e shpellës e dinin se çfarë duhet bërë për t’i vënë në jetë idetë e tyre.

Etimologët dhe leksikologët arabë kanë diskutuar shumë për domethënien thelbësore të fjalës قَوْمٌ *kaumun* (popull), duke e dalluar atë nga sinonimet tjera të përafërta شَعْبٌ *sha’bun* (popull) dhe أُمَّةٌ *ummetun* (popull-ummet).

Etimologjia e fjalës شَعْبٌ *sha’bun* (popull) është me dy kuptime antonimike: ndarje dhe bashkim.¹ Quhet kështu sepse kur populli shihet nga afër, duket se është i ndarë në shumë pjesë përbërëse; por, kur shihet nga larg, atëherë duket i bashkuar. Termi *sha’bun* duket më shumë si term administrativ apo politik për një popull, edhe nëse nuk jetojnë në një shtet. Ky në Kuran përmendet vetëm shumë herë وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا... وَقَبَائِلًا. **“ju bëmë popuj e fise...”**

Fjala *ummetun* më shumë lidhet me përkatësinë fetare, ideologjike apo gjuhësore, pra, fjala *ummetun* përfshin epiqendrën ku lidhen apo mbështeten shumë gjëra të të njëjtit lloj, prandaj nëna quhet أُمَّةٌ *ummun*, sepse nga ajo dëgëzohen apo puqen të gjithë fëmijët e



saj. Në përgjithësi, kjo përfshin degëzimet fetare: *ummeti* i Muhamedit, *ummet* i kufrit etj.

FOKUSIMI, TE STRUKTURAT ELITARE TË NJË POPULLI

Ndërsa fjala قَوْمٌ *kaumun* rrjedh nga rrënja që nënkupton: qëndrueshmëri, vlerë, ngritje dhe drejtësi, apo ata që menaxhojnë apo mund të menaxhojnë me këto çështje madhore, prandaj shumë dijetarë fjalën قَوْمٌ *kaumun* e shohin si sinonim të fjalës رِجَالٌ *rixhalun* (burra).² Edhe pse, sipas disa etimologëve të tjerë, brenda kësaj fjale mund të hynë edhe gratë, përsëri fokusimi nuk është te gjinia, por te strukturat elitare të një populli që udhëheqin me vlerat e asaj shoqërie.

Kur i kemi parasysh këto dallime, atëherë kuptojmë përse banorët e shpellës dhe të gjithë pejgamberët e kanë thirrur popullin e vet me fjalën يَا قَوْمٌ “o populli im!”. Kështu ata i kanë folur gjithë popullit, por në veçanti atyre që kanë qenë ajkë e shoqërisë, të cilët kanë menaxhuar me punët e shoqërisë, e që atëkohë kanë qenë kryesisht burra. Ata nuk i thirrën يَا أُمَّتِي “o populli im!”,

sepse nuk ishin të një besimi, as يَا سَعْيِي “o populli im!”, sepse kjo e fundit më shumë është term administrativ dhe i thatë, kurse ata me shprehjen يَا قَوْمٌ “o populli im”, përveç që tregonin se janë pjesë e atij populli, ata në një mënyrë shprehnin edhe keqardhje, dhembshuri dhe vlerësim për ta. Pothuaj në të gjitha rastet në Kuran fjala قَوْمٌ *kaumun* (popull) përdoret për popujt e devijuar, por kjo nuk e mohon të kundërtën.

Nga kjo, gjithashtu, mësojmë se banorët e shpellës nuk folën me gjithë popullin, por me parinë e popullit, me ata që i menaxhonin. Këtu nuk flitet vetëm për menaxhim politik, por edhe për kryesuesit e familjeve.

Janë disa elemente që tregojnë se fjalimi i banorëve të shpellës nuk ishte tendencioz, por tepër i sinqertë dhe dashamirës. Vetë lidhja e fjalës قَوْمٌ *kaumun* (popull) me përemrin pronor أَنَا *na* (ynë), tregon se mes folësit dhe dëgjuesit ka një lidhje të fortë, sepse forma قَوْمًا (populli ynë!) është edhe trajtë përkëdhelëse dhe shpreh dhembshuri. Po ashtu, përdorimi i përemrit dëftor për afër هٰؤُلَاءِ *haulai* (këta), tregon se ata vërtet kishin qëllim këshillimin, sepse në këto raste përdoret

اولئك *ulaike* (ata) për shkak të ndryshimit në besim, por ata përsëri kërkonin afërsi me popullin. Këtë e tregon edhe fakti se ata ndoshta mund të largoheshin edhe në një mbretëri tjetër të asaj kohe, por nga dëshira për të qëndruar pranë popullit të vet, u fshehën në shpellë për të menduar një zgjidhje, prandaj Allahu (xh. sh.) në fund ua plotësoi dëshirën atyre për t’u kthyer te populli dhe për t’i parë ata besimtarë.

Në pjesën ku flitet se populli i banorëve të shpellës morën zot tjetër përveç Allahut, është përdorur folja أَخَذُوا *it-tehadhu* (morën) dhe jo أَخَذُوا *ehadhu* (morën). Dallimi qëndron në atë se folja أَخَذُوا *ehadhu* është antonim i *dhënies* dhe nënkupton marrje me forcë apo dhunshëm, kurse folja أَخَذُوا *it-tehadhu* nënkupton marrje me dëshirë dhe vullnet. Prej kësaj kuptohet se populli i banorëve të shpellës me dëshirë dhe me vullnet kishin zgjedhur të adhuronin dikë tjetër në vend të Allahut, kurse banorët e shpellës debatonin me njerëz që kishin zgjedhur vetë besimin dhe bindjen e tyre. Pra, kjo na mëson gjithashtu se çdoherë duhet të flasim me njerëz që kanë liri besimi, apo dinë të vendosin vetë.

Parashtrohet pyetja: përse thuhet “morën zota tjerë në vend të Tij” dhe jo “adhuruan zota tjerë në vend të Tij”?

Banorët e shpellës ishin të vetëdijshëm se çfarë dëshironin. Nëse ata do të thoshin “adhuruan zota tjerë në vend të Tij”, atëherë do të kuptohej se populli i tyre vetëm nëpër faktore kanë zota tjerë, sepse adhurimi atëherë bëhej vetëm nëpër faktore; mirëpo përmes fjalisë “morën zota tjerë në vend të Tij”, nënkupton se ata dëshironin ndryshim rrënjësor në jetën e tyre dhe jo vetëm nëpër faktore. Ata e dinin se ai që beson Një Zot të Vetëm jashtë faktore, do ta adhurorë Atë edhe në faktore. Pra, ata kërkonin të bëjnë ndryshim rrënjësor në besimin e tyre, i cili do të reflektonte edhe jashtë faktore dhe jo vetëm brenda saj.

Kjo skenë e kësaj ngjarjeje është një përsëritje tipike për çdo kohë; sepse, lënia mënjanë e Zotit të Vërtetë dhe vënia pas zotave të rrejtshëm është një fenomen i vazhdueshëm në këtë botë - jo rastësisht fjala اٰلِهَةٌ *alihetun* (zota) është dhënë në shumës, për të treguar se çdoherë kur nuk besohet Zoti, atëherë vijnë në shprehje shumë zota. Përveç kuptimit nga këndi i besimit, ky ajeti na frymëzon të kuptojmë realitetin se nëse nuk i përmbahemi rrugës së Zotit, atëherë para nesh do të na shfaqen shumë rrugë: materializmi, karriera, pushteti, fama, pasuria, biznesi, epsi etj.

PËRSE ZOTI NA FALI MENDJEN?

Pjesa e ajetit “pa sjellë për ta (për zotat e rrejtshëm) ndonjë argument të qartë”, flet se banorët e shpellës u kishin ofruar prova që ishin të qarta, sepse nuk ka si e konsideron argumentin e tjetrit të paqartë nëse nuk sjell vetë argument të qartë. Ata bënë përpjekje ta shmangin popullin nga besimi i verbër dhe mitologjik, duke u ofruar një besim të ndërtuar mbi argumente të qarta. Kur jemi në këtë temë, vlen të thuhet se doktrina islame e kundërshton fuqishëm dogmatizmin dhe racionalizmin e skajshëm, sepse i pari të shtyn drejt verbimit në besim, pa e përdorur fare racion, kurse i dyti të çon drejt verbimit në racio, duke iu dorëzuar tërësisht parametrave logjikë. Kështu, të dyja rezultojnë të jenë ideologji dogmatike. Nëse do ishte i rëndësishëm vetëm besimi dogmatik, atëherë përse Zoti na fali mendjen? Po ashtu, nëse do të mjaftonte logjika, atëherë përse Zoti na solli shpalljen? Kjo të jep të kuptosh se Allahu vërtet i ka falë njeriut mendjen për ta ndarë të mirën dhe të keqen në përgjithësi, por jo në tërësi, sepse mendja është krijesë e cila përmes perceptoreve të saj furnizohet nga rrethanat e jashtme relative, të cilat pastaj pa dashje marrin anë, varësisht si furnizohet, kurse nevojat njerëzore shpeshherë e kalojnë relativitetin njerëzor dhe kërkojnë një Gjykues i Cili do të ndajë të mirën nga e keqja pa qenë i ndikuar aspak nga koncepti kohë, nga rrethanat apo situatat relative.

Po ashtu, pjesa e ajetit “pa sjellë për ta (për zotat e rrejtshëm) ndonjë argument të qartë”, flet për tendencën e banorëve të shpellës për të prekur gjënë më të rëndësishme në proceset e ndryshimit - paradigmen e të menduarit, pra, në një mënyrë ata u thoshin se kjo formë e të menduarit është gabim, prandaj ata insistonin që të ndryshojë paradigma e të menduarit dhe atëherë besimi natyrisht do të depërtojë në zemrat e tyre. Fatkeqësisht, sot shumë popuj përpiqen të bëjnë ndryshime rrënjësore e përparimtare me mentalitet dhe mendësi të përfunduar.

Për argumentimin e çështjeve të caktuara Kurani përdor fjalë të ndryshme: بُرْهَانَ *burhan*, سُلْطَانَ *sultan*, دَلِيلٌ *delil* dhe هُخْخَههه *huxhxeh*. Të gjitha këto fjalë e kanë kuptimin e *argumentit*, por secila ka nuanca kuptimore anësore, e cila pastaj e përcakton llojin e argumentit.

Fjala دَلِيلٌ *delil* nënkupton diturinë apo shënjeshtër që orienton drejt një diturie tjetër, i cili mund të jetë argument logjik, tradicional, provë konkrete, argument i saktë apo gabim.³ Kjo fjalë është përdorur vetëm një herë në Kuran.

Në dallim nga *delili*, “fjala burhan nënkupton argumentin përmes të cilit arrihet një informacion apo dituri e saktë, në të cilën nuk ka dhe as që mund të paramendohet (të ketë) ndonjë dyshim. Sferë e burhanit është shkencë dhe jo intuita, si p.sh. informacioni se numri dy është më shumë se një etj.”⁴ Ragib el-Asfahani, duke i kategorizuar argumentet, pohon se *burhani* është fjala që përfaqëson argumentin më të denjë dhe më të fuqishëm të mundshëm⁵, me të cilin i bën ballë kundërshtarit.

Fjala هُخْخَهه *huxhxhetun* (argument) përdoret atëherë kur përplasen dy gjëra të kundërta, ndërsa ky zgjedh njërën.

Rrënja e fjalës سُلْطَانَ *sultan* (argument) nënkupton forcën, fuqinë dhe epërsinë.⁶ Udhëheqësit quhen sulltanë sepse përmes tyre jetësohen argumentet dhe realizohen të drejtat.⁷ Imam Ragib el-Asfahani thotë: “Argumenti quhet *sultan* për shkak të ndikimit në shpirtin, por më shumë dominon te dijetarët dhe urtarët nga radhët e besimtarëve.”⁸ Imam Reshid Rida, ndërkaq, thotë: “*sultani* është argumenti i qartë, i cili ka pushtet mbi mendjen dhe zemrën.”⁹

Kur i sheh të gjitha këto fjalë me sinonimi të përafërt, atëherë mund të vijmë në përfundimin se fjala *sultan* dallohet me dy nuanca kuptimore: me dominimin dhe me hapësirën e ndikimit në zemër.

(Vazhdon)

¹ Ibn Faris, *Mu’xhemu mekajisi el-lugati*, vëllimi III, Daru el-Fikr, fq. 190-191.

² Ahmed bin Muhammed el-Fejumi, *El-Mis’bahu el-muniri*, Liban-Bejrut, Mektebetu Lubnan, 1987, fq. 198-199.

³ Abdul Kadir Abdulhamid El-Kajsij, “El-Burhanu ve is’tidlatuhu fi el-Kur’an”, në revistën: “Mexhel-letu kljijeti el-ulumi el-islamijeti”, nr. XVI, fq. 274.

⁴ Ebu Hamid El-Gazali, *Ihjaw ulumi ed-dini*, vëllimi I, fq. 73.

⁵ Ragib el-Asfahani, *Mufredatu elfadhu el-Kur’ani*, 121.

⁶ Ibn Faris, *Mu’xhemu mekajisi el-lugati*, vëllimi I, Daru el-Fikr, fq. 567.

⁷ Ibn Mendhur, *Lisanu el-Arebi*, vëllimi VII, fq. 320.

⁸ Ragib el-Asfahani, *vep. e cit.*, fq. 420.

⁹ Reshid Rida, *Tefsiru el-menar*, vëllimi VIII, fq. 397.

ATY KU XHAMITË KALOJNË EDHE NË PRONËSI TË KISHËS!...

Fatin e xhamive do ta pësojë edhe Vakëfi. Vakëfi thuhet të asgjësohet ose do të tëhuajësohet dhe do të merret tërësisht nga administrimi i Myftinisë. Nëpër vendbanimet myslimane do të ngelin disa xhami të hapura për shërbim, por edhe ato nga pamundësia financiare e myslimanëve për t'u mirëmbajtur dhe për shkak të obstrukcioneve të ndryshme nga administrata shtetërore, do të jenë në gjendje të mjerueshme.

Myftinia e Shtipit është njëra nga trembëdhjetë myftinitë e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qendra e Myftinisë gjendet në Shtip, por territori i saj është shumë i gjerë dhe përfshin diku një të tretën e Maqedonisë së Veriut. Ky territor, krahas faktit se është i gjerë, po ashtu njihet edhe si pjesë e shtetit ku myslimanët ballafaqohen me më shumë probleme edhe në dimensionin fetar, por edhe në dimensionin ekonomik, social, kulturor, edukativo-arsimor, etj., sfida këto të cilat edhe pse shpeshherë i tejkalojnë kufijtë e përgjegjësisë të Myftinisë, Myftinia, sipas mundësisë që i ka në dispozicion, gjithmonë përpiqet t'u japë përkrahje myslimanëve të kësaj ane, që sa më lehtë t'i përballojnë ato.

Myftinia e Shtipit deri në vitin 2003 ka qenë administruar nga myftiu i Myftinisë së Kumanovës, por në vitin 2003 myftiu i Myftinisë së Shtipit do të emërohet ish-myftiu i Myftinisë së Kumanovës Isa ef. Ismaili, autoritet ky i cili do të japë një kontribut të madh në ndërtimin dhe rindërtimin e xhamive, në angazhimin për përgatitje të kuadrin fetar, në ruajtjen dhe kthimin e vakëfeve dhe pronave të Bashkësisë Fetare Islame dhe në ngritjen e vetëdijes dhe të kulturës fetare islame. Myftiu Isa ef. Ismaili në këtë detyrë do të shërbejë deri më 26.12.2017, kurse në vend të tij do të emërohet mr. Nasir ef. Rexhepi.

Viset të cilat janë nën Myftininë e Shtipit po ashtu njihen si pjesë ku banorët gjatë periudhës pas largimit të Perandorisë Osmane janë ballafaquar me peripeci dhe mundime të shumta nga regjimet e ndryshme të kohës. Një pjesë shumë e



Xhamia e fshatit Radanjë-Shtip para rindërtimit

madhe, si pjesë e projekteve famëkeqe për ta ndërprerë lidhjen e myslimanëve të ngelur në vendet tjera të Ballkanit me botën islame, ka qenë shpërngulja e tyre për në Turqi. Kështu, vendbanime dhe fshatra të tërë për një kohë të shkurtër janë zbratur nga myslimanët. Edhe qytetet në të cilat myslimanët kanë qenë shumicë, si: Shtipi, Strumica, Vinica, Koçani, Radovishi etj., po ashtu do të pësojnë fatin e njëjtë dhe numri i myslimanëve do të bjerë në mënyrë drastike. Shpërnguljet e shumicës së myslimanëve do të lënë pasoja negative edhe për trashëgiminë fetare, por edhe për myslimanët e ngelur në vendlindje. Një numër i madh i xhamive do të rrënohen tërësisht, disa të tjera do mbyllën ose do të shfrytëzohen për qëllime krejtësisht të tjera - si depo, galeri arti etj.; madje ka raste, si për shembull

Xhamia e Husamedin Pashës në Shtip, kur ato do të kalojnë edhe në pronësi të Kishës! Fatin e xhamive do ta pësojë edhe Vakëfi. Vakëfi thuhet të asgjësohet ose do të tëhuajësohet dhe do të merret tërësisht nga administrimi i Myftinisë. Nëpër vendbanimet myslimane do të ngelin disa xhami të hapura për shërbim, por edhe ato nga pamundësia financiare e myslimanëve për t'u mirëmbajtur dhe për shkak të obstrukcioneve të ndryshme nga administrata shtetërore, do të jenë në gjendje të mjerueshme.

MYFTINIA, ZËRI KRYESOR I POPULLATËS MYSLIMANE

Myslimanët e kësaj ane i takojnë shtresës më të varfër, me probleme elementare për arsimim, punësim; me probleme të llojllojshme sociale e me sfida të

ndryshme të kohës - të papunë, të detyruar të merren me punë dhe veprimtaritë më të vështira, të përbuzur dhe të nënçmuar etj. Ky fat do ta ndjekë edhe kuadrin fetar. Në ato pak xhami funksionale, të hapura për shërbim, kryesisht do të shërbejë kuadrin fetar i paarsimuar, i cili ato pak dije dhe njohuri për praktikën fetare i ka të trashëguara nga prindërit ose gjyshërit e tyre.

Këto dhe shumë sfida të tjera do të jenë shkas dhe shtytës që Myftinia e Shtipit vazhdimisht të përpiqet të ballafaqohet me ato dhe të mundohet të gjejë zgjidhje dhe shtigje për të dalë nga të njëjtat. Myftinia, në të njëjtën kohë, do të bëhet edhe zëri kryesor i popullatës myslimane për të tërhequr vëmendjen edhe të faktorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë - në veçanti Republikës së Turqisë - që kjo situatë në mos më shumë, sado pak të ndryshojë.

Myftinia, nëpërmjet ndihmave, edhe pse të kufizuara, fillimisht do të fillojë me ndërtimin dhe rindërtimin e xhamive në ato lagje të qyteteve ose të fshatrave më të mëdha, që në këtë mënyrë të vë lidhjet me myslimanët dhe që më pas t'i organizojë dhe, kështu, të fillojë ngritja e vetëdijes fetare dhe qytetare. Paralelisht me këtë, Myftinia do të kujdeset që në forma të ndryshme të krijojë edhe kuadro të cilat do të marrin arsim fetar të rregullt dhe do të kthehen t'i shërbejnë xhamatit. Në këtë kohë do të dërgohen nxënës kryesisht në Medresenë Isa Beu në Shkup, por edhe një pjesë do të dërgohen në Turqi, ku do të vazhdojnë shkollimin. Gjithashtu, Myftinia gjatë kësaj kohe do të ballafaqohet edhe me probleme të tjera, si: kthimi i va-



Xhamia e fshatit Radanjë-Shtip pas rindërtimit

këfeve, rindërtimi i disa xhamive me vlerë të veçantë historike, aktivizimi i arsimit joformal në mejtepe, mbajtja e ligjëratave nëpër xhami, përfshi edhe gjininë femërore etj.

Vlen të theksohet se për Myftininë e Shtipit viti 2005 do të jetë vit i kthesës së madhe, nga që atë vit Rijaseti i BFI-së do të marrë vendim që në këtë qytet të hapet Paralelja e Shtrirë për Djem e Shkollës së Mesme Islame Medreseja Isa Beu,



Pjesë nga minarja e rrënuar e xhamisë në Dojran

shkollë kjo e cila nëpërmjet arsimimit formal do të luajë rol madhor në ngritjen e vetëdijes fetare në këto vise, në krijimin e kuadrove që do t'i shërbejnë kauzës fetare dhe formimit të një strukture e cila profesionalisht dhe seriozisht do t'u qaset sfidave me të cilat ballafaqohen myslimanët e kësaj ane.

Në fillim Medreseja do të fillojë të funksionojë në një ndërtesë me qira, kurse më pas, aty ku më parë ka qenë Medreseja Hamidije, do të ngrihet Paralelja e Shtrirë e Djemve. Kësaj do t'i kontribuojë shoqata turke "Denis Feneri". Medreseja Hamidije ka qenë në qendër të qytetit të Shtipit dhe është ndërtuar në vitin 1903 nga Sulltan Abdylhamidi i Dytë. Ajo më pas ka qenë e mbyllur dhe ndërtesa është shfrytëzuar nga regjimet e ndryshme për qëllime krejt të tjera. E, pra, pikërisht në atë vend do të ndërtohet një godinë moderne, me të gjitha kushtet për arsim mirë të organizuar. Në këtë ndërtesë, krahas hapësirave për mbajtje të ligjëratave dhe hapësirave administrative, do të ketë bibliotekë të pasur me literaturë fetare dhe me tematikë të përgjithshme, e cila do të jetë në shërbim të nxënësve, pastaj mensë, konvikti, mesxhid; po ashtu edhe hapësira për administratën e Myftinisë së Shtipit. Për shkak se Myftinia nuk kishte mundësi financiare për të financuar të gjitha aktivitetet e Myftinisë, të Medresesë, të të punësuarve në Medrese, por



Mbishkrim i Medresës Hamidije

edhe të nëpunësve fetarë (imamëve, myderrizëve, hatibëve dhe mualimëve), të njëjtat në fillim do të financohen nga shoqata turke “Denis Feneri”. Pas një kohe relativisht të shkurtër, këtë përgjithësi kaq madhore dhe të shenjtë do ta marrë mbi vete “Hudaji Vakfi” - shoqatë kjo me qendër në Stamboll dhe e njohur me aktivitetet dhe shërbesën fetare në shumë vende të ndryshme anekënd botës. Kjo shoqatë që atëherë e sot vazhdon në kontinuitet, pa ndërprerje, t’i mbulojë të gjitha harxhimet e Myftinisë, të të punësuarve dhe të nxënësve në Medrese, të nëpunësve fetarë, por edhe shumë aktivitete të ndryshme me karakter fetar: qoftë për rindërtimin ose ndërtimin e xhamive dhe të mejtepeve etj. Shoqata luan edhe rolin e ndërmjetësuesit ndërmjet Myftinisë dhe institucioneve, shoqatave, komunave dhe personave fizikë për aktivitete fetare dhe humanitare.

BURIMI I SHPRESAVE QUHET MEDRESE

Medreseja, për një kohë të shkurtër, do të fillojë të luajë rolin e burimit të shpresës dhe të ngritjes së vetëdijes fetare dhe qytetare të myslimanëve të kësaj pjese të vendit. Aktivitetet e saj do të mirëpritin dhe do të përkrahen nga të gjithë myslimanët e kësaj ane. Në Medrese çdo vit do të pranohen diku njëzet nxënës, të cilët do të jenë të vendosur në konvikt, harxhimet e të cilëve - që nga librat e deri te rruga - do të mbulohen nga Medreseja, respektivisht nga financuesi filantrop “Hudaji Vakfi”. Deri tash, 2020, në Medrese kanë diplomuar mbi dyqind nxënës; një pjesë e të cilëve shërbejnë nëpër xhami si imamë, vaizë, hatibë dhe mualimë, një pjesë tjetër kanë vazhduar studimet në universitete të ndryshme brenda



Orta-Xhamia në Strumicë

dhe jashtë vendit - madje disa prej tyre kanë vazhduar edhe studimet postdiplomike, kështu që, për rrjedhojë, në një të ardhme të afërt do të kemi edhe tre ish-nxënës të Medresës të cilët do të mbarojnë studimet e doktoraturës. Në Myftininë e Shtipit flasin me mburrje se shumica e nëpunësve fetarë në Myftininë e Shtipit dhe në Medrese sot janë ish-medresantë, të cilët, thonë, me përkushtim dhe seriozitetin më të madh i shërbejnë kauzës fetare në këtë nënqiell.

Po ashtu, Myftinia ka marrëdhënie të shkëlqyeshme edhe me Atasheun për çështje fetare të Ambasadës së Turqisë në Shkup – në veçanti me Shkëlqesinë e Tij Murat Alkan dhe përmes tij edhe me Dijanetin Turk. Dijaneti Turk ka diku dhjetë

imamë që shërbejnë në xhamitë e Myftinisë së Shtipit, të cilët në koordinim me Myftinin dhe me xhematin ku veprojnë – thonë në Myftini - gjithmonë arrijnë të jenë shembull pozitiv. Atasheu ka ndihmuar financiarisht edhe ndërtimin dhe rindërtimin e shumë xhamive, mejtepeve dhe banesave për imamë. Për shembull, Atasheu ka financuar ndërtimin e xhamisë, mejtepit dhe banesën në fshatin Kallkovë të Vallandovës, xhaminë e fshatit Buçim të Radovishit, mesxhidin dhe banesën për imam në Sveti -Nikollë, qytet ky që asnjëherë më parë nuk ka pasur xhami ose mesxhid për falje të namazeve - krahas tentativave të kamotshme të Myftinisë dhe banorëve, pastaj për xhaminë e cila është në ndërtim e sipër në fshatin To-



Xhamia Husamedin Pasha-Shtip

pollnicë të Radovishit, rindërtimin e Xhamisë Kadën Ana në Shtip, etj. Atasheu, po ashtu në bashkëpunim me Dijanetin, ofrojnë edhe ndihma tjera, si: furnizim me materiale mësimore për mejtepet, ndihma gjatë muajit të Ramazanit, mish kurbanit, iftare dhe organizim të manifestimeve të ndryshme me karakter fetar.

Duhet të theksojmë se krahas aktiviteteve të tjera, Myftinia gjatë muajit të Ramazanit çdo natë organizon iftare, vizita nëpër xhimate, ndihma të ndryshme humanitare; po ashtu edhe gjatë Kurban-Bajramit bën therjen dhe ndarjen e mishit të kurbanit për nevojtarët etj.

Problemet me të cilat ballafaqohet Myftinia janë të natyrave të ndryshme – thonë në Myftini. Anakronizmi më i madh është me Xhaminë Husamedin Pasha! Kjo xhami ekziston që nga shekulli 16-të. Në funksion ka qenë deri në vitin 1945. Më pas, në vitin 1953, nga pushteti komunist i atëhershëm i jepet në përdorim, si galeri, Muzeut të Shtipit. Me vendim të Qeverisë, ajo në vitin 2006 i dorëzohet përsëri në pronësi Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë (sot e Veriut), ndërsa në vitin 2009 Ministria e Transportit dhe e Lidhjes truallin ku gjendet Xhamia ia shet Kishës Ortodokse Maqedonase!!! Për çudi, edhe sot Xhamia vazhdon të ngelë në pronësi të Kishës! Edhe pse BFI për rastin në fjalë i ka informuar të gjithë autoritetet shtetërore dhe ndërkombëtare, madje ka ngritur edhe proces gjyqësor, por që është më keqja se të gjitha instancat gjyqësore, madje edhe Gjykata Supreme, kanë



Xhamia në fshatin Kallkovë-Dojran

marrë vendime anakronik në favor të Kishës!

MIRËKUPITIM PËR MYSLIMANËT E MAQEDONISË LINDORE!

Po ashtu mund të përmendet edhe rasti i Orta-Xhamisë në Strumicë, xhami kjo e cila është ndër objektet më me rëndësi të periudhës osmane në vendin tonë: ajo edhe sot, në kohën e pluralizmit fetar, politik, kulturor dhe të demokracisë, vazhdon të mos i jepet në pronësi BFI-së dhe vazhdon të shfrytëzohet si depo për materiale të ndryshme! Edhe pse ka pasur disa takime me zyrtarë të lartë, nga të cilët

është kërkuar që xhamia edhe të restaurohet, por edhe t’i jepet në shfrytëzim Myftinisë, për fat të keq ende nuk ka ndonjë hap konkret optimist në këtë drejtim.

Kemi raste, si në fshatin Durrullu, ku nuk lejohet ndërtimi i xhamisë, madje edhe në vendin ku ka qenë më parë xhamia dhe ku deri vonë kanë ekzistuar themelet e saj! Edhe për këtë rast gjykata ka marrë vendim me të cilin banorëve myslimanë të fshatit nuk u jepet leja për ndërtimin e xhamisë!

Ka raste kur prona të Vakëfit – siç ndodh me varrezat e vjetra në Strumicë dhe Pehçevë, në dokumentacione dalin si prona të “bashkësisë fetare myslimane”, bashkësi kjo inekzistente, kurse autoritetet shtetërore edhe në këtë rast nuk lejojnë që të njëjtat të shfrytëzohen për nevojat e besimtarëve myslimanë, nga Myftinia e Shtipit. Ka edhe raste kur pronat e Vakëfit i janë dorëzuar si pronë Kishës Ortodokse Maqedonase!

Myftinia e Shtipit – thonë në Myftini - me kapacitetet që i ka në dispozicion dhe me përkrahjen e fortë të Bashkësisë Fetare Islame dhe të partnerëve të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, gjithmonë e vendosur dhe e sigurt do të hapërojë në ofrimin e mundësive për ngritjen e vlerave fetare dhe po ashtu me seriozitetin më të madh do të vazhdojë të ballafaqohet me të gjithë sfidat që do të paraqiten në këtë drejtim. Ajo, para së gjithash, kërkon mirëkuptim nga shteti për të gjithë myslimanët e Maqedonisë lindore...

Përgatitën: **Pajazit Murati etj.**

“TIKA” VIZITON BFI-në

Kryetari në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Shefi i Kabinet dhe Drejtor për Diasporë, dr. Selver ef. Xhemaili, më 5 tetor, 2020, në selinë e Rijasetit të BFI priten një delegacion të lartë të organizatës turke për zhvillim dhe humanitet “TIKA”, të udhëhequr nga koordinatori z. Halim Omer Sugut.

Fillimisht, h. hfz. Shaqir Fetahu i falënderoi mysafirët për vizitën e bërë, ndërsa më pas u bisedua për projektet aktuale që janë në realizim e sipër, si dhe për punën që duhet filluar në të ardhmen në renovimin e kompleksit “Arabati” në Tetovë dhe projektin e Xhamisë së Prilepit.



Gjithashtu, u bisedua edhe për punë tjera. Njëherësh, u vendos që BFI-së dhe Kishës Ortodokse Maqedonase-AO kjo organizatë t’u dhurojë materiale dezinfektuese për xhamitë dhe kishat, që u pranua nga krerët e BFI, pas së cilës u arrit dakordimi që ky aksion të bëhet si projekt i përbashkët.

fektuese për xhamitë dhe kishat, që u pranua nga krerët e BFI, pas së cilës u arrit dakordimi që ky aksion të bëhet si projekt i përbashkët.

MYFTINIA E SHKUPIT: "GARA KURANORE 2020"



Më 25 shtator, 2020, në prani të Myftiut dr. Qenan ef. Ismaili, referentëve, hoxhallarëve, hafëzllarëve e xhematlinjve, Myftinia e Shkupit realizoi me sukses Garat Kuranore 2020 në Xhaminë e Mustafa Pashës, moderimin e të cilave e bëri referenti Rexhep ef. Imeri. Prezentuan Komisioni vlerësues përbërë nga: hfz. Xhemail ef. Nuhiju (kryetar); hfz. Abdulkërim ef. Ebibi (anëtar); hfz. Jashar ef. Ibrahim (anëtar).

Vendi i parë i takoi Isra Jusufit, nxënës në mejtepin e Xhamisë En-Nur – Bukoviç; vendi i dytë, Iman Latës, nxënës në mejtepin "Ikre", Fushë-Tophanë; vendi i tretë, Nuredin Osmanit, nxënës i mejtepit "Drita", Fushë-Tophanë.

Më pas hfz. Huzri ef. Idrizi lexoi disa ajete

nga Kurani famëlartë.

Në fund, Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili e vlerësoi lart angazhimin e mualimëve, elanin dhe dëshirën e nxënësve për mbrojtjen dhe mësimin e fjalës së Allahut, duke shtuar se ky rezultat nuk mund të arrihet pa mbështetjen e prindërve, të cilët janë faktor kyç në edukimin e mirëfilltë të fëmijëve të tyre. Myftiu i ndau edhe mirënjohjet dhe shpërblimet për nxënësit dhe komisionin vlerësues.

Nxënësit që zunë tri vendet e para u shpërblyen me nga një tablet (mini-kompjuter). Myftinia e Shkupit, ndërkaq, për nxënësit që morën pjesë në këto aktivitete organizoi dhe një ekskursion njëditor në qytetet e Ohrit dhe të Strugës.

KUIZ DITURIE NË ÇAIR

Në Xhaminë e Re - Çair është organizuar dhe Kuizi i diturisë, mbrëmja finale.

Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili e çmoi lart punën dhe angazhimin e gjithë mualimëve, të cilët i falënderoi për punën e tyre fisnike, të cilët – tha ai - arritën që t'u japin këtyre nxënësve vetëbesimin, krahas dijës, njohurive të nevojshme dhe përgatitjes së duhur që po na bëjnë krenarë sot, me shpresë dhe lutje që të na bëjnë krenarë edhe më tutje me arritjet dhe sukseset e tyre.

Në bazë të vlerësimit të komisionit treanëtarësh, të përbërë nga: Llokman ef. Kamberi (kryetar), Adem ef. Rahmani (anëtar), Shaban ef. Tahiri (anëtar), në vendin e parë u rangua: **ABDULBASIT MEMETI**, nxënës në mejtepin "Ikre" – fshati Studeniçan; në vendin e dytë, **REJHANE SEFA**, nxënës në mejtepin e Xhamisë Jahja Pasha; në vendin e tretë, **ZERINA ÇUPLI**, nxënës në mejtepin e Xhamisë Hatunxhuk.

PËR ZBATIMIN ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE NË RMV

Më datë 13 tetor, 2020, Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset Drejtorin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve, prof. dr. Ylber Sela, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët z. Shaqir Islami, Këshilltar i Drejtorit dhe z. Besian Pollozhani.

Gjatë takimit h. hfz. Shaqir ef. Fetahu u tregoi mysafirëve praktikën e shumëgjuhësisë, cila vite të tëra zbatohet në Bashkësinë Fetare Islame, duke i respektuar të gjithë popujt e vendit-besimtarë të Islamit, duke i mundësuar secilit përdorimin e gjuhës amtare.

Nga ana tjetër, prof. dr. Ylber Sela i shprehu urimet e tij dhe të Agjencisë që ai drejton Kreut të BFI për postin e ri, duke i dëshiruar shumë suksese në punë në drejtimin e BFI dhe në të njëjtën kohë i dhuroi Kryetarit të BFI-së një doracak të Agjencisë rreth mënyrës së aplikimit



të dygjuhësisë në institucionet shtetërore. Efendi Fetahu u falënderua për këtë dhe i dëshiroi suksese në udhëheqjen e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve.

Më pas, të dyja palët këmbëzën mendime rreth shumë çështjeve, në veçanti rreth zbatimit të gjuhëve në Republikën

e Maqedonisë së Veriut dhe konstatuan se zbatimi i dygjuhësisë, në veçanti e gjuhës shqipe në institucione, është shtyllë e ardhmërisë sonë kombëtare dhe fetare, prandaj në këtë frymë u ra dakord që bashkëpunimi mes këtyre dy institucioneve të vazhdojë edhe në të ardhmen.

REAGIM

BANESAT E "IBNI PAJKOS" I KA SHITUR SHTETI PA PËLQIMIN E BFI-SË!

Lajm TV ka publikuar më 21 shtator, 2020, raportin me titull "BFI ka humbur vakëfin në zemër të Shkupit, kushton miliona euro?", ku deklaratë jep historiani Qerim Lita - njëri ndër më të privilegjuarit e BFI-së më herët, i cili për shërbime të ndryshme ka marrë shuma të majme nga buxheti i BFI-së, shuma të cilat vijnë edhe prej vakëfit.

Si rregull, për të shitur një pronë, duhet të nënshkruash edhe marrëveshje për shitblerje. Marrëveshje të tilla, asnjë organ i BFI-së nuk ka nënshkruar me personat që sot janë pronarë të banesave në ndërtesën "Ibni Pajko", por ato banesa i ka shitur shteti pa pëlqimin e BFI-së.

Në fakt, me nacionalizimin e pronave në monizëm e gjithë prona e Xhamisë Ibni Pajko, përfshi këtu edhe ndërtesën gjashtëkatëshe që mban edhe sot e kësaj dite këtë emër, kalon në pronësi të shtetit. Xhamia priset, ndërsa ndërtesa ekziston edhe sot e kësaj dite. Me nxjerrjen e Ligjit për denacionalizimin e pronave, BFI ngriti procedurë për kthimin e pronës që nga tetori i vitit 2000.

- Ndërtesa përbëhet prej banesave, si dhe 322,42 m2 objekte afariste.
- BFI ka dëshmuar pronësinë e saj me tapinë nr. 12820 të datës 11 maj 1929,
- Nacionalizohet me vendim nr. 301/59 më 13.05.1960 për interesa shtetërore.
- Kërkesa për denacionalizim parashtr

het më 7.10.2000, e regjistruar si DN. nr. 19-08-736/1 (570), sapo nxirret Ligji për denacionalizim dhe është një ndër objektet e para të cilat BFI kërkon që t'i kthehet në pronësi.

- Deri tani janë kthyer vetëm dyqanat me sipërfaqe prej 322,42 m2, ndërsa banesat nuk kthehen në pronësi, sepse që nga vitet 80-të të shekullit XX kanë kaluar në pronësi të personave fizikë (kanë qenë të vendosur në këtë ndërtesë, kryesisht ushtarakë të JNA-së).
- Për kthimin e banesave disa herë jemi ankuar si: në vitin 2001, 2004, 2009, 2014 e kështu më radhë, deri më sot, dhe lënda disa herë është kthyer në rishqyrtim.
- Shuma e fundit me të cilën shteti e kompenson BFI-në për banesat është 22.530.172 denarë, shumë të cilën BFI nuk e ka marrë akoma.

Duam të sqarojmë se BFI nëpërmes procesit të denacionalizimit kërkon kthimin e Vakëfit të nacionalizuar nga sistemi komunist dhe nëpërmes procesit arrijmë të kthejmë shumë prona, mes tyre edhe dyqanat e të njëjtit objekt, por shpesh në disa lëndë shteti nuk lejon kthimin e pronave nëse ato vazhdojnë të jenë interes shtetëror, si Vakëfi të Universiteti Shën Kiril e Metodij, vakëfi tek Biblioteka Universitare e të tjera.

Arsyeja e moskthimit të banesave është se prona ka kaluar në pronësi të per-

sonave fizikë që nga vitet 80-të të shekullit të kaluar, kur objekti ka qenë i qeverisur prej organeve të shtetit. Sipas Ligjit për denacionalizim, neni 9, thuhet: "prona e cila ka kaluar në pronësi të personave fizikë deri në hyrje të fuqi të këtij ligji, nuk mund të kthehet në pronësi".

Këto akte normative, të nxjerra nga Kuvendi i Maqedonisë, jo nga organet e BFI-së, shpesh janë pengesë për kthimin e pronës, ndërsa potencojmë se ligjet nuk i nxjerrim ne, por deputetët e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut.

Ne si BFI në vitin 1998, kur për herë të parë është nxjerrë Ligji për denacionalizim, shumë ashpër i kemi kritikuar këto norma juridike, por si atëherë, ashtu edhe sot, shpesh kërkesat e BFI-së, edhe pse janë legjitime, hasin në vesh të shurdhër të organeve kompetente.

Jo vetëm për banesat e "Ibni Pajkos", por edhe për shumë lëndë të tjera të cilat nuk janë në favor të Vakëfit, të njëjtat do të dërgohen edhe në Gjykatën e Strasburgut.

Me shpresë se sqaruar mjaftueshëm, që qytetari të dijë se BFI asnjëherë nuk ka shitur asnjë vakëf dhe as do të shesë në të ardhmen, derisa vendimet janë në përgjegjësi të plotë të organeve legjitime të BFI-së. Për atë që është jashtë kompetencave tona, ju lutemi drejtojuni institucioneve përkatëse. (22.09.2020)

Zyra për Informim e BFI të RMV

ZV/MINISTRI I KULTURËS NË BFI



bëjnë me Bashkësinë Fetare Islame dhe u konstatua se Ministria e Kulturës në të ardhmen do të jenë në shërbim të ndihmesës dhe zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohet institucioni fetar.

Për këtë, Kreu i BFI h. hfz. Shaqir

ef. Fetahu edhe një herë i shprehu falënderime në emrin e tij personal dhe në emër të BFI për vizitën dhe respektin që ka treguar Zv/Ministri, të bindur se bashkëpunimi mes dy institucioneve do të jetë në frymën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në sferat e përbashkëta.

NË FORUMIN NDËRKOMBËTAR BOSHNIK

Kreu i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 28 shtator, 2020, mori pjesë në përvjetorin e Forumit Ndërkombëtar Boshnjak, i cili u mbajt në amfiteatrin e Komunës Çair. Në këtë manifestim morën pjesë shumë personalitete të sferave të ndryshme shoqërore dhe politike.

Fjalën hyrëse e mbajti akademiku i njohur z. Ferid Muhiq, ndërsa kanë folur edhe Kryetari i Forumit Boshnjak z. Enes Shemsoviq, Kryetari i Komunës së Çairit z. Visar Ganiu, Ministri i Punëve të Brendshme z. Oliver Spasovski e të tjerë.

Kreu i Bashkësisë Fetare Islame shoqërohej nga Myftiu i Shkupit, dr. Qenan Ismaili.

Në fjalën e tij të rastit, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu përshëndeti tubimin dhe foli për rolin e boshnjakëve në jetën fetare islame. Njëherësh, nga organizatori Kreut të BFI u dorëzua Dekorata



e Forumit Boshnjak për kontributin e dhënë në ngritjen fetare-kulturore të boshnjakëve.

KËNAQ BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E FINANCAVE

Bashkëpunimi mes BFI dhe Drejtorisë për Çështje Pronësore-Juridike, që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, është në binarët e duhur. Kjo është vlerësuar më 10 tetor, 2020, në takim midis Kreut në detyrë të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me zonjën Shasine Kasami, drejtoreshë e kësaj drejtorie. Ajo është shoqëruar nga dy bashkëpunëto-

rëve të vet, z. Bejan Rexhepi dhe z. Bunjamin Shabani. Nga Rijaseti ka marrë pjesë Sekretari i Përgjithshëm, h. Irsal ef. Jakupi.

Fillimisht, Kreu i BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi zonjën Kasami dhe drejtorinë që ajo drejton për punën e palodhshme dhe kontributin e dhënë në të mirë të BFI dhe të myslimanëve të vendit, për ndihmën e dhënë në privatizimin e pronave

të BFI dhe denacionalizimin e vakëfeve të nacionalizuara.

Të dyja palët ranë dakord që edhe në të ardhmen të ketë një bashkëpunim të mirëfilltë për çështjet e hapura, siç janë denacionalizimi në tërësi i pronave të BFI dhe rikthimi i tyre tek pronari i vërtetë – pra, te BFI, si dhe nxjerrja e epilogut për pronat që janë në procedurë e sipër.

PËRVJETORI I SHOQATËS “SOS VITA”

Më 27 shtator, 2020, Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, kanë marrë pjesë në shënimin e njëvjetorit të shoqatës “SOS Vita”, e cila përkujdeset për personat me nevoja të posaçme. Në këtë ceremoni ata u mirëpritën nga Kryetari i Shoqatës “SOS Vita”, z. Ertan Shaqiri dhe anëtarët tjerë të Shoqatës.

Në prezencë të një numri të madh të të pranishmëve, Kreu i BFI, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përshëndeti këtë përvjetor dhe punën e palodhshme të udhëheqjes së kësaj shoqate, si dhe premtoi mbështetje të pazërvë për këtë shoqatë, e cila është në shërbim të personave me nevoja të posaçme.

Deri më tani në këtë shoqatë janë regjistruar 110 persona me nevoja të veçanta, ndërsa qëllimi dhe synimi i kësaj shoqate



është që përmes aktiviteteve të ndryshme të përmirësohet gjendja e personave me nevoja të veçanta në Shkup dhe më gjerë.

GESAB NË SHKUP

Kreu në detyrë i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit dhe Drejtori për Diasporë, dr. Selver ef. Xhemaili, kanë pritur më 16 tetor, 2020, në Rijaset, në një takim pune, anëtarët e GESAB-International Academy of Sciences, me seli në Linz të Austrisë, në për-

bërje: z. Shaban Jashari dhe z. Mesut Koxha. Fillimisht, Kreu i BFI u dëshiroi mirëseardhje në institucionin më të vjetër në vend - atë të Bashkësisë Fetare Islame dhe më pas i njoftoi, me një paraqitje të shkurtër, mbi funksionimin e BFI dhe institucioneve edukativo-arsimore që ajo ka. Mysafirët i uruan Shaqir ef. Fetahut postin e ri në udhëheqjen e BFI-së dhe i dëshi-

ruan suksese dhe punë të mbarë në të ardhmen.

Më pas të dyja palët diskutuan më thellësisht mbi mundësitë e bashkëpunimit të përbashkët mes GESAB-International Academy of Sciences dhe BFI, përkatësisht Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, në sferën e edukimit, arsimimit dhe të shkollimit në përgjithësi.

RINIA, BEGATIA MË E ÇMUESHME E NJË POPULLI

Periudha e rinisë është periudha e fuqisë, e cila gjendet në mes dy periudhave të dobësisë: dobësisë së fëmijërisë dhe dobësisë së pleqërisë. Faza e rinisë është një begati që duhet të shfrytëzohet. Të rinjtë janë ata që mund të bartin detyra të rënda, të ballafaqohen me sfida të ndryshme, të durojnë dhe të sakrifikojnë për ideale. I Dërguari (a. s.) ka thënë: “Nuk do të lëviz askush ditën e Kiametit derisa të pyetet për katër gjëra: për jetën si e ka harxhuar, për rininë si e ka vjetruar, për pasurinë si e ka fituar dhe ku e ka harxhuar; dhe për punën e tij – ç'bëri.”



Shkruan: Mr. Nexhati Spahiu (Enkas për HeR)

Falënderojmë Allahun (xh. sh.), i Cili krijoi vdekjen që jeta të ketë kuptim, i Cili krijoi sëmudjen që shëndeti të ketë kuptim, i Cili krijoi Ahiretin që jeta në dynja të ketë kuptim. I dërgojmë salavate dhe selame Muhamedit (a. s.), shumë selame shpirtave të shehitëve dhe lutemi për udhëzimin e Allahut për ne të gjallët.

Rinia është e ardhmja, pjesa më e rëndësishme e një populli, pranvera e jetës. Jeta në rini është përplot stuhi. Nëse një rini është e ngritur, atëherë edhe populli i asaj është i ngritur. Rinia duhet të edukohet me vlerat e dashurisë, të respektit, të dinjitetit, të punës, të sakrificës, të nderit, të diturisë dhe të guximit.

ÇFARË BREZI PO RITIM? ÇFARË TË ARDHME PO NDËRTOJMË?

Po jetojmë në një kohë shumë të vështirë, ku rinia jonë çdo ditë po përballlet

me sfida të ndryshme siç janë: droga, prostitucioni, alkooli etj. Të rinjtë tanë po mundohen të imitojnë kultura të ndryshme dhe po e harrojnë vetveten e tyre.

Rinia është begatia më e çmueshme e një kombi. Një komb pa një rini të shëndoshë, nuk ka perspektivë të ndritur. Rinia e popullit shqiptar ka kohë që gjendet në udhëkryqet e saj.

Gjithmonë është thënë se rinia është ardhmëria e një shoqërie, e një populli, e një shteti dhe në duart e tyre do të barten

përgjegjësitë dhe obligimet për të udhëhequr, edukuar, zhvilluar dhe për të çuar përpara bashkësinë njerëzore.

Rinia shqiptare sot po kalon momente shumë të vështira dhe, ashtu si i gjithë kombi shqiptar, ndodhet në një udhëkryq të madh. Kërkon të ndërtojë të ardhmen e saj, por ndeshet me shumë probleme të cilat shpesh janë shumë të vështira për t’u zgjidhur.

Koha në të cilën jetojmë është mjaft dinamike dhe sot në botë ndryshimet ndodhin me një shpejtësi marramendëse, e me këtë e gjithë bota zihet në vorbën e ndryshimeve të natyrave të ndryshme që i përjetojmë sot.

Periudha e rinisë është periudha e fuqisë, e cila gjendet në mes dy periudhave të dobësisë: dobësisë së fëmijërisë dhe dobësisë së pleqërisë - siç tregon për këtë Kurani famëlartë:

اللَّهُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِّنْ ضَعْفٍ ثُمَّ جَعَلَ مِنْ بَعْدِ ضَعْفٍ قُوَّةً ثُمَّ جَعَلَ مِنْ بَعْدِ قُوَّةٍ ضَعْفًا وَشَيْبَةً يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَهُوَ الْعَلِيمُ الْقَدِيرُ

“Allahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsلمي, më i fuqishmi.” (Er-Rum, 54)ⁱ

Faza e rinisë është një begati që duhet të shfrytëzohet. Të rinjtë janë ata që mund të bartin detyra të rënda, të ballafaqohen me sfida të ndryshme, të durojnë dhe të sakrifikojnë për ideale. I Dërguari (a. s.) ka thënë:

”لن تزول قدما عبد يوم القيامة حتى يسأل عن أربع خصال: عن عمره فيما أفناه، وعن شبابه فيما أبلاه، وعن ماله من أين اكتسبه وفيما أنفقه، وعن علمه ماذا عمل به“

“Nuk do të lëviz askush ditën e Kiametit derisa të pyetet për katër gjëra: për jetën si e ka harxhuar, për rininë si e ka vjetruar, për pasurinë si e ka fituar dhe ku e ka harxhuar dhe për punën e tij – ç’bëri.” (Transmeton Tirmidhiu)ⁱ

قال رسول الله صلى الله عليه وسلم لرجل وهو يعظه : اغتتم خمسا قبل خمس : شبابك قبل هرمك ، وصحتك قبل سقمك ، وغناك قبل فقرك ، وفرغك قبل شغلك ، وحياتك قبل موتك المصدر: الآداب - الراوي: البيهقي الصفحة أو الرقم:

“Shfrytëzo pesë gjëra para pesë të tjerave: rininë tënde para pleqërisë,

shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para se të zihesh dhe jetën para vdekjes.” (Transmeton Bejhekiu)ⁱⁱⁱ

Rinia sot po jeton në një zbrazëti shpirtërore. Ajo ka energji, por këtë energji po e shpenzon kot, pa e ditur qëllimin e krijimit të tyre. Sheh një numër të madh të rinisë pa të ardhme, pa kontroll. Bëjnë jetë të çastit, nuk mendojnë për një të ardhme të ndritshme. Kanë pak moral, flasin shumë e asgjë s’thonë. Edhe ato fjalë që flasin, i kanë: sharje, mallkime, tallje etj. Pra, aq sa dinë, aq (atë) flasin. Shkojnë në shkollë si në dasmë. Bile, në dasmë njerëzit dërgojnë dhurata - me një fletore në xhep; të gjitha lëndët i përziejnë aty.

Shkollën nuk e llogarisin si vend të arsimit dhe të edukimit. Për ta shkolla është një mundësi për largim nga shtëpia. Shkollat sot kanë filluar të marrin rolin e vendeve ku bëhen sfilata, ku secila vajzë shtyhet me tjetrën se cila e ka fustanin më të shkurtër, cila po ekspozon lakuriqësinë më shumë; disa të tjera, kush po bënë majkiazhe më të mira. Çantave të vajzave, në vend të librave, fletoreve dhe lapsave, po zë vend grimi i tyre. Kjo pothuajse nuk po u pengon shumë prindërve dhe edukatorëve të tyre. Nëse një vajzë e re vendos të mbrojë nderin dhe identitetin e vet fetar, për rrethin dhe pedagoget e tyre ato janë të nënçmuara, të përjashtuara nga orët e mësimin, ndërsa ka raste edhe të përjashtimit nga shkolla.

Për rininë e Perëndimit dhe problemin e zbrazëtisë së tyre shpirtërore, dr. Jusuf el-Kardavi thotë: “Ata ankohen për shkak të boshllëkut, të brengës dhe të jetës së pakuptimtë. Për këtë shkak jeta e tyre është e ngjashme me mënyrën nomade të ekzistencës, ngase ky civilizim bashkëkohor nuk u ka ofruar inspirim shpirtëror, nuk e ka mbushur boshllëkun dhe vakumin fetar; nuk i ka mbrojtur nga frika. Ata me të nuk e kanë kuptuar zanafillën, as zhvillimin e tyre. Me të nuk e kanë kuptuar domethënien e ekzistimit të tyre. Te kokat e tyre ende sillen pyetjet e përhershme: prej nga janë, ku dhe përse shkojnë?”^{iv}

Dr. Jusuf el-Kardavi thotë: “Të rinjve u nevojitet autoriteti. E, a mund ta gjejnë një model të duhur në shtëpi? Po a mund të gjejnë në shkollë dhe në shoqëri? Fatkeqësisht, modele të tilla të duhura sot ka gjithnjë e më pak. Sot është vështirë të gjendet një baba i cili mund të jetë shembull për fëmijët e tij, as pedagog tek i cili nxënësit do të shohin autoritetin dhe edukatorin e duhur. Është vështirë të gjendet ky lloj, pos atyre të cilët i ka mëshiruar

Allahu (xh. sh.), ndërsa ata, siç duket, janë të rrallë. Në disa shkolla ekziston një program i mirë për studimin e diturive të dobishme, mirëpo arsimimi nuk nënkupton vetëm programin e mirë, ose librin e mirë, ose lëndët të cilat duhet mësuar përmendsh për të kaluar provimin. Arsimimi është diç më e thellë dhe më e madhe se kaq. Arsimimi i nevojitet një model i cili diturinë e vet do të arrijë ta transmetojë tek nxënësit ngrohtësisht dhe të zgjojë tek ata vëmendjen dhe dëshirën për fitimin e diturisë, i cili do të jetë shembull i gjallë i arsimimit”^v

Për këtë, i riu mysliman duhet të bëhet vetë shembull i mirë, të cilin do ta ndjekin tjerët, nëse nuk sheh në shoqëri shembull të mirë. Askush nuk ka të drejtë që këtë t’ia hedh tjetrit apo shoqërisë. Ne të gjithë jemi përgjegjës, sepse kjo është prej problemeve substanciale të shoqërisë dhe kjo nënkupton edhe përgjegjësinë tonë kolektive për mosrealizimin e këtij objektivi madhor islam. Shembulli i mirë duhet të ekzistojë në të gjitha fushat e jetës, si: (tek) përkushtimi fetar, shkenca, morali, sjellja e mirë, familja, shoqëria etj.

Shumë prej të rinjve i kanë neglizhuar obligimet fetare dhe i kanë lënë mënjanë. Ka prej tyre që i kanë lënë krejtësisht. Një pjese prej tyre u kanë ikur disa nga obligimet, disa nga shtyllat.

Nëse zemra e të riut lidhet për epsheet, ajo është prishur edhe është sfiduar, kështu që ai është bërë rob i atyre epsheve, vrapon pas tyre nga të shkojnë ato, edhe pse ato e drejtojnë drejt shkatërrimit të tij.

“Kush e lë shpirtin e vet të zbrazët, në të do të vendoset pakujdesia. Shpirti nuk mund të mbetet bosh. Nëse nuk mbushet me të mirë, do të mbushet me të keq; nëse nuk mbushet me udhëzim, do të mbushet me mashtrim; nëse nuk mbushet me të vërtetën, do të mbushet me të pavërtetën.”^{vi}

Disa sfida me të cilat, për fat të keq, po ballafaqohet rinia jonë janë: alkooli, droga (narkomania), duhani, interneti etj.

ALKOOLI

Me të vërtetë që konsumimi i alkoolit dhe i drogës krijon një gjeneratë plotësisht të shkatërruar, prej së cilës nuk pritet asnjë dobi, asnjë fitore, sepse kjo gjeneratë do të jetë vegël e tjetërkujt. E nëse kështu është kjo gjeneratë, kjo do të jetë fatkeqësia më e madhe, sepse nëse rinia bie, atëherë kush do të ngrihet me ndërtimin dhe kush do ta rikthejë fitoren dhe rezultatet:

إِنَّمَا يُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ يُوقِعَ بَيْنَكُمْ الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ فِي الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ وَيَصُدَّكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَعَنِ الصَّلَاةِ فَهَلْ أَنْتُمْ مُنتَبِهُونَ

“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedh armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?” (El Maide, 91)

DROGA (NARKOMANIA)

Droga në vendin tonë paraqet armën më moderne të djallit të mallkuar.

Narkomania sot, për fat të keq, po merr një shtrirje me përpjesëtime më të gjera, të katastrofave dhe është një problem bashkëkohor dhe universal i çdo nacionaliteti. Narkomania po bartet te të rinjtë me përmasa epidemiologjike dhe po përhapet më të madhe. Ajo është një problem botëror dhe, ç’është më e keqja, kjo epidemi planetare po përqafohet nga kategoritë e ndryshme e në veçanti nga të rinjtë.

Sot në shumë vende të botës droga është bërë “traditë” dhe pjesë përbërëse e njeriut - në shkollë, në rrugë, në dasma, në ahengje, në dëfrime, në mbrëmje gazmore, si dhe në momente dhe situata të ndryshme. Në anën tjetër, shumica e prindërve, duke dashur që të tregohen “modernë” dhe se ata i kuptojnë veprimet e fëmijëve të tyre dhe të rinisë në përgjithësi, shpeshherë bëhen të shurdhër për jetën e tyre, duke mos i kuptuar pasojat e saj.

DUHANI

Duhani është një ves i fëlliqur, i shpërndarë me të madhe në mesin e rinisë dhe të tjerëve. Dijetarët janë shprehur qartë për ndalesën e duhanit të fëlliqur dhe dëmet e tij. Allahu i madhërishtëm thotë:

وَيَحِلُّ لَهُمُ الطَّيِّبَاتُ وَيَحْرَمُ عَلَيْهِمُ الْخَبَائِثُ

“...ai u lejon atyre si të ligjshme At-Tajjibat (gjithçka të mirë dhe të ligjshme për besimin, punët, njerëzit, ushqimet, sendet) dhe ua ndalon si të paligjshme Al-Habaith (gjithçka të keqe dhe të palejueshme për besimin, për punët, njerëzit, ushqimet).” (El Araf, 157)^{vii}

DISA HADITHE KU PËRMENDET RINIA

Në vazhdim po japim disa hadithe ku përmendet rinia:

1. “Zoti yt është i kënaqur me atë adoleshent i cili është i lirë nga pasioni rinor.” (Transmetuar nga Ahmedii)^{xi}

2. “Janë shtatë persona të cilëve Allahu do t’u ofrojë hije prej hijes së Tij në ditën kur s’do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij: sunduesi i drejtë; i riu që është edukuar me dëgjueshmëri ndaj Allahut; njeriu, zemra e të cilit është e lidhur për xhaminë; dy njerëz të cilët e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe ata takohen për hir të Allahut; njeriu i cili nxitet nga një grua me pozitë dhe bukuri dhe ai thotë: “unë i frikësohem Allahut”; njeriu i cili ka dhënë lëmshë fsheturazi, sa që dora e tij e majtë nuk e di se çfarë ka dhënë dora e djathtë e tij; dhe personi i cili e ndajkujton Allahun në vetmi dhe lotët rrjedhin nga sytë e tij (për shkak të frikës ndaj Allahut).” (Transmetuar nga Buhari dhe Muslimi)^{xii}

3. “Hasani dhe Huseini (radiallahu-anhuma) do të jenë udhëheqësit e të rinjve në xhenet.” (Transmetuar nga Tirmidhiu)^{xiii}

4. “Do t’u thuhet njerëzve të Xhenetit: Për ju është rinia dhe ju kurrë s’do të plakeni.” (Transmetuar nga Muslimi)^{xiv}

5. “Asnjëherë një i ri nuk e nderon një të vjetër për shkak të moshës së vjetër të tij, e që Allahu mos t’ia caktojë dikë i cili do ta nderojë atë gjatë pleqërisë së tij.” (Transmetuar nga Tirmidhiu me zinxhir të dobët të transmetimit)^{xv}

6. Ebu Bekr i tha Zejd bin Thabitit derisa Umeri (radiallahu anhum) ishte krahas tij: “Ti je një i ri, inteligjent. Ne s’dyshojmë në ty dhe ti e shkurajue shpalljen për të dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selam). Pra, ndiqe Kurantin dhe mblidhe atë.” (Transmetuar nga Buhariu)^{xvi}

7. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) i erdhi një të riu derisa ai ishte në agoninë e vdekjes dhe e pyeti atë: “Në çfarë gjendje e sheh veten?” Ai tha: “Kam shpresë tek Allahu, o i dërguar i Allahut dhe frikësohem për mëkatet e mia.” Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha: “Nuk bashkohen këto dy gjëra (shpresa dhe frika) në zemrën e robit në një moment të këtillë, e që Allahu mos t’ia japë atë për çka shpreson dhe ta shpëtojë atë nga ajo prej së cilës frikësohet.” (Transmetuar nga Ibn Maxheh)^{xvii}

8. Bera bin Azib (radiallahu-anhu) tha në lidhje me Betejën e Hunejnit: “Jo, pasha Allahun. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) nuk ka ikur. Madje, edhe shoqëruesit e tij të rinj, të cilët qenë të lodhur dhe të pajisur dobët, u shfaqën për të luftuar.” (Transmetuar nga Buhariu)^{xviii}

9. Ibn Mes’ud (radiallahu-anhu) transmeton: “Ne luftonim me Pejgamberin (salallahu alejhi ue selam), ndërsa ishim të rinj.” (Transmetuar nga Ahmedii)^{xix}

10. Alkame, i cili është njëri nga shoqëruesit e Ibn Mes’udit (radiallahu-anhu) transmeton: “Unë ecja me Abdullahun në Mine, kur ai e takoi Uthmanin (radiallahu-anhu). Abdullahu qëndroi duke biseduar me Uthmanin (radiallahu-anhu), kur ai tha: “O Ebu Abdir-Rahman, a do të martojmë ty me një vajzë të re, ashtu që ajo do të t’i përkujtonte ty disa gjëra të cilat kanë kaluar gjatë kohës tënde.” Abdullahu tha: “Nëse e thoni këtë. Me siguri, Resulullahu (salallahu alejhi ue selam) na ka treguar neve: ‘O rini, kushdo nga ju që ka mundësi, le të martohet, sepse kjo është më efektive në mbrojtjen e shikimit dhe më e dëlirë për vendet e turpshme. Nëse dikush s’ka mundësi që ta bëjë këtë, atëherë ai duhet të agjërojë, sepse kjo është mburojë për të (nga mëkatet).’” (Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)^{xx}

11. Në hadithin që ka të bëjë me Dexhallin, të transmetuar nga Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam): “Dexhalli do ta thërrasë një person, i cili është në kulmin e rinisë së tij dhe do ta godasë atë me shpatë, duke e prerë atë në dy pjesë, sikur goditja e shënjestrës. Pastaj, Dexhalli do ta thërrasë të riun. I riu do të përgjigjet, duke qenë ftyra e tij vezulluese – duke qeshur.” (Transmetuar nga Muslimi)^{xxi}

12. Malik bin Huvejrith (radiallahu-anhu) transmeton: “Ne erdhëm te Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) derisa ishim të rinj, me moshë të ngjashme. Ne qëndruam pranë tij për njëzet ditë dhe net. I dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ishte i mëshirshëm dhe i butë. Kur ai supozoi se ne mërzhiteshim për familjet tona në vështirësi, ai na pyeti neve se çfarë kishim lënë prapa, dhe ne e informuam. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha: “Kthetuni te familjet tuaja, jetoni me ta, mësoni ata, thirrni ata” Dhe, ai përmendi edhe disa gjëra të tjera. “Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur. Kur të afrohet koha e namazit, atëherë njëri prej jush duhet ta thërrasë thirrjen e namazit (ezanin) dhe më i vjetri nga mesi juaj le të udhëheqë në namaz.” (Transmetuar nga Buhariu)^{xxii}

Interneti është një sprovë e re, që ka hyrë pa kontroll në shtëpitë tona tani shpejt. Edhe pse interneti mund të përdoret për të mirë dhe për përmirësim, shumica e të rinjve e shfrytëzojnë atë me qëllim të lojës dhe kalimit të kohës më kot, e ndoshta mundet me qenë kjo edhe në gjëra të ndaluara - e kjo është vërejtur te shumica e të rinjve në kohën tonë, të cilët kalojnë nëpër faqe të ndryshme të këqija, duke shikuar atë që nuk kanë pasur mundësi ta shohin përmes kanaleve televizive satelitore.

Ja një shembull se si duhet te jetë një i ri: Ibrahim (a. s.) ishte një i ri, në moshë shumë të vogël. Edhe pse në atë moshë, ai nuk pranoi t'i adhurojë idhujt dhe ia mohoi këtë babait dhe popullit të vet. Siç e përmendën Allahu (xh. sh.) në Kuranin famëlartë: "Ç'janë këto statuja? Ata thanë: I gjetëm te të parët tanë që po i adhuronin. Ai u tha: Edhe të parët tuaj, edhe ju ishit të humbur." Pastaj vazhdoi të debatojë me ta derisa i mposhti dhe u tha:

وَتَأْتِيهِمْ لَأَكِيدَنَّ أَصْنَامَكُمْ بَعْدَ أَنْ تُوَلُّوا
(٥٧) فَجَعَلَهُمْ جُدَادًا إِلَّا كَبِيرًا مُدْبِرِينَ
لَهُمْ لَعْنَةُ اللَّهِ إِنَّهُمْ يَرْجِعُونَ

"Pasha Allahun, posa të largoheni ju, unë kam për t'ua bërë atë që duhet statujave tuaja! Dhe, i bëri ato copë-copë, përveç njëres, më të madhes, që kishin ata, me shpresë se asaj do t'i drejtohen (për të kuptuar se kush i

theu)." (El-Enbija, 57-58)¹⁴

Kur u kthyen ata, u habitën se ç'kishte ndodhur me zotat e tyre. Ja se si e shpjegon Kurani këtë rast:

قَالُوا مَنْ فَعَلَ هَذَا بِآلِهَتِنَا إِنَّهُ لَمِنَ
) قَالُوا سَمِعْنَا فَتَى يَذُكُرُهُمْ ٩ ۝ الظَّالِمِينَ
يُقَالُ لَهُ ۖ إِبْرَاهِيمَ

"Ata thanë: 'Kush e bëri këtë me Zotat tanë? Ai na qenka kriminel. (Pastaj) Thanë:

Kemi dëgjuar për një djalosh që i përqeshte ato, të cilit i thoshin Ibrahim'." (El-Enbija: 59-60)¹⁵

Ibrahimi ishte një djalosh i ri; ndoshta edhe më i ri se ne, por ai në atë moshë ishte në rrugën e Allahut (xh. sh.) dhe i kishte kërcënuar ata se do t'ua bënte copë-copë zotat. Ndërkohë, ai e realizoi kërcënimin e vet. Kur ata e pyetën se 'a e bëre ti këtë?', ai u përgjigj:

ثُمَّ نَكْسُوا عَلَى رُءُوسِهِمْ لَقَدْ عَلِمْتُمْ مَا
هَؤُلَاءِ يَتَّبِعُونَ

(me gisht, duke treguar kah statuja më e madhe). "Mirëpo, pastaj e shoshitën këtë gjë në kokat e tyre (u kthyen nga bindja në kokëfortësi) dhe thanë: 'Po ti e ke ditur se këta nuk flasin!'" (El-Enbija, 65)¹⁶

Dëshira jonë më e madhe është edukimi i një rinie të vetëdijshme dhe të gat-

shme për të marrë mbi supë përgjegjësitë e së ardhmes dhe për të ndërtuar botën sipas vlerave hyjnore. Një rini që do të jetë model për botën islame në veçanti dhe për të gjithë botën në përgjithësi...

Lusim Allahun e lartësuar me emrat e Tij më të bukur dhe me cilësitë e Tij më të larta që ta mbrojë rininë tonë nga trillimet e sprovave dhe t'i bëjë prej udhëzuesve të udhëzuar, mbrojtësve të Islamit me udhëzim dhe dritë prej Zotit tonë, derisa ta takojmë Atë, duke qenë i kënaqur me ne.

(Autori është imam dhe profesor nga Prizreni)

¹ Kuran: Er-Rum, 54.

² Hadith: Transmeton Tirmidhiu.

³ Bejhekiu.

⁴ Dr. Jusuf el-Kardavi: Disa refleksione mbi gjendjen e sotme të rinitë sonë, fq.79

⁵ Dr. Jusuf el-Kardavi: Disa refleksione mbi gjendjen e sotme të rinitë sonë, fq.21.

⁶ Dr. Jusuf el-Kardavi: Disa refleksione mbi gjendjen e sotme të rinitë sonë, fq.88.

⁷ Kuran: El Araf, 157.

⁸ Kuran: El-Embija, 57-58.

⁹ Kuran: El-Embija, 59-60.

¹⁰ Kuran: El-Embija, 65.

¹¹ Hadith: Transmeton Ahmedi.

¹² Hadith: Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

¹³ Hadith: Transmeton Tirmidhiu.

¹⁴ Hadith: Transmeton Muslimi.

¹⁵ Hadith: Transmeton Tirmidhiu.

¹⁶ Hadith: Transmeton Buhariu.

¹⁷ Hadith: Transmeton Ibn Maxheh.

¹⁸ Hadith: Transmeton Buhariu.

¹⁹ Hadith: Transmeton Ahmedi.

²⁰ Hadith: Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

²¹ Hadith: Transmeton Muslimi.

²² Hadith: Transmeton Buhariu.

POPULLSIA MYSLIMANE SOT DHE NESËR



Një në çdo tre myslimanë është më i ri se 15 vjeç. Prandaj, edukimi do të mbetet sfida më esenciale e të gjitha shteteve apo bashkësive myslimane.

Mr. Haki Sahitaj

Jemi të vetëdijshëm se thelbi i çdo gjëje qëndron në cilësinë që gjërat mbajnë përbrenda dhe e jashtëmja është manifestim i saj. Këtu nuk bën përjashtim as numri i popullsisë. Megjithatë, ne duhet të mos e neglizhojmë aspektin sasior të prezencës myslimane, pavarësisht se fokusi qëndron tek cilësia. Mendojmë se prezenca aktuale dhe ajo në të ardhmen mund të ndikojë pozitivisht në të gjitha aspektet; si në nivel të iniciativave personale, po aq edhe në atë në nivele shtetërore apo të bashkësive. Ne duhet ta marrim shumë seriozisht dhe të kemi parasysh faktin se sipas studimeve demografike numri i myslimanëve nëpër botë po rritet vërtet ndjeshëm. Kjo rritje duhet të na shtyjë të mendojmë shumë më seriozisht për prezencën e myslimaneve, për sfidat që na presin, për jetën dhe botën që duam të kemi. Cili do të jetë roli ynë me një popullsi me rritje të lartë? Prezenca më e

madhe nënkupton edhe sfida, kërkesa të reja; si do t'u përgjigjemi këtyre kërkesave etj.

Aktualisht, myslimanët janë i vetmi grup fetar që pritet të ketë rritje (në terma absolutë dhe relativë) në dekadat e ardhshme. Madje, këto studime na tregojnë se edhe numri aktual, në fakt, është më shumë se sa tregohet. Njëri aspekt ka të bëjë me shtete ku banorët janë popullsi myslimane dominuese dhe aspekti tjetër paraqet rritjen e kësaj popullate në vende si Evropa apo Amerika.

Këtu do të analizojmë disa nga shkaqet kryesore të kësaj rritje, sfidat dhe urgjencat me të cilat do të mund të përballen në të ardhmen e afërt myslimanët, kudo që të jenë.

PSE RITJE?

Në mes të shek. XX bota myslimane ka pësuar ndryshime dramatike nga ato njohëse, ideologjike, politike dhe demo-

grafike. Sot, të flasësh për botën myslimane, nuk do të thotë se po flasim vetëm për vendet e Afrikës veriore, ose ato të Azisë juglindore.¹ Sipas Pew Research Center, deri në vitin 2010 janë llogaritur të jenë 1.6 miliardë myslimanë, ose 23% e popullsisë globale.² Aktualisht zona më e dendur është ajo në Indi dhe Pakistan (344 milionë). Po sipas kësaj qendre, ky numër po vazhdon të rritet me ritme të shpejta në Evropë³ dhe në SHBA⁴. Në Kosovë myslimanët janë popullsi dominuese, rreth 95.6% e popullsisë; në Shqipëri 56.7% dhe Maqedoninë e Veriut me 32.0%.⁵

Në një studim që është bërë nga Sardar, Serra dhe Jordan, janë treguar disa arsye pse po rritet me ritme të larta popullsia myslimane. Si arsye e parë është shënuar numri i lartë i pjellorisë. Vlerësimet e fertilitetit në këto vende mund të variojnë nga 2.9 në 2.6 fëmijë për grua nga 2010 deri në 2015. Sipas të dhënave të KB, mesatarja globale për të njëjtin interval do të ishte 2.4 dhe kjo bie në 1.6 në vendet e

zhvilluara. Si arsye e dytë vjen numri i lartë i rinisë. Më pas vjen përmirësimi i kushteve shëndetësore në vendet myslimane, ku edhe shkalla e vdekshmërisë është ulur. Në dritën e përmirësimit të dukshëm të kushteve shëndetësore, nuk duhet të befashohet se shoqëritë myslimane mund të dëshmojnë rritje më të lartë të jetëgjatësisë. Në vitin 1990, jetëgjatësia myslimane ishte afro 62 vjeç në vendet me shumicë myslimane, por deri në vitin 2010 ajo ishte rritur tashmë në moshën 66 vjeç dhe parashikimet do të arrinin 73 vjeç deri në 2030.^{vi} Kjo rritje e popullsisë, e në veçanti numri i lartë i rinisë myslimane, e bën çështje në vete të menduarit se çfarë roli do të luajë kjo popullatë, e në veçanti rinia dhe çfarë sfida i pret vendet myslimane.

SKENARËT E SË ARDHMES

Mendoj se fati i të ardhmes së myslimaneve nuk do të jetë ndryshe nga fati i shumë popujve të tjerë nëse ne nuk do të bëjmë hapa të rinj drejt vendimmarrjes globale. Rritja e popullsisë myslimane është edhe shpresë, por edhe sfidë, që nuk do të jetë e lehtë. Kjo do të varet me çfarë vullneti dhe alternative do të shkojë kjo tek popullsia aktuale.

Kur një vendi i shtohet popullsia, natyrshëm atë vend e presin sfida me një popullsi më të lartë. Kërkesat për edukim, punësim do të jenë shumë më të larta dhe kjo mund të sjellë një rritje ekonomike, ose në të kundërtën një krizë më të madhe papunësie. Nëse marrim parasysh skenarët që mund ta presin njerëzimin në tërësi, shohim se ndryshimet e shpejta teknologjike dhe investimet e larta në *inteligjencën artificiale*, na tregojnë se strukturat e ndryshme sociale do të ndryshojnë me të madhe.^{vii} Teknologjia do të zëvendësojë shumë profesione të ndryshme dhe kjo nxit ndryshime të mëdha në edukimin dhe aftësimin e njerëzve, që të mund të përballojnë trendet e reja të së ardhmes. Duke u bërë një popullsi me numrin më të lartë, atëherë ata që do të mund ta pësojnë më shumë do të jenë pikërisht myslimanët. Nëse marrim parasysh kushtet që mund të kenë ose stilin e jetës perëndimore, vendet me popullsi myslimane në një të ardhme mund të shndërrohen dalëngadalë ndër popullsitë më të plakura. Kështu, nivelet e larta të plakjes kërkojnë nevoja të veçanta në strukturat shëndetësore, ekonomike etj. Ndërsa rritja e rinisë tregon se fati apo rruga e këtyre vendeve do të varet nga zgjedhja që do të bëjë rinia. P.sh UNESCO ka vendet e Arabisë Saudite me 5.660 studentë jashtë vendit, Iranin 4.254, Nigerinë 3.257, Pakistanin 2.502, Bangla-

deshin 1.614, Malajzinë 1.224 dhe Marokun 1.125, në njëzet vendet e saj të para për eksportues të studentëve jashtë vendit. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë në SHBA bëri një studim për të parë se sa studentë nga jashtë, të cilët ndiqnin gradën në STEM, dëshiruan të mbeteshin në Shtetet e Bashkuara pas diplomimit. Ndërsa studentët aziatikë përbënin pjesën më të madhe të studentëve që studiojnë jashtë vendit në Amerikë, 64% e tyre dëshirojnë të mbesin, ashtu si dhe 7% e studentëve nga Lindja e Mesme. Arabia Saudite ishte një nga udhëheqësit në këtë studim, me 5.4% të studentëve të saj jashtë vendit që dëshirojnë të qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara pas diplomimit.

Rritja e popullsisë myslimane po ashtu na tregon se aty ku myslimanët janë pakicë fetare shumë shpejt do të bëhen komunitete më të mëdha. Nëse në këto vende, si p. sh. Evropë ose SHBA, problemi i islamofobisë apo terrorit do të vazhdojë të rritet, atëherë kjo mund të ndikojë në uljen e lindjeve, si shkak i frikës dhe natyrës së ambientit ose pjesëmarrje më masive në aktivitetet terroriste.

Varfëria e lartë në vendet myslimane, për më tepër ku në shumicën e vendeve myslimane papunësia e të rinjve (moshat 15 deri në 24 vjeç) është relativisht më e lartë se mesatarja globale, mund ta shtyjë dhe më tepër rininë në rrugë të gabuara.^{viii} Për më tepër, myslimanët janë gjithashtu grupi fetar me popullsinë më të madhe rimore, gati 33% mesatarisht. Me fjalë të tjera, një në çdo tre myslimanë është më i ri se 15 vjeç. Kjo na bën me dije se edukimi mbetet në plan të parë si mjet për të vetëdijësuar popullsinë e re. Prandaj, edukimi do të mbetet sfida më esenciale e të gjitha shteteve apo bashkësive myslimane.^{ix} Nëse kjo popullatë nuk merr një edukim të mirë, atëherë rritja e popullatës do të thotë me tepër gjenerata të humbura, më tepër konflikte, më shumë emigrime, më tepër kriza identiteti fetar dhe kulturor.

MOZAIKU I PAQES DHE MYSLIMANËT

Rritja e popullatës myslimane nuk duhet parë si krenari përkundrejt popullsisë të tjera dhe kjo nuk duhet të merret si shkas për konflikte. Përkundrazi, në këtu synojmë të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësitë tona tani dhe nesër. Bota është lidhur jashtëzakonisht shumë - nga ushqimet që hamë, filmat që shikojmë, rrobat që veshim, edukimi që marrim, sfidat që po kalojmë... të gjitha këto janë të njëjta kudo. Madje dhe sfida e këtyre ditëve me virusin na tregon sa afër jemi bërë me vende që deri para pak kohësh ishin botë të largëta, siç është Azia. Rritja e populla-

tës myslimane si tani, por edhe në të ardhmen, do të jetë jetike për rolin dhe kontributin që do të japim në një botë me kriza nga më të ndryshme. Po të shohim edhe takimin e fundit në Davos, ndër çështjet që ishin në fokus të botës qëndrojnë sfidat klimatike, modelet e bizneseve, zhvillimet e mëdha teknologjike që po riformulojnë strukturat sociale, arsimore, sipërmarrjet etj. Tani shumë intelektualë po sugjerojnë një aktivizim të përbashkët për fatin e jetës sonë në këtë botë. Dhe, në gjeopolitikë nuk shikohet më si zgjidhje konkurrenca, por bashkëpunimi mes vendeve. "Ndërsa bota bëhet edhe më e ndërlidhur për sa i përket fluksit të informacionit, kapitalit dhe njerëzve, shtetet do të jenë më të varura nga njëra-tjetra për të realizuar rezultate pozitive për veten e tyre dhe komunitetin global", shkruan kryetari i forumit B. Brende.^x Dhe myslimanët si popullsi në rritje, jo vetëm që do të duhet të bëjnë më shumë, por ne duhet të luajmë edhe rolin kryesor në promovimin dhe nxitjen e solidaritetit global për një botë më të mirë. Sido që do të duam ta shikojmë botën, kushdo që është i vetëdijshëm për mozaikun global e di që ky mozaik do të mund të jetë më koherent vetëm me koherencën që myslimanët do të mbajnë në vetëdijen e tyre se, në fund të fundit, ne jemi përgjegjës për fatin e njerëzimit dhe të tërë botës së gjallë para Zotit. Fati ynë është i destinuar të jetë mënyra se si ne i shërbejmë njerëzimit dhe botës në emër të Tij.

PËRFUNDIM

Në çdo kohë dhe vend të jesh i pakët në numër mund të sjellë jetë të vështirë, por edhe numri i lartë nuk zgjidh çdo gjë në vetvete. I dërguari i Allahut na ka treguar se rritja e numrit mund t'i ngjajë shkumës së detit, pra që përsëri fati ynë do të jetë i trishtueshëm nëse nuk do të kemi një jetë në përputhje me besimin tonë. Në qoftë se nuk riorganizohet popullata e tanishme, nëse nuk do të punohet më shumë në infrastruktura më të mira edukative, nëse nuk merren parasysh sfidat e tanishme, në nivel shtetëror apo global, kjo rritje do të sjellë vështirësi edhe më të madha. Ndoshta papunësi më shumë, përkallëzim të terrorit, gjenerata të reja të tëhuajësuarish. Të jemi më shumë, do të thotë: më shumë përgjegjësi, ose më shumë vuajte. E ardhmja nuk është matematikë, që me statistika të parashikojmë të ardhmen, por ato na ndihmojnë të mendojmë për një alternativë dhe zbulojnë potencialin që kemi. Është në dorën tonë të zgjedhim se në çfarë drejtimi do të na çojë

'krenaria' e tanishme. (Prizren, gusht 2020)

(Autori është magjistër i shkencave islame nga Kosova)

ⁱ Të shikohet parathënia nga John L. Esposito (ed) në The Oxford History of Islam, Oxford University Press, New York, 1999, fq. IX.

ⁱⁱ World's Muslim population more widespread than you might think, <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2017/01/31/worlds-muslim-population-more-widespread-than-you-might-think/> lexuar më 2020-02-06

ⁱⁱⁱ Sipas statistikave nga viti 2015 popullsia myslimane në Evropë nga 4.9%, deri në 2050 pritet të rritet në 14.0%, shih: Europe's Muslim population will continue to grow – but how much depends on migration, në <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2017/12/04/europes-muslim-population-will-continue-to-grow-but-how-much-depends-on-migration/> lexuar më 06.02.2020.

^{iv} Numri aktual i myslimanëve në SHBA, sipas kësaj qendre kërkimore, është 3.45 milionë deri më 2017, ose 1.1% e popullsisë totale. Në bazë të trendit rritës demografik, kjo qendër parashikon një rritje deri në 8.1 milionë deri më 2050, ose 2.1% e popullsisë. Shih për më shumë: New estimates show U.S. Muslim population continues to grow, <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2018/01/03/new-estimates-show-u-s-muslim-population-continues-to-grow/> lexuar më 2020-02-06.

^v Statistikat për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut janë të bazuara sipas të dhënave rajonale në ENCYCLOPEDIA BRITANNICA, shih <https://www.britannica.com>.

^{vi} Muslim Societies in Postnormal Times/Fore-sight for Trends, Emerging Issues and Scenarios, Ziauddin Sardar, Jordi Serra and Scott Jordan, IIIT&CPPFS, 2019, UK, fq. 5-9.

^{vii} Për sfidat që do të sjellë teknologjia në të konceptuarit dhe jetuarit tonë të lirisë, të barazisë, punësimit, edukimit, lexoni librin e Yuval Noah Harari, 21 Leksione për Shekullin 21, Sh.B. Botart, Tiranë, 2019, fq. 3-81. Dhe një libër që është përgatitur nga një grup autorësh për sfidat e reja që do të sjellin studimet e bëra në njohjen e trupit të njeriut dhe marrëdhënies që kjo shkencë po formon me fuqinë teknologjike. Pushteti i ri, që shtete apo korporatat do (po) fitojnë falë bioteknologjisë, do të jetë tepër sfiduese për strukturat e tanishme, duke filluar nga roli ynë si qytetarë e deri tek pikëpamjet tona si njerëz. Aq lart ka shkuar skepticizmi, sa disa janë shprehur se në të ardhmen ne nuk do të jemi duke luftuar një elitë ekonomike që shfrytëzon njerëzit, por një elitë të re ekonomike që s'do të ketë nevojë për ta. Për më tepër shih: Sean D. Sutton (ed), Biotechnology/Our futures as Human Beings and Citizens, Suny Press, New York, 2009.

^{viii} Po aty, fq. 9.

^{ix} Nexhat Ibrahim, Reformimi i të menduarit mysliman, Sherja, mars 2020, fq. 35.

^x Shih raportin e këtij forumi në <https://www.weforum.org/reports/geopolitics-in-the-21st-century-competition-or-cooperation>.

SI POPULLI, ASHTU EDHE HOXHA



"Bëni atë që thotë hoxha, mos bëni atë që bën hoxha" (thënie)

Nga Zehrudin Hadžić

Unë kam shkruar për shumë kategori njerëzish dhe ende nuk kam shkruar për efendilerët. Edhe unë jam efendi dhe jam krenar për këtë.

Kur një anëtar i moshuar i xhematit më quan "efendi", unë përgjigjem dhe jam i kënaqur, sepse e di që ai e thotë atë me respekt. Kur dikush tjetër, sidomos disa, më quajnë "hoxhë", unë nuk përgjigjem, sepse e di që nuk e bëjnë nga respekti, por për të më treguar se ku e kam vendin - siç mendojnë ata - vetëm në xhami, për shkak se të tillët duan që Islamin ta vendosin dhe ta mbajnë vetëm në xhami. Feja u pengon jashtë xhamisë, për shkak se nuk mund të bëjnë ç'të duan nëse Islami del jashtë mureve të xhamisë.

Kështu që ata pak vijnë në xhami, pak i luten Zotit, ndërsa pastaj jashtë xhamisë rrejnë, vjedhin, bëjnë qufër e kështu me radhë. Unë pres që ata të më drejtohen me Efendi, ose me Reis dhe t'u përgjigjem.

Të kthehem tek hoxhallarët! Efendi ose imam në kuptimin zyrtar, ose hoxhë në gjuhën popullore, janë fjalë me kuptime të ndryshme.

Fjala efendi do të thotë zotëri, ndërsa fjala imam do të thotë udhëheqës-prijës. Kuptimi i fjalës hoxhë është postiqe. Që disa ta shkelin, ndërsa disa ta kenë për zbukurim. Efendia ka xhybe dhe ahmedije (fes). Ahmedija është fes i kuq, i mbështjellë me pëlhurë të bardhë dhe është simbol i dallueshëm në jetën e efendilerëve. Ngjyra e kuqe është ngjyrë e gjakut dhe e jetës, ndërsa ngjyra e bardhë është simbol i pastërtisë. I jetës së pastërtisë!

Efendilerët janë një popull i veçantë, një botë e veçantë. Udhëheqës të xhematit, mësues të fesë. Me njerëzit janë në të mirë e në të keqe. Ka që janë të mirë dhe ka që nuk janë të tillë; ka që janë të ditur dhe të stërditur. Për popullin janë gjithnjë në shërbim. Më shumë duan të flasin sesa të shkëmbejnë diçka. Shpesh gjenden



ndërmjet popullit dhe pushtetit, për shkak se as njëri, as tjetri nuk mundet pa ta. Urë që i lidh botët njerëzore. S'i duan as "besimtarët" e mëdhenj, as mëkatarët e mëdhenj.

Efendilerët janë me të rinjtë e me pleqtë, me fëmijët dhe me të pamundshmit në ditën e lindjes së njeriut dhe në ditën e vdekjes së tij. Ata janë me xhematlinjtë në gëzim e në hidhërim. Kur jeni me ta, ose do të hani diçka të mirë, ose diçka të bukur do të dëgjoni!

Ata janë me të gjallët dhe me të vdekurit. Ndokush do të kishte dashur që efendilerët të mos jetojnë dhe të mos hanë, vetëm t'i luten Allahut. E "pësojnë" shumë njerëz dhe tregimet e tyre, për shkak se secili dëshiron t'u bëjë gjyqin, t'u bëjë kaktimin dhe t'u shkruajë vendimin. Me këtë paralajmëroni ata që nuk dinë ose që nuk kuptojnë se dinin e tyre ata nuk e japin, ndërsa shumë prej asaj që iu bëhet mund të durojnë.

Burimi:

<https://www.facebook.com/glavniimam.medzlisajce.9/posts/744621709668448> (9.08.2020; boshnjakisht)

(Nga boshnjakishtja/maqedonishtja, përktheu: Nuredin ef. Sherifovski, Imam në Xhaminë e Jellovës, Studenica, Shkup. Përpunoi: N. Z. Zehrudin Hadžić /Zehrudin Haxhiq është Hoxhë nga Jajca, Bosnjë e Hercegovinë)

XHAHILIJETI SHPËRFAQ LARGIMIN NGA ALLAHU

Ai e trajton Islamin si një "rend dhe program hyjnor të jetës". Sipas tij, injoranca nuk ka të bëjë vetëm me njerëzit e Arabisë para Islamit, sepse shoqëritë injorante shfaqen në çdo kohë dhe në çdo hapësirë.

Shkruan: Nexhat Ibrahim
(Enkas për HeR)

Muhamed Kutubi është njëri prej dijetarëve më të njohur të shekullit XX në botën arabe-myslimane, edhe si aktivist shoqëroro-politik, por edhe si autor i dhjetëra veprave në fusha të ndryshme. Ai jetoi gjatë, por jetën e mbushi me përmbajtje të shumta: besim, vepruese dhe intelektuale.

Muhamed Kutubi lindi më 26 prill 1919 në fshatin Musha, afër Asjutit, në Egjiptin e Epërm. Muhamedi ishte fëmija i dytë nga pesë fëmijët e familjes Kutub. Sejjid Kutubi, më i njohur për ne, është fëmija i parë, disa vjet më i vjetër se Muhamedi.

Bashkë me nënën, vëllezërit dhe motrat jetuan në lagjen Hilvan të Kajros, aty nga viti 1926. Babai i tij, Ibrahim, ishte bujk e i pashkollë, por e donte dijen dhe i përkiste rendit shazili; ndërsa nëna, Fatimja, vinte nga një familje dijetarësh. Të dy ishin dashamirë të arsimit dhe mësuesit e parë të fëmijëve të tyre dhe trasues të rrugës së dijes dhe përkushtimit në rrugën e Allahut. Muhamedi më vonë do të thotë se Sejjadi kishte ndikuar tek ai më shumë se çdo kush tjetër.

Në Kajro, bashkë me Sejjidin kryen shkollën fillore dhe të mesme. Në Universitetin e Kajros, Departamenti i Filologjisë Angleze, më 1940 mori diplomën e fakultetit. Në vitin 1941 ai mori edhe një diplomë në psikologji dhe arsim nga Shkolla e Lartë e Mësuesve.

STUDIUES I IDEVE MATERIALISTE

Derisa ishte student, nëpërmjet vëllait, Muhamedi ishte njoftuar me shumë shkrimtarë e mendimtarë, sikurse me Abbas M. Akkadin, kurse nga të huajt e lexoi më së shumti Freudin, Marks, Dur-



kheimin dhe Darwinin. Gjatë periudhës pas fakultetit, ai studioi në hollësi idetë materialiste dhe më vonë do të bëhet kritikues i rreptë. Teoritë e tilla ofrojnë një interpretim materialist të origjinës njerëzore, të substancës njerëzore dhe të jetës njerëzore si individë, ose si bashkësi, dhe janë

në kundërshtim rigoroz me fenë islame. Pasi mbaroi arsimimin e nevojshëm, Muhamed Kutub mësoi anglisht për katër vjet. Pastaj punoi në shtëpinë botuese "Dar-ul-kutub el-Misrije" për një kohë, e më vonë do të punojë si përkthyes në Ministrinë e Arsimit.

Në fund të viteve 1940 ai u takua me lëvizjen e Ihvân'ul-Muslimînëve, por nuk hyri si aktivist në organizatë; ndryshe nga Sejjid Kutubi, i cili u bë pjesë udhëheqëse e tyre. Pas kthimit të Sejjid Kutubit nga SHBA-të më 1950, ku Sejjadi ishte transformuar nga një properëndimor në një fanatik të vetjakes dhe vendores, filloi periudha e vuajtjeve dhe persekutimeve nga regjimi, të cilin paraprakisht Ihvanët e ndihmuan ta rrëzojnë mbretërinë dhe ta marrë pushtetin. Vuajtja e familjes Kutub manifestohej në dy anë kryesore: 1) Problemet me regjimin prokomunist të Xhemal Abdunaserit, i cili mbylli rrugët për zhvillimin e fesë islame, duke imponuar mënyra socialiste të politikës, ekonomisë, kulturës etj. 2) Problemet sociale në familje, meqë Sejjadi si kryefamiljar ishte në thumb të shtetit.

Zhvillimet që ndodhën para dhe pas grusht shtetit ushtarak në Egjipt në vitin 1952 ishin një pikë kthese për vëllezërit Kutub, ashtu si edhe për shumicën egjiptiane. Muhamed Kutub është njëri nga dëshmitarët më të rëndësishëm të kësaj periudhe. Edhe pse kryetari egjiptian Xhemal Abdunaseri dhe Sejjid Kutubi fillimisht flisnin mes vete dhe ndonjëherë shkëmbejnë ide në stilin e bisedave, shumë shpejt Xhemal Abdunaseri dhe lëvizja Oficerët e Lirë dhe Vëllezërit Myslimanë do ta ashpësojnë retorikën, duke u ndarë nga njëri-tjetri. Oficerët e Lirë, duke u ditur forcën e Vëllezërve Myslimanë, ndërmorën masa publike e jobpublike për t'i demaskuar, madje edhe për t'i torturuar, burgosur dhe vrarë.

Në vitin 1954, pas një atentati (?) të dështuar ndaj kryetarit Xhemal Abdunaser, Muhamed Kutubi u arrestua së bashku me vëllanë Sejjidin dhe shumë anëtarë të Ihvân'ul-Muslimînëve.

Pas disa muajve Muhamedi u la i lirë, sepse ai ishte arrestuar më shumë për t'i ngritur kurth Sejjid Kutubit dhe për ta vënë në sprovë atë, sesa për ndonjë veprim konkret të Muhamedit. Vëllai Sejjadi mbeti në burg.

Këto ngjarje çuan në ndryshime të rëndësishme në jetën e tij ideore. Sipas fjaleve të tij, derisa letërsia dhe poezia deri atëherë zinin një vend të rëndësishëm në jetën e tij, prej tash vendosi t'i bashkohet drejtpërdrejt lëvizjes së Ihvanëve 'në luftimin e veprimtarive antislame të regjimit në shoqërinë egjiptiane'.

M. Kutubi rrëfen se torturimi i tij dhe vëllait në burgjet ushtarake egjiptiane ishte i paparë. Ai pohon se torturat fizike dhe psikike kishin lënë pasojë të dukshme në shëndetin e tij. Por, nga ana tjetër, ditët e burgut e kishin mësuar Mu-

hamedin se ecja rrugës së Allahut kërkon sakrificë të plota, pa llogari matematikore.

Gjatë dekadës vijuese Muhamedi shkroi dhjetëra libra, shumica e të cilave u bënë manualë për anëtarët e Ihvanëve. Sejjid Kutubi, i cili ishte në burg i dënuar me 15 vjet, filloi rishikimin dhe rishkruesjen e dorëshkrimit të Tefsirit të Kuranit, me titull *Fî dhilâl'il-Ķur'ân*. Vetëm në vitin 1964 Sejjid Kutubi u lirua nga vuajtja e dënimit, edhe atë me iniciativën e presidentit irakian Abdusselam Ârif.

Por, një vit më pas, më 1965, Muhamed Kutubi u arrestua me akuzën e krijimit të një organizate të fshehtë të quajtur "Tendhim". Bashkë me të u arrestuan edhe Sejjid Kutubi, motrat dhe nipërit e tij. Si rezultat i gjyqimit të gjatë, Sejjid Kutub u dënua me vdekje me tre miq të tij dhe ai u ekzekutua më 29 gusht 1966. Muhamed Kutubi më vonë deklaroi se arsyeja kryesore për arrestimin e tij dhe të vëllait ishte kritika radikale në veprën e tij *Xhahilijet-ul-ĳarn'il-'ishrîn* dhe veprës së vëllait Sejjidit *Me'âlimu fi't-ĳarik*.

Muhamed Kutubi mbeti në burg deri në vitin 1971, kur kryetari vijues i Egjiptit, Enver Sadat, e liroi. Muhamedi pas vrasjes së vëllait u josh nga qeveria me post në ministri e të tjera, por ai i refuzoi të gjitha dhe tregoi se 'beteja vazhdon'. Menjëherë Muhamedi dhe familja ikën për Arabi, ku ai gjeti strehim dhe filloi mësimdhënien si profesor në fakultetin e universitetit "Mbreti Abdulaziz" në Mekë. Vetëm në vitin 1973 Muhamedi u martua.

Gjatë qëndrimit në Arabi dhe punës në universitetet "Mbreti Abdulaziz" dhe "Umm'ul-Kurra", ai i redaktoi veprat e Sejjid Kutubit dhe i dha për botim. Është mendim i shumicës, por edhe i orientalistëve, si John Calvert, që Muhamed Kutubi pas transferimit në Arabinë Saudite, konceptin "Sejjid Kutub" e bëri më të moderuar dhe më apolitik.

Kritikët thonë se Muhamed Kutubi konsiderohet njëri prej themeluesve kryesorë të mendësisë që do të dominojë në Arabi, një prej ideatorëve të shkollës së re ideologjike brenda universiteteve të Arabisë Saudite, gjë të cilën e ka arritur përmes shumë tezave të mbikëqyruara nga vetë ai. Kjo shkollë më vonë do t'i radikalizojë qëndrimet ndaj shkollave/medhhebeve tjera dhe do të vijë deri te një ekstremizëm, e që po zgjat deri në ditët tona nëpërmjet rrymave të ndryshme.

ÇMIM NGA MBRETI FEJSAL

Periudhën tjetër të jetës së tij Muhamedi e kaloi duke mësuar e studiuar. Ai mori Çmimin Ndërkombëtar të Studimeve

Islame të Mbretit Fejsal në vitin 1988 për veprën e tij *Menhexh'ut-terbijjet'il-islamijeh*, në dy pjesë, të cilën e shkroi në fillim të viteve 1960.

Ai mori pjesë në shumë takime shkencore në Lindje dhe në Perëndim, veçanërisht në vendet arabe, dhe ligjëroi si pedagog vizitues në universitete të ndryshme. Pavarësisht se ishte larg politikës aktuale në Arabinë Saudite, ai u citua nga disa shkrimtarë perëndimorë si arkitekt ideologjik i lëvizjes Sahwî, që u shfaq si rezultat i shkrirjes së ideologjisë së vehâbizmit dhe ihvânizmit në vitet 1970 dhe u quajt "Sahve Shejh". Pas pensionimit dhe largimit nga universiteti më 1996, ai e kaloi pjesën tjetër të jetës së tij duke shkruar artikuj e libra.

Muhamed Kutubi ndërroi jetë në vitin 2014, në Xhide, në spitalin ku mjekohej. U varros në prani të një numri të madh besimtarësh.

Muhamed Kutub ishte një autor, studiues dhe mësues islamist, i njohur si vëllai më i ri i mendimtarit islam Sejjid Kutub.

Muhamed Kutub shquhet po ashtu edhe për aftësitë e tij letrare dhe njohuritë e tij të gjëra në fushën e edukimit dhe të psikologjisë. Po ashtu, ai një përkushtim të veçantë ia ka dhënë edhe ballafaqimit me ideologjitë perëndimore, duke u munduar që t'ua bëjë njerëzve sa më të qartë se Islami është alternativa e vetme për mbarë njerëzimin.

Për ta sendërtuar këtë botëkuptim, ai pa pushim shkroi dhe ligjëroi. Ai është autor i 36 veprave, ndërsa vepra që e kemi në duar, "Dirasat kur'anijeh - Studime kur'anore", është ndër veprat studioze, themeltare të tij, bazë për studimet tjera.

Lexuesin do ta kursejmë nga interpretimet e veçanta, me qëllim që vetë ai të gjejë atë që i nevojitet karshi nevojave intelektuale dhe besimore. Ky shkrim njoftues, mbase dhe kjo vepër e përkthyer, do t'i japë vlerën këtij autori mysliman dhe do t'i udhëzojë të interesuarit për veprat tjera të tij.

Muhamed Kutubi vazhdoi ideologjinë e Ebu'l-Ala Mewduidit, Abu'l-Hasan Nedewiut dhe Sejjid Kutubit. Muhamedi ndërtoi idetë e tij kryesisht si përgjigje karshi kolonializmit perëndimor dhe ndikimit të këtij sistemi kolonial në gjeografinë islame në mënyrat moderne. Pothuajse në të gjitha veprat e tij është e pranishme edhe një kritikë karshi myslimanëve, për të cilët ai mendon se kanë një simpati të verbër ndaj ideve perëndimore dhe strukturave të tyre politike e ndërtojnë sipas sistemeve të jashtme.

Përveç kësaj, ai ka shkruar vepra në

shumë fusha të tilla si: Interpretimi i parimeve të besimit islam, Kuptimi i Kuranit, Metodologjia e historisë, artit, psikologjisë dhe edukimit.

Muhamed Kutub e trajton Islamit si një "rend dhe program hyjnor të jetës". Sipas tij, injoranca nuk ka të bëjë vetëm me njerëzit e Arabisë para Islamit, sepse shoqëritë injorante shfaqen në çdo kohë dhe në çdo hapësirë. Tipari i përbashkët i këtij xhahilijeti është largimi nga Allahu, ku ndryshojnë vetëm imazhet dhe koloriti i jashtëm.

Muhamed Kutubi punoi edhe në relaksim e ideve të tij të shkruara në kohë tendosjeje, në relaksim e ideve të Sejjidit dhe Ihvanëve në përgjithësi dhe u mor për pajtimin e vëhabizmit saudit dhe Ihvanëve. Ka edhe lëvizje në këtë plan. Në vitin 1986, Sefer Haval mbrojt doktoratën në mbikëqyrjen e Muhamed Kutubit (i cili bëri një miksi të ideve vëhabiste dhe të S. Kutubit).

M. Kutub pohoi se historia nuk është vetëm përcjellje e formale e ngjarjeve, por edhe interpretimi dhe vlerësimi i tyre. Historia duhet të jetë dinamike dhe këshilluese për myslimanët dhe të tjerët. Me këtë rrugë ai qorton sofizmin, se në vend të përbaljes dhe luftimit të së keqes, ai largohet nga problemet e botës, për të ngadhënjyer e keqja.

Angazhimi kritik i M. Kutubit në prezantimin e Islamit para intelektualëve të arsimuar, si karshi prezantimit konservativ të mësimëve islame, ashtu edhe karshi ideologjive moderne - si kapitalizmi e socializmi - duke ofruar Islamit, ndikoi në një pjesë e arabëve jashtë truallit vendor, në Perëndim. Përse? Sepse "globalizmi që myslimanët ankohen, i ka vënë në shënjestër të parët myslimanët, të cilët ndryshe quhen 'bota e tretë', 'shtetet e pazhvilluara', 'shtetet e varfra' etj".

Muhamed Kutub vdiq në një spital në Mekë më 2014, në moshën 95 vjeç. (Prizren, 2020)

ⁱ Shiko: Hilal Görgün, *Muhammed Kutub, Islam Ansiklopedisi*, EK-2, fq. 307-310, 2016, Stamboll.
ⁱⁱ Muhamed Kutub, *Bota në fokusin islam*, Tiranë, 2006 etj.
ⁱⁱⁱ https://ar.wikipedia.org/wiki/%D8%B3%D9%8A%D8%AF_%D9%82%D8%B7%D8%A8
^{iv} https://ar.wikipedia.org/wiki/%D8%B3%D9%8A%D8%AF_%D9%82%D8%B7%D8%A8
^v Sipas: Hilal Görgün, po aty.
^{vi} Shiko: Xhabir Rizk, fq. 140 etj.
^{vii} Sipas: Hilal Görgün, po aty.
^{viii} Sipas: Hilal Görgün, po aty.
^{ix} https://ar.wikipedia.org/wiki/%D8%B3%D9%8A%D8%AF_%D9%82%D8%B7%D8%A8
^x Masami Nishino, *Muhammad Qutb's Islamist Thought: A Missing Link between Sayyid Qutb and al-Qaeda?*, në: http://www.nids.mod.go.jp/english/publication/kiyo/pdf/2015/bulletin_e2015_6.pdf.
^{xi} Mansoor Jassem Alshamsi, *Islam and Political Reform in Saudi Arabia: The Quest for Political Change and reform*, Nju-Jork/Londër, 2007, fq. 59 e tutje.
^{xii} Sipas: Hilal Görgün, po aty.
^{xiii} Lacroix, *Awakening Islam*, fq. 52, 53.
^{xiv} Muhammed Kutub, *Dirasat Kur'anijeh, Dar'ush-Shurut*, Beirut, (-).
^{xv} https://ar.wikipedia.org/wiki/%D8%B3%D9%8A%D8%AF_%D9%82%D8%B7%D8%A8
^{xvi} Muhammed Kutub, *A jemi myslimanë*, Shkup, 1420/ 1999; Muhamed Kutub, *Bota në fokusin islam*, Tiranë, 2006 etj.
^{xvii} Elmer Swenson, po aty.
^{xviii} Muhamed Kutub, *Myslmanët dhe globalizmi*, (-), 2019.

PROFETOLOGJIA DHE FILOZOFIA HELENISTIKE NË KORPUSIN E FARABIUT

BOTA MË E MIRË BËHET ME NJË NJERI MË TË MIRË

Njeriu i këtij filozofi gjatë procesit të njohjes së të mirës vetëm se ka filluar të bëhet i mirë dhe kulmi është shkrirja në të mirën supreme. Në këtë aspekt, njeriu si individ e ka arritur plotësinë. Vetëm dashuria i lidh njerëzit dhe i bën një trup; më pas, dashuria është ajo që e lidh shkakun e parë me botën.

Shkruan: Ramazan Fetahu (Enkas për HeR)

Në mendimin e Farabiut shpirti dhe trupi, feja dhe filozofia, i gjejnë vendin njëra-tjetër brenda sistemit të tyre. Në këtë aspekt, etika filozofike religjioze e Farabiut, në dallim nga ajo e grekëve të hershëm, është më e avancuar, sepse formon një trekëndësh, i cili zbret nga Zoti te njeriu dhe më pas nga njeriu te bota. Ky trekëndësh formon konceptin e humanitetit.

Në aspektin juridik drejtësia është parimi themelor mbi të cilin vendoset sistemi i Farabiut. Në aspektin etik e mira është synim që përherë synon Lumturinë dhe në aspektin estetik dashuria mbisundon si ligj i tërheqjes fillimisht ndërnjerëzore dhe më pas në mes njerëzimit dhe Qenies së parë (Zotit). Në këtë mënyrë drejtësia, e mira dhe e bukura ngrihen si orientime sublime për avancimin e karakterit moral. Por, çështja më fundamentale dhe më e rëndësishme përmes së cilës njihet drejtësia ishte edebi (edukimi).

Farabiu mendon se me edukim të fuqishëm arrin të kalitet ose të ndryshohet karakteri njerëzor, varësisht sipas cilësisë që posedon. Por, kjo kalitje si çekiç duhet të përdorë të Mirën, kurse mjeshtri që i mëshon ç-

kiçit të së Mirës duhet të jetë bartës i gjallë i përvojës fetare, ose mësues shpirtëror. Përvoja e së shenjtës nuk bartet vetëm përmes librave, sikurse karakteri njerëzor, i cili nuk mund të ndryshohet vetëm përmes mësimëve teorike. Kërkohet një ndërlidhje mes traditës filozofike, e cila vjen si e thatë, dhe traditës së gjallë të shpalljes hyjnore, e cila frymëzon në çdo kohë. Përvoja transcendentë është shumë më vështirë e arritshme sesa mësimi i tërë dijes filozofike. Por, ajo është e domosdoshme për bartjen e shpalljes nga njëra kohë në tjetrën. Këtë element Farabiu në mënyrë mjeshtrë e ka përpunuar dhe instaluar brenda sistemit të tij filozofik. Në këtë aspekt, filozofisë së tij i ka dhënë dinamikë dhe virtualitet aktiv dhe e ka bërë si sistem të gjallë, i cili u përshatet të gjitha kohëve dhe hapësirave për shkak se Farabiu sistemin e tij e ka ndërtuar në analogji me sistemin hyjnor dhe më pas këtë sistem ia ka vendosur Shpalljes dhe profetësisë si hije e cila do t'i përcjellë përherë. Aty ku do të ketë përvojë të së shenjtës, do të ketë edhe një model organizimi të përbotshëm.

TRANSFORMIMI I BOTËS

E mira sublime zbret te njeriu në formën e përndritjes përmes frymëzi-



mit nga inteligjenca e parë dhe implikimi i kësaj ndjenje e transformon botën në një botë më të mirë. Bota më e mirë bëhet atëherë kur kemi një njeri më të mirë, i cili kalon nëpër filtrat e moralit. Njeriu i Farabiut gjatë procesit të njohjes së të mirës vetëm se ka filluar të bëhet i mirë dhe kulmi është shkrirja në të mirën supreme. Në këtë aspekt njeriu si individ e ka arritur plotësinë.

Mirëpo, kur kemi parasysh se njeriu është genie sociale, ai nuk mund të pajtohet pa e shtrirë të mirën edhe në aspektin social. Ky është edhe elementi i tretë, "elementi estetik" i filozofisë morale të Farabiut. Këtu hyn dashuria. E mira individuale është lumturia dhe plotënia individuale, kurse e mira dhe lumturia shoqërore do të thotë një njeri i zmadhuar ose një shoqëri e lumtur, e cila e ka realizuar të mirën publike. Ky është kuptimi i shtetit virtuoz të Farabiut, ku mbizotëron dashuria. Vetëm dashuria i lidh njerëzit dhe i bën një trup, e më pas dashuria është ajo që e lidh shkakun e parë me botën.

Një element tjetër me rëndësi në filozofinë e Farabiut është ndërlidhja e metafizikës dhe teologjisë, konkretisht harmonizimi i Shpalljes dhe pejgamberisë me mësimet filozofike. Doktrina e Farabiut rreth krijimit të botës është e ndryshme nga ajo e Aristotelit. Shkaku i parë i Aristotelit, i cili e vë botën në lëvizje, përherë ngelet aty si forcëdhënëse; për pasojë, edhe bota e merr atributin e amshueshmërisë - akuzë kjo të cilën ua kishte bërë Gazaliu filozofëve peripate-

tikë islamë, të cilët i konsideronte si ndjekës besnikë të Aristotelit. Në këtë fokus doktrina e intelektualëve, e zhvilluar nga Farabiu, është me interes të shpjegohet shkurtimisht.

Sipas Farabiut, Allahu është Qenia e parë dhe e domosdoshme (vaxhibul vuxhud) për nga vetë ekzistenca e Tij. Ai përveçse është Qenie e domosdoshme në raport me Vetën, në raport me botën është Intelekti i parë (El-aklu'l Evvel). Inteligjenca e parë është shkaku fillestar i krijimit të inteligjencës së dytë dhe njëherazi paraqitja e shumësisë. Nga inteligjenca e dytë dalin në pah paratrajta e krijimeve ose paraqitja e formave në vetvete, që ndryshe njihet si bota e shpirtave. Më pas nga inteligjenca e dytë buron inteligjenca e tretë dhe paraqitja e tretë e formave të krijimit. Kjo njihet ndryshe si bota e yjeve. Më pas nga inteligjenca e tretë del inteligjenca e katërt dhe rregulli i përsosur i krijimit. Nga inteligjenca e katërt buron inteligjenca e pestë, e cila tashmë fillon e merr nuanca të formave materiale. Kështu me radhë, nga inteligjenca e pestë del inteligjenca e gjashtë, ose sfera e simboleve. Nga inteligjenca e gjashtë del inteligjenca e shtatë ose sfera e diellit. Nga inteligjenca e shtatë vjen ajo e teta, ose sfera e Venusit - planetit më të afërt me Diellin. Nga inteligjenca e tetë buron inteligjenca e nëntë ose sfera e Merkurit. Nga inteligjenca e nëntë vjen inteligjenca e dhjetë ose sfera e Hënës.

Këtu paraqitet forma përfundimtare e objekteve materiale. Intelekti i dhjetë njihet ndryshe edhe si Inteligjencë aktive

(feal akl). Objektet në botën (ekzistuese) më poshtë se inteligjenca aktive e marrin formën përmes inteligjencës aktive.

Nga inteligjenca aktive vijnë në ekzistencë të gjitha krijesat në botë, duke përfshirë këtu edhe botën bimore, shtazore dhe njerëzore. Por, në raport me njeriun inteligjenca aktive (feal akl) ka një lidhje aktive. Ajo është e derdhur te secili njeri dhe nga fakti se ndodhet te secili njeri, atëherë njerëzit potencialisht kanë mundësinë për ta arritur inteligjencën aktive. Arritja e saj njëherazi është edhe Lumturia në vetvete, e cila do të shpjegohet më pas, kur do të shkruajmë për Lumturinë. Për faktin se bota intelektive del në pah vetëm në raport me qenien njerëzore dhe jo me materien dhe me botën e kafshëve, atëherë ato bëjnë përjashtim nga ky rregull. Një gjë është interesante te Farabiu: kur flet për shtetin e virtutshëm, ai nuk e ka fjalën për një shtet me bedena gjeografikë; ai flet për një botë metafizike të virtutshme dhe ky virtut realizohet tek inteligjenca aktive (feal akl). Për aq sa bota e materies nuk ka një esencë prej Intelekti, atëherë ajo në të vërtetë nuk ekziston. Realizimi i qytetit ideal të Farabiut do të nënkuptonte realizimin e njeriut brenda inteligjencës aktive dhe në këtë rast bota do të pushonte së qeni materie dhe në statusin e Intelektit ajo do të fitonte amshueshmëri. Në këtë kuptim, Farabiu flet për amshueshmërinë e botës jo në kuptimin e materies, por në kuptimin e pasqyrimin të intelektit. Ibn Ruzhdi i argumenton Gazaliut, i cili i kritikon filozofët peripate-

tikë islamë për konceptin e amshueshmërisë së botës. Dallimi i filozofisë peripatetike dhe asaj të Gazaliut qëndron në këndvështrime se prej nga shihet problemi. Gazaliu shikon nga poshtë-lart, kurse filozofët peripatetikë nga lart-poshtë.

PEJGAMBERI-FILOZOF

Kur flasim për qytetin virtual të Farabiut, pa dyshim duhet të kemi parasysh edhe një aspekt tjetër me rëndësi. Farabi është i pari në mesin e dijetarëve dhe filozofëve islamë i cili konceptin e pejgamberisë e futi brenda diskutimeve filozofike, për faktin se Pejgamberi konsiderohet udhëheqës edhe shpirtëror edhe politik. Farabi ecën shtigjeve të bashkimit të rrugëve të pejgamberit dhe të filozofit. Për Platonin udhëheqja i takon mbretit-filozof, kurse te Farabi udhëheqësi është pejgamberi-filozof, duke mos e mohuar ose kontestuar institucionin e

pejgamberisë.

Njerëzit, siç e thamë më lart, potencialisht janë kandidatë për arritjen e lumturisë, por jo te secili njeri është i zhvilluar ky potencial në mënyrë të barabartë. Kështu që çdo njeri nuk ka mundësi të arrijë lumturinë dhe shtohet nevoja për udhëheqës shpirtëror. Udhëheqësi shpirtëror është ai që i ka të zhvilluara aftësitë më tepër sesa njeriu i zakonshëm dhe ka arritur bashkimin me inteligjencën aktive (feal akl). Ky njeri meriton të bëhet kryetar shteti. Në dallim nga pejgamberi, i cili për bazë merr shpalljen, që arrin ta kapë përmes imagjinatës, filozofi për bazë merr përndritjen filozofike (në aktin e bashkimit me akl feal), të cilën e arrin përmes fuqisë së arsyetimit. Dallimi mes njëres dhe tjetres qëndron në atë se pejgamberi zgjidhet të jetë pejgamber dhe i jepet Shpallja, kurse filozofi e arrin Urtësinë përmes arsyes. Dihet se përndritja arrihet vetëm tek bashkimi me inteligjencën aktive dhe

shpirti i udhëheqësit duhet të jetë i lidhur përherë me të. Dija nga Zoti arrin tek inteligjenca aktive dhe nga ajo pastaj te kryetari i shtetit, te pejgamberi ose filozofi.

Kur marrim parasysh kriteret që vendos Farabi në zgjedhjen e kryetarit të shtetit, atëherë do të shohim se ato janë kriteret të cilat i përkasin vetëm një pejgamberi. Në anën tjetër, ato janë kriteret të mundshme për t'u arritur. Në këtë formë Farabi bën një dallim mes pejgamberit dhe njeriut të zakonshëm. Rreptësia në kriteret morale dhe fizike për zgjedhjen e udhëheqësit të shtetit e drejton shoqërinë drejt përsosjes, ose drejt më të mirës së mundshme njerëzore.

Në këtë aspekt Farabi mundohet të krijojë një sistem të përsosur filozofik-fetar, ku teologjia do t'i shprehë dogmat e veta përmes mekanizmave filozofikë. Në këtë vijë të ndërmjetme, në mes teologjisë dhe filozofisë, e krijojnë rrugën e vet etika filozofike e Farabiut.

TREGIM

KUR SHEJTANI E ZGJIDH GOMARIN...

Një gomar ishte i lidhur për një peme. Erdhi shejtani dhe e zgjidhi litarin e tij.

Hyri gomari në kopshtin e komshiut dhe filloi të hante çdo gjë që gjente para vetes.

Kur e pa gruaja e pronarit të kopshtit gomarin dhe atë çfarë ai bënte, e mori pushkën dhe e mbyti gomarin.

E dëgjoi pronari i gomarit krismën e pushkës së komshiut. Kur iu afrua kopshtit, e pa gomarin e tij të mbytur. U hidhërua aq shumë, saqë nxori pistoletën e tij dhe e qëlloi për vdekje gruan e komshiut.

Në ato momente u kthye komshiu në shtëpi dhe e pa gruan e tij në frymëmarrjet e fundit, duke bërë me shenjë kah shtëpia e pronarit të gomarit... E mori pushkën dhe me të shpejtë shkoi në shtëpinë e pronarit të gomarit, të cilit i shkrepë disa plumba në gjoks.

Dëgjoi fisi i pronarit të gomarit krismat tek i afërmi i tyre dhe menjëherë i kapën armët. Në anën tjetër, komshiu vrapoi dhe e mobilizoi fisin e tij dhe filloi lufta mes këtyre dy fiseve, në të cilën



u mbytën më shumë se gjysma e pjesëtarëve të secilit fis...

U pyet shejtani: A nuk e sheh se çfarë bëre?

U përgjigj: Asgjë nuk bëra....Unë vetëm e lirova gomarin!!

Urtësia e tregimit: Nëse doni ta shkaktoni një vend, vetëm lironi gomarët e atij vendi.

Rijad ef. Imeri
(HeR ka të drejtën e botimit)



SI U SHEMB XHAMIA E ÇARSHISË NË TETOVË



Xhamia e Çarshisë në sheshin e qytetit, që ishte emblemë kryesore dhe qendrore për identifikimin e Tetovës si qytet, u shemb në fillim të qershorit të vitit 1965, për të mos u ndërtuar kurrë më. - Si shpëtoi nga rrënimi Xhamia e Sahatit?

Shkruan: Ismail Arslani

Shumë qytete në gjeografinë shqiptare, si Korça, Prizreni, Shkodra etj., e kanë ruajtur identitetin e tyre me objekte kulturore-historike e fetare, të cilat kanë mbetur trashëgim nga një kohë e kaluar dhe janë shndërruar në emblemë njohëse të tyre.

KU ËSHTË TETOVA NË KËTË RRAFSH?

Tetova e dikurshme, nga një qytet i rregulluar mirë, me të gjitha elementet arkitekturore qytetëruese dhe me mentalitetin qytetar të banorëve të saj, për disa dhjetëvjetësha u rrit në mënyrë kaotike dhe u shndërrua në një "fshat të madh" - me degradim të bukurive të trashëguara prej më herët, me vlerë historike-kulturore.

Ky qytet, kjo kasaba, i ka pasur këto attribute qytetëruese e orientale me të gjitha parametrat: kalaja, konakët e pashallarëve, xhamitë, hamamin, çezmat publike, parqet e gjelbra, rrugët me kalldrëm dhe, në përgjithësi, një arkitekturë të vjetër, me shumë vlerë, e cila u fashit nga sytë dhe kujtesa e shumë brezave të tetovarëve.

PËR XHAMINË QË S'ËSHTË MË

Brezi i tashëm jo vetëm që nuk arriti të ngrrej Tetovën ashtu si e meriton një qytet universitar, me pamje, arkitekturë dhe infrastrukturë të duhur, por deri më tash, ndër shumë vite, nuk arriti, madje, as ta mbrojë nga "kthetrat" e huaja, të cilat e katandisën qytetin në këtë gjendje.

Arkitektët e dinë mirëfilli që qytetet zgjerohen në periferi dhe e ruajnë identitetin, si dhe trashëgiminë kulturore-hi-



XHAMIA E ÇARSHISË NË TETOVË NË DITËN QË U RRËNUA, MË 5 QERSHOR 1965.

storike dhe arkitekturore, duke mos i prekur sheshet e vjetra dhe objektet me vlerë. Në Tetovë, ky zgjerim, përkundrazi, filloi pikërisht nga sheshi, duke u shembur nga një "dorë e fshehur" një kompleks ndërtesash me arkitekturë të së kaluarës, me shumë vlera kulturore-historike.

Në këtë kompleks ndërtesash me arkitekturë të vjetër, pos që kishte një park të gjelbër e të bukur, me shatërvan, në pjesën qendrore hidhte shtat një xhami, me minare të lartë e të bardhë, të cilën tetovarët e njihnin si Xhamia e Çarshisë apo e Tupanit, me pamje shumë të bukur arkitekturore, tejet funksionale, e cila, sipas ekspertëve, e kishte akustikën më të njohur në këtë lloj. Kjo xhami ishte vetë emblema e qytetit, boshti kryesor, që e mbante fuqishëm identitetin kombëtar e fetar të tetovarëve. Prania e kësaj xhamie i bënte krenarë të gjithë.

Mjerisht, me një vendim nga "lart", kjo xhami u shemb deri në themel brenda një dite (një të diel), para 55 vjetësh, në fillim të qershorit të vitit 1965, për të cilën gjë organet e sigurimit kishin shpal-

lur "orë policore".

Është interesant se të gjithë të angazhuarit joshqiptarë për të prishur xhaminë kategorikisht kishin refuzuar të merrnin pjesë në këtë krim mbi historinë dhe kulturën e një populli, prandaj hartuesit e këtij projekti kriminal e me prapavijë politike ishin detyruar të angazhonin njerëz nga burgju. Meqë Myftinia e Tetovës dhe askush nga Mexhlisi i saj nuk ishte përkulur që të japë çelësin e xhamisë, të burgosurit, të cilët nuk arritën të hynin brenda xhamisë, ishin detyruar që të fillojnë prishjen e saj prej kulmit, për çka dëshmojnë edhe disa foto të mbetura nga ai çast.

Tetovarët e morën këtë gjest të pushtetit me shumë dhembje, sepse atyre jo vetëm që iu mor xhamia, por edhe kujtesa për të. Reagimet e qytetarëve ishin ngufatur brenda qarqeve të ngushta, sepse reperkusionet do të ishin të pamëshirshme.

Rindërtimi i kësaj xhamie në sheshin kryesor të Tetovës paraqitet si imperativ i kohës. Ka pasur disa nisma do vite më parë për këtë punë, por projektet e har-

tuara kanë mbetur në sirtarët e administratës shtetërore. Rindërtimi i saj, me formën dhe pamjen autentike, si dhe me lokacionin e vet të dikurshëm, do t'u mbetet peng brezave të rinj, që janë e po bëhen akademikë e arkitektë. Duhet kërkuar edhe vullneti politik, qoftë kjo edhe me një mbështetje përmes një referendumit të popullatës, që të sendërtohet sa më parë - si një e drejtë universale, qytetare dhe fetare - rindërtimi i Xhamisë së Çarshisë.

XHAMIA E SAHATIT NË SYTË E PUSHTETARËVE

Njëra ndër xhamitë më të njohura në Tetovë - ajo e Sahatit, e vjetër prej disa shekujsh, gjatë viteve 70-të të shekullit të kaluar, në kulmin e egërsisë komuniste, ka qenë e rrezikuar që të rrënohet nga pushteti i atëhershëm, por në sajë të angazhimit të disa personaliteteve nga xhemati i Xhamisë, ajo i kishte shpëtuar rrënimin. Në këtë punë, për shpëtimin e Xhamisë nga rrënimi, ka dhënë një kontribut të madh edhe ish-imami i Xhamisë së Sahatit, Hafëz Sali Efendiu. Ai, derisa ishte gjallë, ndonëse në moshë të shtyrë, gjatë bisedës kujtohej për disa momente kyç nga ajo kohë e vështirë për xhematin e kësaj xhamie.

“Në vitin 1968, në prag të festës së Bajramit, në hovin e represionit komunist, dita kishte aguar me disa grafite në muret e Xhamisë së Sahatit, të cilat kishin përmbajtje propaganduese antifetare dhe kishin simbole të krishtera (kryq). Ndaj kësaj ngjarjeje të rëndë, me prapavijë provokuese dhe propaganduese, reaguam si komunitet mysliman, edhe pse regjimi i atëhershëm komunist kishte mbjellë frikë të popullata. Përkundër këtij reagimi, pushteti i atëhershëm komunist nuk ndërmoi masa konkrete për këtë provokim fetar, kështu që ne u detyruam që t'i ndërprisim për disa ditë ritualet tona fetare, përderisa nuk i hoqëm grafitet nga muret e Xhamisë”, ka rrëfyer ish-imami i kësaj xhamie, Sali Efendiu.

“Me këto veprime dëshirohej të na përcillej mesazhi se ky vend nuk na takon neve, se vendi i xhamisë nuk duhet të jetë aty, kështu që herët a vonë një ditë do të rrënohet, për t'u zëvendësuar me një objekt tjetër. Madje, kishte edhe disa arsye-time shumë banale: në majën e minares paska pasur një pjesë që simbolizua kishën katolike, ndërsa në lokalitetin ku është xhamia, më herët paska pasur një kishë (!). Kjo na habiti për tepër, sepse Xhamia e Sahatit ka një histori të gjatë prej disa shekujsh dhe ka fakte arkeologjike që dëshmojnë në favorin tonë”,

shprehej ish-imami i Xhamisë.

Ç'është e vërteta, presioni i pushtetit për rrënimin e kësaj xhamie, shumë afër sheshit të qytetit, kishte filluar në vitin 1974, kur ende nuk ishin shëruar plagët e popullatës myslimane për rrënimin e Xhamisë së Çarshisë (qershor 1965). Këshilli i xhematit të kësaj xhamie kishte marrë vendim për rinovimin e objektit, për shkak të vjetërsisë dhe depërtimit të lagështisë, që kishte për pasojë rrënimin gradual të mureve. Për këtë shkak, me rrugë zyrtare ishte kërkuar leje nga ana e Komunitetit të Tetovës për meremetimin e përgjithshëm të mureve të xhamisë, por autoritetet komunale nuk jepnin leje në formë të shkresës dhe lejonin në mënyrë verbale që të bënin disa meremtime të vogla, në mënyrë që të mos vështirësohej rruga për rrënimin e xhamisë që e kishin në plan.

“NË BEOGRAD, PËR TË SHPËTUAR XHAMINË”

Sipas Sali Efendiu, njërit nga dëshmitarët e asaj kohe, Komuna e Tetovës ka pasur në plan që në truallin e xhamisë të ndërtojë një objekt institucional për çështje sociale. Të shqetësuar nga një situatë e tillë e pasigurt për ekzistencën e kësaj xhamie në bërthamën e qytetit, Këshilli i Xhematit të Xhamisë kishte vendosur që të ndërmarrë disa masa konkrete për të parandaluar një veprim të tillë të pushtetit të atëhershëm dhe problemi të zgjidhej njëherë e përgjithmonë. Kishin vendosur që Hafëz Sali Efendiu, së bashku me tre anëtarë të xhematit - Murtezan Gegën, Bujamin Qylxhiu dhe Haxhi Nazifin të shkojnë në Beograd, që të ankohen te krejt më të lartë të shtetit të atëhershëm të Jugosllavisë, sipas mundësisë edhe te kryetari i shtetit, Tito, për ta shpëtuar nga prishja Xhaminë e Sahatit në Tetovë.

Në mungesë të mjeteve financiare për të angazhuar ndonjë avokat të njohur për ta shtyrë këtë çështje më tutje në Gjykatën Supreme, ishte angazhuar avokati Mirsad Kulenoviç, i cili i kishte prituar mjaft mirë në Beograd. Ai kishte premtuar që çështjen do ta përcjellë edhe deri te kryeministri i atëhershëm i Jugosllavisë, Xhemal Bijediq. Në atë takim ishin sqaruar shumë çështje që i brengosnin teovarët e fesë myslimane, mbi të gjitha për presionet që u bëheshin për prishjen e xhamisë. Ishte dhënë fjala që çështja do të shqyrtohet dhe raporti do t'u dërgohet organeve më të larta të, atëherë, Republikës Socialiste të Maqedonisë.

“Kishin kaluar disa muaj nga ai takim, por përgjigje nuk kishte. Andaj, vendosëm që të bëjmë një telefonatë në

Beograd, prej nga na thanë që kjo çështje është mbyllur dhe raporti me sugjerime ishte dërguar në institucionet përkatëse në Shkup, ku edhe mund të drejtohem. Menjëherë pas telefonatës shkua në Shkup, ku e kërkua shkresën e dërguar nga Beogradi”, ka rrëfyer për atë kohë ef. Saliu, për të shtuar se raporti vërtet ishte dërguar, por me qëllim apo pa qëllim nuk dërgohej në Tetovë.

Në atë shkresë nga Beogradi shkruante se Xhamia e Sahatit ka marrë leje për rinovim, ndërsa objekti merret nën mbrojtjen e shtetit, sikurse Xhamia e Pashës (e Larmer) në Tetovë. Kjo i kishte gëzuar shumë dhe këtë punë nuk mund ta ndalte më tutje as Shkupi e as Tetova. Atëherë ishte bërë rinovimi i nevojshëm, që po i reziston kohës deri në ditët e sotme.

Sali Efendiu i kujtohej një detaj nga ajo kohë: “Derisa shkonim duke trokitur nëpër shumë zyra të shtetit në Tetovë, Shkup apo Beograd, disa më thoshin që ta heq çallmën e imamatit nga koka, por kam qenë këmbëngulës dhe asnjëherë nuk e kam hequr, sepse për mua kjo ishte njësoj sikur të heq vetë kokën. M'u kujtua një hadith i Pejgamberit tonë (a. s.), i cili ka thënë: “Veprat vlerësohen sipas qëllimit (nietetit), andaj derisa njeriu e ka qëllimin e pastër, Allahu çdoherë është me të.”

Po të mos ishte ai angazhim i xhematit të Xhamisë së Sahatit, në krye me imamin e atëhershëm, Sali Efendiu, dyzet vjet e më parë, sot nuk do të ishte kjo xhami në Tetovë, vjetërsia e së cilës matet me disa shekuj. Sali Efendiu ka thënë se për historinë e Xhamisë së Sahatit ekzistojnë të dhëna të dokumentuara edhe nga ulemaja e kohës, Qemal Efendiu, i cili i kishte rrëfyer për të kaluarën e kësaj xhamie dhe fjalët e tij i kishte shënuar me kohë. Sipas të dhënave, Xhaminë e Sahatit e ka ndërtuar Abdulgani Muslihuiddini, i cili paska ndërtuar edhe Kurshumli Hanin në Shkup.

Ekziston edhe e dhëna se Xhamia e Sahatit është ndërtuar në vitin 1486 (sipas Hixhrit: në vitin 908) nga ana e Abdullislam Muslihuiddinit. Këto të dhëna janë marrë nga mbishkrimi i varrit që gjendet në oborrin e Xhamisë së Sahatit. Në këtë oborr gjenden edhe disa varreza të tjera, për të cilat nuk ka të dhëna të sakta. Vlen të përmendet varri i Dervish Huseinit dhe i gruas së Abdulgani Muslihuiddinit. Xhamia e Sahatit e merr emrin nga Kulla e Sahatit, e cila ka qenë përballë saj, në pjesën perëndimore. Afër Kullës së Sahatit ka pasur edhe një medrese, e cila është rrënuar në vitin 1926.

125-VJETORI I KONGRESIT TË PARË TË SHQIPTARËVE TË ITALISË

BASHKË PËR GJUHËN E ZEMRËS



Arbëreshët, pas mërgimit, e kishin kuptuar se mbijetesa e gjuhës, e zakoneve dhe e kulturës së tyre mund të arrihej vetëm nëse u dilnin zot pasurive shpirtërore e kulturore, se ndryshe do të asimiloheshin dhe do të zhdukeshin. Historia e diasporës arbëreshe dëshmon bindshëm se sa të qëndrueshëm dhe sa këmbëngulës kanë qenë dijetarët arbëreshë në përpjekjet e tyre për arsimimin e nipërve dhe mbesave të Skënderbeut.

Shkruan: Prof. Xhemi Hajredini (Enkas për HeR)

Më 1 tetor 1895, para 125 viteve, arbëreshët kanë organizuar në qytetin e Kozencës, Kalabri, Kongresin e Parë të Shqiptarëve të Italisë. Kur në asnjë vend të Evropës nuk flitej për një shtet shqiptar e një gjuhë shqipe, kur nga kuznetët serbë kundërmonte se gjoja Kancelari i parë gjerman, Bismarku, paskësh thënë se Shqipëria nuk është gjë tjetër përpos një shprehje gjeografike (e që, në fakt, ai kishte thënë se shqiptarët janë popull etnik evropian që ka hapësirën e vet, e cila duhet të ruhet e paprekur në kuadër të Perandorisë Otomane), intelektualët arbëreshë merrnin pjesë në tubime e konferenca ndërkombëtare si përfaqësues të Arbërisë. Sigurisht që një nga përfaqësuesit më të denjë të shqiptarisë ka qenë dhe do të mbetet përgjithmonë në kujtesën tonë “tatëmadhi i Arbrit”, Jeronim de Rada.

Gjatë një vizite që Presidenti i Shqipërisë, z. Bujar Nishani, bëri në disa komuna arbëreshe të Kalabrisë (prill 2015), ndër të tjera do të thotë: “Atëherë kur në Shqipëri qe e ndaluar të shkruhej e të flitej shqip, kur mërgimtarët nuk guxonin të shkruanin as edhe një letër në shqip për familjet e tyre, kur propaganda antishqiptare siguronte se shkrimi në gjuhën shqipe ishte i pamundur, pikërisht në një epokë të tillë, për të gjithë shqiptarët, e në veçanti për mërgimtarët, ishte një ngushëllim i madh dhe i thellë përgënjeshtrimi i shkëlqyer që u dhanë shpifjeve të tilla arbëreshët e Italisë me veprat, zakonet, simbolet, kostumet, këngët, mikpritjen dhe me traditat e tyre. Por, përveç kësaj, Shqipëria duhet t'u jetë përgjithmonë mirënjohëse këtyre bijve të saj të largët edhe për provën e mrekullueshme të dashurisë karshi racës së tyre që dhanë nëpërmjet përpjekjeve të mëdha për përpunimin e gjuhës. Qenë ata të parët që provuan se



shqipja është një gjuhë e thellë dhe e plotë, e ëmbël dhe e aftë për t'u dhënë formë edhe krijimeve më të epërme të imagjinatës poetike.”

Shtypi evropian i kohës evidentonte se një kulturë e lashtë arbërore po ripërtërihet dhe organizohet. Mbi 200 mijë shqiptarë të larguar nga trojet e tyre, të shpërndarë në të gjithë Italinë e jugut, po bashkoheshin për të mos harruar identitetin e tyre. Kongresi i Parë i Shqiptarëve të Italisë, që u zhvillua për tri ditë me radhë, nga data 1 deri më 3 tetor të vitit 1895, në ambientet e Gimnazit Garopoli Korilian Kalabro (Kozencë), do të trajtonte çështje mes gjuhës dhe historisë.

Njëzet e pesë delegatët e Kongresit dhe 500 intelektualët tjerë nga rajonet e Italisë së jugut (Kalabri, Kampania, Pulia dhe Sicili), që mbështetën këtë nismë, kanë lënë gjurmë të rëndësishme në ngjarjet gjuhësore dhe historike të kombit. Paramendoni: një nismë pas 400 vitesh pas shpërnguljes! Gjaku nuk bëhet ujë, pa marrë parasysh se është shprishur. Gjuha italiane, thonë arbëreshët, është gjuhë e bukjes, ndërsa arbërishtja (gjuha shqipe) është gjuhë e zemrës.

Arbëreshët, pas mërgimit, e kishin

kuptuar se mbijetesa e gjuhës, e zakoneve dhe e kulturës së tyre mund të arrihej vetëm nëse u dilnin zot pasurive shpirtërore e kulturore, se ndryshe do të asimiloheshin dhe do të zhdukeshin. Historia e diasporës arbëreshe dëshmon bindshëm se sa të qëndrueshëm dhe sa këmbëngulës kanë qenë dijetarët arbëreshë në përpjekjet e tyre për arsimimin e nipërve dhe mbesave të Skënderbeut.

Diaspora e moçme arbëreshe u integrua në mënyrë paqësore në Itali, por kurrë nuk braktisi gjuhën, kulturën dhe traditat e paraardhësve. Pas marrëveshjes për një kornizë-debati, Kongresi i Shqiptarëve të Italisë, i drejtuar nga Jeronim de Rada, më 2 tetor të vitit 1895 vendosi të themelojë Shoqatën Nazionale Shqiptare (Società Nazionale Albanese). Kryetar i kësaj shoqate u zgjodh arkimandriti Pietro Kaomdeka Koronei, zëvendëskryetar Anslemo Lorekio (jurist, gazetar) dhe sekretar u zgjodh Salvatore Liguori. Kjo shoqatë, sipas delegatëve të Kongresit, do të duhej të kujdesej për qëndrueshmërinë e vendimeve që do të merreshin në këtë kongres historik.

Katër ishin pikat kryesore ku u përqendrua Kongresi i Parë i Shqiptarëve të Italisë:

- unifikimi i alfabetit dhe hartimi i një



KOHA E VLERAVE TË MIRËFILLTA

'Pashë shumë njerëz që s'kishin tesha; pashë shumë tesha pa njerëz brenda.' (Rumi)

Nga Daim Iljazi

“Nipat veprat i gjykojnë”, ka thënë poeti Esad Mekuli. Sot jetojmë në një kohë të pakohë, në kohë të leshta, në një kohë kur vlerat janë të anashkaluara dhe të përmbysura.

Si duket, jemi te prirur të shtiremi, të sillemi sikur jemi të mpirë. Tani është koha kur duhet të nxjerrim në pah vlerat tona të mirëfillta - individë pa hipotekë, të ndershëm dhe profesionistë të lëmenjve të ndryshëm.

T'ua japim timonin atyre me përvojë, me guxim dhe ndërgjegje, që ta drejtojnë veturën dhe mos ta dëmtojnë. Jo shoferëve që ngasin veturën dhe shikojnë në retrovizor, ose që flasin në telefon mobil dhe më pas bëjnë karambol. Siç thotë në një ese i madhi Azem Shkreli: koha më e ligë është koha e mediokërve. Shfaqja e mediokërve bëhet shpejt, janë vërshues; pastaj edhe sundues. Ata janë në mënyrë latente të armiqësuar me hierarkinë e vlerave. Ata nxitohen të marrin në duart e veta pikat kyç të vlerësimit, të gjykimit e të vendosjes. Smira e mediokërve nuk duron të prishet rendi i sundimit të tyre. Ata shqetësohen seriozisht nga çdo e arritur pozitive apo sukses i tjetrit. Paafësinë, mosdijen dhe moskompetencën e tyre mediokërit përherë e kompensojnë me dëgjueshmëri shembullore dhe servilitet.

Fatkeqësia e mediokërve që i pjell koha, dhe ata që i kemi sot, është se ata kurrë nuk janë të zotë, të aftë e të kthjellët ta kuptojnë këtë fakt. Ata, bile, nuk kanë as ide dhe janë shterp. Në shtetet e civilizuar njerëzit me ide vlerësohen shumë dhe paguhen shumë. Fillet e ideve përherë nisjen e kanë nga individët.


Ta përkujtojmë arkitektin i ri Gustav Eiffel (Ajfel), i cili kishte një ide para një she-

kulli. Pra, në Paris të ndërtonte një kullë të lartë, mbi 300 metra, që do të ishte krenaria e Francës, ku do të vinin turistë nga shume vende të botës dhe Franca do të afirmohej gjithandej, qyteti do të kishte leverdi ekonomike, punësime etj. etj. Kjo ide individuale e tij u realizua më 1889 dhe u bë pronë e për-bashkët, simbol i parisienëve, trashëgimi kulturorë e Francës dhe Gustav Eiffeli e mori epitetin e patriot francez dhe u bë krenari kombëtare, pa e pasur për qëllim. Qyteti i Parisit sot fiton nga biletat e turistëve që hipin lart në Kullën e Ajfelit - nga 1 milion euro në ditë, 30 milionë euro në muaj.

Uroj që udhëheqësit tanë, qoftë në nivel lokal apo qendror, në çdo qytet e vendbanim, të na ndërtojnë infrastrukturë elementare për jetë e më pak të vjedhin. Nipat dhe mbesat t'ua dërgojnë nga një uratë, t'i mbajnë mend se në kohën e tyre është ndërtuar një shkollë, një pishinë, një bibliotekë, një fabrikë, një teatër, një muze arkeologjik - etnologjik, një teatër për fëmijë, një ambulancë, një kopsht për fëmijë, rrugë e trotuare të pastra, parqe me lule e gjelbërim...që t'i kemi si pronë të përbashkët e ti ruajmë si trashëgimi kulturore. Me këtë ambient modus vivendi me standarde bashkëkohore, qytetarët do të jenë të lumtur, sepse hyrja në BE është e kushtëzuar edhe me ndërtimin e infrastrukturës sikur ajo evropiane.

Do ta parafrazoj mendimin e poetit më të madh mistik të të gjitha kohëve, Rumi (Mevlana), i cili në një varg do të thotë: 'Pashë shumë njerëz që s'kishin tesha; pashë shumë tesha pa njerëz brenda.'

(Autori është Diplomati i Lartë në Ambasadën e RMV në Ankara, Turqi. Mendimet e paraqitura këtu janë krejtësisht personale, si poet dhe publicist)



abetareje të gjuhës shqipe;
- hartimi i një fjalori (u formua një grup pune prej 14 anëtarësh);
- botimi i një gazete italo-shqiptare; dhe
- hapja e marrëdhënieve me mëmëdheun (Shqipërinë).

Kongresi vendosi gjithashtu që selia e Shoqatës të jetë në katundin më të njohur arbëresh, në Shën Mitër (San Demetrio Corone), vendbanim i cili do të bëhej sinonim i atdheadashurisë dhe bartës i projekteve arsimore dhe kulturore arbëreshe.

Pas përfundimit të Kongresit, datë 3 tetor, pjesëmarrësit vërenin gjithandej kënaqësinë e të gjithë arbëreshëve kudo që jetonin. Më pas, drejtuesit e Shoqatës Nacionale Shqiptare nga Qeveria e Mbretit të asaj kohe kërkuan ngritjen e një katedre për mësimin e gjuhës shqipe pranë Institutit Oriental në Napoli. Kjo kërkesë ka qenë shumë e mençur, pasi që vetëm duke u shkolluar dhe duke studiuar në gjuhën shqipe, mund të realizoheshin edhe synimet e Kongresit dhe të Shoqatës.

Sot, pas 125 viteve të Kongresit të Parë të Shqiptarëve të Italisë, përballimi me një realitet pozitiv dhe një diasporë të organizuar, me imazh plotësisht evropian. Pothuajse gjithçka kishin synuar, e kanë realizuar. Rrugëtimi arbëresh ka shumëfishuar dijetarët, akademikët, hulumtimet, publikimet, shkollat, katedrat e gjuhës shqipe, manifestimet etj.

Është për çdo lëvdatë se si bashkohen arbëreshët pas mendjeve të shkolluara dhe grupeve intelektuale dhe vazhdimisht të mbajnë ndezur zjarrin e kulturës dhe qytetërimit, të pasionit dhe të krenarisë kombëtare. Arbëreshët e kishin kuptuar shumë herët se mbijetesa e shqiptarëve në Evropë do të rezistonte vetëm nëpërmjet shkollimit të gjeneratave të reja, të cilët do t'u dilnin zot trashëgimive shpirtërore dhe kulturore kombëtare.



MES PROFANES DHE INFRASTRUKTURËS SAKRALE

"Prandaj, mos i dilni Zotit kundër." (Kuran, Esh'Shura: 110)

Shkruan: Taxhudin Hamidi

Vendosmëri e lartë për themelimin e qytetit. Përkufizime, si tërësi e rregullave që përcaktojnë të drejtën dhe detyrën. Komunikativiteti në përdorimin e terminologjisë së Kuranit nuk duhet të funksionojë në distancë, apo me përparësi kompetitive të një botëkuptimi dhe dukurie.

Themelimi i qytetit pas tufanit në kodrën Xhudi, si platformë në kushtetutën e tij kishte falënderimin dhe durimin ndaj përcaktimeve të Zotit dhe jo të shkakto-rëve të ciklonit.

Konsiderata e shumë autorëve rreth gjetjes së subjektit të së drejtës dhe funksionimit të saj rrihet dhe analizohet në shumë dimensione të ndryshme:

- e drejta e popujve;
- e drejta e shteteve;
- e drejta ndërkombëtare; dhe
- e drejta e kapaciteteve kompetitive të rregullave fetare që ruajnë resurset njerëzore dhe natyrore dhe jo të atyre dogmatike, konservative dhe fanatike.

STANDARDE, PËR PAQE TË PËRHERSHME

Standardet sakrale njohin një stabilitet në bindje dhe besim, si dhe paqe të përherëshme në infrastrukturën administrative të zbatimit të legjislacionit.

Shumë juristë konfirmojnë se është dashur që e drejta të plotësojë disa kushte:
-të ketë arsye të drejtë;
-të ketë qëllim të drejtë dhe të fillohet në mënyrë të drejtë.

Njerëzimi gjatë historisë së tij është takuar me ciklone të ndryshme të luftërave pushtuese, shkatërrimtare, deri tek eksodi fizik, politik, ndërsa kohën e fundit, më trishtues, i quajturi ekonomik. Ky i fundit pas vetes le si pasojë çdo gjë shkruam.

Prandaj, librat e historisë botërore, të atyre shqiptare, që janë shkruar në mërgim



pa censurime të burokracisë shovene dhe menefregiste (- e 'smandisë'), njohin ndarjen midis luftërave të drejta dhe luftërave të padrejta.

Luftërat e drejta, sipas shumë definicioneve, janë ato që zhvillohen për mbrojtjen e interesave të njerëzimit dhe të paqes së përhershme duke iu falënderuar Zotit dhe duke bërë durim në rrugën e Tij. Kurse luftërat e padrejta janë luftërat pushtuese, të cilat instalojnë edhe histori edhe enciklopedi të censuruara, pastaj i detyrojnë punëtorët shkencorë të thirren në burimet e tyre jolegjitime.

Është bërë përpjekje që të justifikohen qëndrimet mes standardeve sakrale dhe intensivitetit homodupleks profan. Pa dyshim se intensiteti profan në mungesë të arsyes së drejtë, qëllimit të drejtë dhe fillimit të drejtë e humb betejën në çdo kënd të jetës politike, ekonomike dhe ndërkombëtare.

Intensiteti me presion profan gjatë gjithë kohës përipiqej të luftonte standardet sakrale të natyrës dhe të njerëzimit. Ai formësoi Zotin si një njeri, të cilin e quan antropomorfizëm. Dhe këtu cikloni profan humbi të gjitha instancat e proceseve të drejtësisë si pasojë e frustracioneve përballë infrastrukturës sakrale - teologjike. Kështu, mendja e njeriut pa falënderim (hamd) dhe durim (sabër) përfytyroi Zotin brenda dimensioneve të pasionit të vet, gjë që e çoi njeriun në idhujtari!

Ndërkaq, Islami në mënyrë kategorike e shmang njeriun nga idhujtaria, duke iniciuar, madje, edhe shpërthimin e ciklonit. Për këtë Islami e ka ndaluar portretin dhe statujën, me qëllim që ta pengojë formësimin e Zotit. Ngaqë, portreti dhe statuja e kufizojnë imagjinatën e njeriut.

Shkaku kryesor i këtij ndalimi është mbrojtja e njeriut nga konkretizimi i ideve abstrakte dhe rënia në perversitetin e adhurimit të tyre.

Në kohën e profetit Nuh (alejhisselam) ndodhi tufani, përmbytja e përgjithshme si pasojë e konkretizimit të abstraktes përmes idhujtari. Idhujtaria bëri dhe shkaktoi ndalimin dhe shkatërrimin e mendimit progresiv.

Gjithçka mund të tolerohet, por atëherë kur pengohet dhe stopohet mendimi progresiv i njerëzimit dhe kjo gjë bën që të ndizet alarmi, për të treguar se është shkelur kufiri, në atë moment pritët ndëshkimi nga Krijuesi i Gjithësisë.

Krijuesi i Gjithësisë e urdhëroi Nuhin që të ndërtojë gjeminë, si një paralajmërim nga përmbytjet. Infrastruktura profane e versionit të shkurtër detyrimisht inicioi shpërthimin e tufanit për të ndërtuar një qytet - shtet nga fillimi, që të realizohet jeta në suaza të mendimit progresiv dhe në paqe.

Themelimi i qytetit u strukturua nga tetëdhjete ithtarë të Nuhit (alejhisselam). Më në fund, Nuh, duke mos duruar

dot, u lut: "O Zot! U munda... Më ndihmo!"

(Kuran, Kamer: 10)

Kalimthi, një digresion rreth durimit të Nuhit: Durimi i Nuhit nuk ishte i periudhës së shkurtër, por durimi i tij, së bashku me mundimet, persekutimet, zgjati dhjetë shekuj.

Kështu, Nuhi është një shembull eklatant në trasimin e rrugës drejt realizimit të urdhrave të Zotit (xh. sh.).

Përmes kësaj lutje juristët vërejnë se hazreti Nuhi nuk e ka pasur aspak dert postin, pushtetin dhe pasurinë, por ai kishte dert të mos bëhet vazal i klientelizmit dhe i interesave të ndryshme kriminele, tirane dhe persekutuese që ushtronin ndaj infrastrukturës sakrale - teologjike.

Krijuesi i Gjithësisë e urdhëroi Nuhin të ndërtonte një gjemi dhe aty hipën të gjithë ithtarët e Nuhit që ishin kundër idhujtarisë.

NJË ERË E RE...

Pasi që ujërat u tërhoqën nga toka dhe nga qielli, gjemia zuri tokë në malin Xhudi. Nga ky moment filloi një erë e re për botën e civilizimit dhe të besimit drejt një Zot (monoteizëm).

Themelimi i qytetit u bë me tetëdhjetë besimtarë që i qëndruan besnik Nuhit dhe të cilët kishin hipur në gjeminë e shpëtimt.

Falë këtyre njerëzve që i besuan Nuhit u arrit themelimi i një qyteti ligjor, etik dhe të barabartë.

Zoti përmes tregimeve autentike të pejgamberëve i tregon njerëzimit se ka pasur njerëz falënderues ndaj Zotit dhe durimtarë në rrugën e Tij.

Pjesa më interesante dhe më emocionale në teorinë e këtij tregimi paraqet djalin e tij... Nuhi kishte dëshirë ta ketë në gjeminë e shpëtimt... Pas shumë përpjekjeve... Zoti e këshilloi dhe Nuhi e pranoi këshillën. Nuhi (alejhis-selam) u pajtua pa të birin e tij (sepse ai mohoi!).

Ky tregim kuranor i hazreti Nuhit sot tregon se qyteti - shteti nuk ndërtohet me njerëz që i do, me njerëz me të cilët komunikon në aspekte shoqërore, kolegjiale dhe të afiniteteve komerciale dhe utilitare të ngushtë, por qyteti ndërtohet me njerëz që dinë të krijojnë strukturën teorike të drejtësisë dhe dinë ta zbatojnë atë në praktikë, që do të thotë institucionet e qytetit-shtetit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të e kishin kushtëzuar njohjen e Shqipërisë nëse ruan të drejtën e fjalës dhe lirinë e shprehjes dhe mbajtjen në fuqi të trakteve ndërkombëtare...

MESAZHE NGA HIRA



Shkruan: Adnan Skenderi

Kur në Kuranin famëlartë, apo në hadithet e Pejgamberit (a. s.), hasim ndonjë histori apo ndonjë ngjarje, ajo si e tillë nuk paraqet vetëm ngjarjen e ndodhur, por ajo njëkohësisht para neve ka edhe mesazhet e saj, të cilat ne duhet t'i kuptojmë prej saj, ngase do të ishte e pakuptimtë që gjithë ato ngjarje të evidentuara në Kuran, apo gjithë ato histori të treguara në hadithet e Pejgamberit (a. s.), të ishin vetëm për të na treguar se çfarë ka ndodhur në të kaluarën dhe - asgjë më shumë.

Prandaj, çdo histori apo ngjarje e treguar ka brenda për brenda vetes edhe mesazhe, të cilat na japin zgjidhje dhe alternativa neve për probleme të caktuara. Kështu ka qenë edhe me ngjarjen e Hirasë, kur ka filluar t'i zbret Kurani famëlartë Pejgamberit (a. s.) nga ana e Allahut (xh. sh.) nëpërmjet Xhibrililit (a. s.).

Pejgamberi (a. s.) para se t'i vinte shpallja shkonte dhe strehohej në shpellën Hira, ku qëndronte me orë, me ditë apo edhe me javë dhe ku një ditë prej ditësh i erdh Xhibrili (a. s.) dhe ia dha fjalët e para:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi; krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur; lexo për Zotin tënd bujar, është ai që ua mësoi penën."

Këtu nuk do të synojmë të tregojmë aspektin historik të kësaj ndodhie, por do të mundohemi të analizojmë mënyrën se si Allahu (xh. sh.) e shpalli Kuranin famëlartë.

Nëse ndalemi të mendojmë se pse u desh që Pejgamberi (a. s.) të shkonte në shpellën Hira - ata që e kanë vizituar Mekën e dinë se në çfarë lartësie gjendet ajo dhe sa vështirë është ngjitja në të - dhe të thoshim: a thua, vallë, nuk mundte që ato fjalë, apo shpallja, t'i vinin/vinte duke qenë Pejgamberi (a. s.) në shtëpinë e tij, do të arrijmë të kuptojmë se një nga mesazhet e shumta të këtij gjesti nga ana e Allahut (xh. sh.) është që të tregojë se për të marrë dituri, duhet të vraposh pas saj, ta kërkosh atë, po qoftë edhe në vendet më të vështira për udhëtim në to. Kjo u dha mesazh edhe gjeneratave të vjetra, që për një hadith apo një këshillë, udhëtonin me qindra kilometra, edhe atë më këmbë, apo me deve, ngase e kishin kuptuar që vlera e dijes është aq e madhe, saqë për të ia vlen të udhëtohet po qoftë edhe me qindra kilometra.

Një mesazh tjetër që mund të kuptohet nga ndodhia e Hirasë është edhe ajo se Allahu (xh. sh.) e dërgoi shpalljen e tij me anë të Xhibrililit (a. s.), edhe pse fuqia e Allahut (xh. sh.) është e pafundme dhe atë kishte mundësi ta bënte me mënyra tjera, por Ai zgjodhi atë mënyrë që zgjodhi që t'i tregojë njerzimit se për të marrë dije të mirëfilltë dhe sa më të saktë në interpretim, ajo patjetër të merret nga mësues (që në këtë rast Xhibrili a. s. ishte mësuesi i Pejgamberit a. s.). Pra, mënyra autodidakte është e refuzuar në Islam, ngase njeriu e ka të pamundur që në mënyrë vetanake t'i interpretojë dhe të kuptojë drejt domethënien e atyre interpretimeve

që ai i mëson. Për ta kuptuar sa më drejtë dhe sa më saktë atë që ai lexon, e ka të nevojshme që atë ta marrë nga mësuesi i asaj dije përkatëse. Prandaj, edhe vetë Pejgamberi (a. s.) çdo vit e lexonte Kuranin famëlartë para Xhibrililit (a. s.), për të parë se mos ndoshta është lëshuar apo shtuar diçka nga Kurani, dhe këtë e kërkonte nga myslimanët e tjerë që ta bëjnë para tij, vetëm e vetëm që mos të ndryshohet diçka nga ajo që ka zbritur Allahu (xh. sh.) nga Kurani famëlartë, dhe kjo mënyrë e mësimt të fesë ka vazhduar edhe nga gjeneratat e mëvonshme, me ç'rast, për t'u bërë dijetar, që të tjerët të vijnë të marrin dije nga ai, e kishin të patjetërsueshme që dijen e tyre ta kishin marrë të lidhur me ndonjë dijetar, që dija e tij të lidhej apo të kishte zinxhirin dijetar pas dijetarit, deri te Pejgamberi (a. s.), kështu që historia islame nuk njih ende, sot e kësaj dite, dijetar që është bërë i tillë nga mënyra autodidakte, pa pasur lidhje me ndonjë nga dijetarët e asaj kohe kur ai ka jetuar.

Mosha në të cilën i erdhi shpallja Pejgamberit (a. s.) është një mesazh në vete, pra Pejgamberi (a. s.) ishte në moshën 40-vjeçare kur për herë të parë i erdhi shpallja nga ana e Allahut (xh. sh.), që tregon se për dijen, mosha është e parëndësishme dhe asnjëherë nuk mund të thuhet që nuk është koha për të marrë dije. Këtë na e urdhëron edhe vetë Pejgamberi (a. s.), ku në një hadith na thotë:

"Kërkoni diturinë nga djepi deri në varr."

Që nënkupton se, për të marrë dituri, nuk është me rëndësi mosha dhe se njeriu nga momentet e para të jetës së tij e deri në fund të saj ka nevojë për dije, ashtu siç na ka mësuar edhe Pejgamberi (a. s.): "Dituria është gjë e humbur për besimtarin; ku ta gjejë, le ta marrë atë."


Dituria është ushqimi i mendjes së njeriut, i cili kalon shumë dallgë dhe shumë sfida në jetën e vet, prandaj pa marrë parasysh moshën e tij, ai çdoherë ka nevojë që ta ushqejë shpirtin, ashtu siç ka nevojë që deri në fund ta ushqejë edhe trupin e vet.

Këto janë disa nga shumë mesazhet që Allahu (xh. sh.) na i jep nga mënyra e shpalljes së Kuranit famëlartë, por kjo mënyrë është përdorur në çdo ngjarje apo ndodhi që Allahu (xh. sh.) ka paraqitur në Kuran, apo Pejgamberi (a. s.) në hadithet e tij, por neve na ngel që t'i gjurmohet ato dhe të nxjerrim më të mirën e tyre me anë të leximit, të studimit, të hulumtimit dhe të interpretimit të tyre nga ana e dijetarëve islamë.

(Autori është hoxhë dhe magjistrant në Turqi)

LUMTURIA NË VEPRAT E TË URTËVE

Veprat e të urtëve gjithmonë kanë dëshmuar në shekuj se lumturia arrihet duke u shërbyer dhe të tjerëve, ashtu si procesi i fotosintezës që merr e që jep.



Shkruan: Mr. sc. Arbër Berisha (Enkas për HeR)

Lumturia nga shumë njerëz definohej si një mjet material. Por, realisht, kjo është një botëkuptim i gabuar. Besimtari vazhdimisht kërkon trinomin që Allahu t'i japë të mira në këtë botë dhe në tjetrën dhe ta ruajë nga ferri (zjarri).

Në klasë mësuesja pyeste nxënësit për çka duan të jenë në të ardhmen. Gjithsecili tregonte; dikush: mjek, dikush: mësues, inxhinier e kështu me radhë. Kur i erdhi radha artistit dhe këngëtarit me famë botërore John Lenon, ai u përgjigj: *I want to be happy what i do* ('dua të jem i lumtur me atë çfarë bëj').

Pra, esenca është se ti duhet të jesh i lumtur me atë profesion ose zanat që ushtron; përndryshe, mos iu qas fare. Siç na tregon Krijuesi i Gjithësisë: "Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri; pse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi." (Isra: 36)

Rumiu, ndërkaq, na tregon lumturinë duke u bërë mirësi për të tjerët, pra të bëhemi 'duke u bërë shërbëtor i bujarisë e lumturisë':

Bëhu si ujvarë në bujari dhe ndihmë!

Bëhu si diell në dhembshuri dhe mëshirë!

Bëhu si natë për t'i mbuluar të metat e të tjerëve!

Bëhu si i vdekur në nervozizëm dhe

zemërim!

Bëhu si dhë në thjeshtësi dhe përlulesi!

Bëhu si det në mirëkuptim!

Ose, duku siç je, ose bëhu siç dukesh!

(Mesnevia)

Shemsi Tabrizi ishte mësuesi shpirtëror i Rumiut dhe këta kolosë ishin në linjat shpirtërore ashtu si Atari dhe Gazaliu, por dhe në Perëndim Françesko d'Assisi, duke mos harruar dijetarët e urtë si Lukiani, Seneka, Marcus Aurelius, ku të gjithë këta ishin eruditë dhe njerëz me dhunti të rralla, që i dhuruan shumë dije botës dhe civilizimeve, duke mahnitur me modestinë e tyre dhe duke iu dhuruar njerëzve lumturinë si një oksigjen, deri në infinit.

Seneka i urtë thoshte: "Si vales bene est, ego valeo" /Nëse ti je mire, edhe unë jam mirë. Po ashtu, duke vazhduar, ai thoshte: Nëse është mire shpirti, do të jetë mirë edhe trupi.

Fahrudin Attari, i cili ishte nga Nishapuri i Persisë, poet i periudhës së selxhukëve në Mesjetë, trajtoi shumë arritjen e lumturisë në veprat e tij - ndër to edhe ajo 'Ligjërimi i zogjve' Manm. Ndryshe, si poet i alegorive me ritëm harmonie në

poemë parashtron oqeanin e dashurisë përmes alegorisë së zogjve, ku liria e tyre jep frymë udhëtimi drejt fenomeneve metafizike, duke përjetuar dashurinë e lumturisë si muzikalitetin e trupave qiellorë në harmoni dhe nënshtrim ndaj Krijuesit të Universit.

Ashtu dhe San Francesco d'Assisi thoshte me fjalët e tij brilante, duke sjellë dhembshurinë dhe dritën mes njerëzve: *Ku është urrejtja, unë do sjell dashurinë; Ku është ofendimi, që unë të sjell faljen, Ku është përçarja, që unë të sjell bashkimin, Ku është dyshimi, që unë të sjell besimin, Ku është gabimi, që unë të sjell vërtetën, Ku është dëshprimi, që unë të sjell shpresën, Ku është trishtimi, që unë të sjell gëzimin, Ku është errësira, që unë të sjell dritën.*

Po ashtu, i famshmi në veprën e tij tregon se me mirëqenie nënkuptohet vetëmse rregulli i duhur shpirtëror. Ai thotë se bota është ndryshim, jeta është mendim. Po ashtu, për arritjen e lumturisë Mark Aureli, si të urtët tjerë, thotë: *Duaje zanatin që ke mësuar, qetësohu tek ai dhe kaloje pjesën më të madhe që të ka mbe-*

tur nga jeta si dikush që ia beson hyut, me gjithë shpirt, çdo të mirë, pa u bërë shtypës apo rob i askujt.

Muhamedi (a. s.), i dërguari i Zotit, i ardhur si mëshirë për mbarë njerëzimin, thoshte: „Më i miri ndër ju është ai i cili është më i mirë për familjen e vet. Ndërkaq unë, në mesin tuaj jam më i miri për familjen time.“ Pastaj në një hadith tjetër: *“Pasha atë në duart e të cilit është jeta ime, nuk do të hyni në xhenet derisa të besoni dhe nuk do të besoni, derisa të duheni mes vete.”* (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Veprat e të urtëve gjithmonë kanë dëshmuar në shekuj se lumturia arrihet duke u shërbyer dhe të tjerëve, ashtu si procesi i fotosintezës që merr e që jep. Ashtu si tha Isai (a. s.), i biri i Mejremes së ndershme: *“Kemi ardhur në këtë botë t’u shërbejmë të tjerëve, sepse duke iu shërbyer të tjerëve i shërbejmë dhe vetvetes.”*

(Autori është Imam në vendlindjen e tij, në fshatin Dojan, Tropojë, Shqipëri; është ligjërues, historian, publicist dhe autor i dhjetëra librave)



NË SPIKAMË

DOBITË E MËSIMIT TË KURANIT

Të mos mjaftohemi duke thënë - Kurani fjalë e Zotit, por ta rregullojmë jetën me Kuran, t'i zgjidhim problemet familjare, problemet shoqërore, problemet ekonomike, problemet sociale vetëm se me Kuran, ngase ky është qëllimi i zbritjes së tij.

Shkruan: Musa ef. Biba

„Ata që e lexojnë librin e Allahut, që e falin namazin dhe nga begatitë që ne u kemi dhënë japin fshehtëzi e hap-tazi, ata mund të shpresojnë në një fitim që kurrë nuk humbet, të cilëve Ai (Allahu) do t'ua plotësojë shpërblimin dhe do t'ua shtojë nga mirësia e Vet. Vërtet, Ai është Mëkatfalës dhe shumë Mirënjohës.“ (Fatir: 29-30)

„Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj a ka ndonjë që do të marrë këshillë?!“ (Kamer: 17)

Pikësëpari, duhet të dimë se ndër gjitha të mirat që na ka dhuruar Zoti i plotfuqishëm, më e madhja e tyre është Kurani famëlartë. Të mos e vlerësosh këtë begati grandioze, me të vërtetë është një e metë e madhe. Sepse, mjeti kryesor që na forcon besimin në zemrat tona e që na zgjon ndjenjën e fesë është Kurani fa-

mëlartë.

Të lexuarit e Kuranit mund të jetë dy llojesh: lexim me kuptim dhe zbatim - e ky është pranimi i çdo gjëje që ndodhet në të; dhe kryerje e të gjitha obligimeve që urdhërohen. Kjo do të thotë të bësh atë që urdhërohet në Kuran, dhe të largohesh nga ajo që ndalohet në Kuran.

Lloji tjetër është leximi gjuhësor i ajeteve. Për dobitë dhe vlerën e këtij lloji deri te ne kanë arritur shumë hadithe - qoftë që kanë të bëjnë me leximin e Kuranit në tërësi, qoftë të sureve apo të ajeteve të veçanta.

Më së miri mbi vlerën e Kuranit na tregojnë hadithet e shumta të Muhamedit (a. s.), ku ndër ta thotë: „Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin, dhe ua mëson atë të tjerëve.“ (Buhariu) Pse, vallë, Pejgamberi (a. s.) e quajti personin më të mirë në mesin tonë atë që mëson Kuranin për vete dhe që ua mëson atë të tjerëve? Sepse, Pejgamberi (a. s.) e diti

më së miri nevojën e besimtarëve për Kuranin famëlartë. Sepse, është ai Kurani që na përtërin shpesh besimin tonë, e na mbron nga çdo dyshim që vjen rrotull nesh. Sepse, është Kurani ai që na e pastron zemrën tonë të ndryshkur nga gjynahet me të cilat ngarkohemi gjatë jetës sonë, të cilat ndikojnë në dobësimin e moralit tonë. Kurani është thesari i mje-teve për të shëruar çdo sëmundje morale e materiale, që d.m.th është bar shërues për të gjitha sëmundjet të cilat mund ta rrethojnë shpirtin tonë.

Nëse shikojmë sot, njerëzit janë me sëmundje të ndryshme shpirtërore, si: urrejtja, xhelozia, tradhtia, mosbesimi, nevrikosja, depresioni, lakmia për dynjanë... A thua, pse gjithë këto probleme shpirtërore nga më të ndryshmet? Sepse personat e tillë ende nuk e kanë kuptuar se ilaçi i vetëm shpirtëror është Kurani famëlartë.

Gjithashtu, Kurani na ndihmon dhe

na jep udhëzime nga më të ndryshmet edhe për këtë botë. Nëse duam që të pasurohemi në këtë jetë, Kurani është gati të na tregojë mënyrën se si mund të pasurohemi; nëse duam që të na ndriçojë në jetën tjetër, e cila është jeta e vërtetë, Kurani përsëri është gati të na udhëheqë në rrugën më të sigurt për t'ia arritur lehtësisht qëllimit, për të cilin jemi krijuar në këtë jetë. Vetëm se duhet të kuptohet mirëfilli, pra të na bëhet bar i këtyre sëmundjeve që thamë; ndryshe nuk mund të shihet ndonjë dobi prej tij.

Kurani aq sa na e rregullon jetën në këtë botë, po ashtu na rregullon jetën në botën tjetër. Nga Ibn Mesudi (r. a.) transmetohet se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: „Kush e lexon një harf-shkronjë nga Kurani, do të ketë shpërblim, kurse shpërblimi shtohet dhjetëfish. Unë nuk them që: Elif, Lam, Mim janë harf, por: Elif është harf, Lam është harf, Mim është harf.“

Gjithashtu, Pejgamberi (a. s.) na ka treguar mbi vlerën e Kuranit në botën tjetër, edhe atë: „Lexoni Kuranin, ngase ai vërtet në Ditën e Gjykimit do të vijë si shefatxhij - do të ndërmjetësojë për atë që e lexon.“

Prandaj, ne duhet të lexojmë, të dëgjojmë, të mësojmë më shumë Kuran. Por, mbi të gjitha, atë që e mësojmë, të mundohemi edhe me sinqeritet ta praktikojmë dhe në këtë formë do të arrijmë edhe me Kuran të jetojmë. Nëse ne nuk mundohemi pak ta kuptojmë brendinë e Kuranit ashtu si duhet, le ta dimë se u kemi dhënë shkak të tjerëve të thonë se të gjithë ata që veprojnë me këtë libër, janë të paditur, injorantë, bëhen dembelë, mund të manipulojmë me ta dhe janë popull shumë i prapambetur.

Kështu, duhet të dimë mirë se çfarë përmban ky libër. Në qoftë se nuk dimë, duhet të pyesim e të mësojmë nga ata që janë më të ditur dhe ta bëjmë Kuranin pjesë të jetës sonë. Të mos mjaftohemi duke thënë - Kurani fjalë e Zotit, por ta rregullojmë jetën me Kuran, t'i zgjidhim problemet familjare, problemet shoqërore, problemet ekonomike, problemet sociale vetëm se me Kuran, ngase ky është qëllimi i zbritjes së Kuranit: „Rregullimi i jetës në Tokë, në pajtueshmëri të plotë me Zotin.“ Vetëm atëherë do të jemi fitimtarë, triumfues, si në këtë botë, po ashtu edhe në botën tjetër, kur të dalim para Allahut (xh. sh.).

O Allah, na mundëso që edhe ne të jemi sikur Pejgamberi (a. s.) “Kuran i gjallë, që ec në tokë”... Amin.

XHAMIA QENDRORE NË PRISHTINË

POPULLI SHQIPTAR I KOSOVËS NË SHPIRT E KA BESIMIN NË ZOT



Xhamia pritet të ketë rreth 15 mijë metra katrorë, katër minare, bibliotekë, salla për takime dhe konferenca, lokale etj.

Shkruan: Mr. Ragmi Destani (Enkas për HeR)

Qysh moti kohë, e sidomos pas luftës së Kosovës, në Prishtinë ndihej nevoja e madhe për një xhami me hapësirë të mjaftueshme për frekuentuesit e shumë besimtarë për faljen e namazit, e sidomos të atyre të namazit të xhumasë dhe të Bajramit. Edhe sot e kësaj dite namazin e xhumasë, e sidomos namazin e Bajramit, një pjesë e madhe e besimtarëve e falin jashtë objektit të xhamive, ku ndodh shpesh që moti të jetë aspak i përshtatshëm për t'u falur jashtë xhamisë, por në mungesë të hapësirës ata detyrohen të falen edhe ashtu.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke e parë këtë gjendje, filloi ta diskutojë dhe planifikojë mundësinë e gjetjes së një zgjidhje për këtë gjendje, por mungesa e truallit apo një toke në emër të Bashkësisë Islame e bënte situatën edhe më të vështirë.

Duhet të fillohet nga zeroja, pra duhet të gjendet tokë për ta blerë e pastaj të ndërtohet xhamia, mirëpo në Prishtinë ishte shumë e vështirë të gjendet tokë e përshtatshme për t'u blerë, në atë madhësi sa duhej të ndërtohej xhamia. Andaj, duhej t'u drejtohet organeve komunale të Prishtinës, që ato të gjejnë një truall të cilin do t'ia falin Bashkësisë Islame dhe të ndërtohet xhamia e madhe e Prishtinës.

Në vitin 2012 kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës edhe zyrtarisht filloi takimet me organet e Komunës së Prishtinës për gjetjen e një lokacioni. Kryesia e BIK-ut kishte për synim një lokacion që ishte përballë katedrales dhe afër kishës ortodokse serbe - që të tria fetë në Kosovë

të kenë objektet kryesore afër njëra-tjetrës, mirëpo ky lokacion në asnjë mënyrë nuk u mundësua.

Komuna e Prishtinës me sa duket kishte presion të madh që të mos japë asnjë vend brenda në qytet për ndërtimin e xhamisë, por preferonte që një gjë e tillë mund të bëhet në periferi të Prishtinës, mirëpo insistimet e mëdha të Bashkësisë Islame nuk kishin të ndalur, me intencën që kjo gjithsesi duhet të bëhet brenda në qytet e në veçanti sa më afër qendrës së qytetit.

Pas takimeve të shumta, në mes insistimit të BIK-ut dhe presionit të madh për kundër xhamisë që kishte kryetari i atëhershëm i Prishtinës Isa Mustafa, u mundësua që vendi në lagjen Ulpiana afër Postës me 7.800 metra katrorë t'i jepet Bashkësisë Islame për ndërtimin e xhamisë.

Pas disa takimeve u zyrtarizua ky lokacion si pronë e Bashkësisë Islame dhe më 8 tetor 2012 u vendos që të vihet gur themeli i kësaj xhamie. Në këtë ceremoni të gur themelit morën pjesë të gjithë krejtë e shtetit të Kosovës, si dhe udhëheqësit e të gjitha institucioneve fetare në Kosovë dhe të rajonit.

Pas kësaj, kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës shpalli konkurs ndërkombëtar për projektin e xhamisë. Pasi që u paraqitën 81 projekte ideore nga vende të ndryshme të botës, vendin e parë e zuri projekti nga Turqia, pas së cilës pritej të fillonin punimet.

Problemet e para si pengesë për fillimin e punimeve filluan me planin e ndërtimit në komunën e Prishtinës, e të cilat zgjatën shumë, pastaj mënyra e financimit, ku Bashkësia Islame dhe qytetarët e

a kulturor.

Bindja ime e plotë është se natyra e pastër njerëzore – fitra - ashtu si është e krijuar, është rezistente ndaj të gjitha formave të agresioneve dhe presioneve që i bëhen nga veprimtaria njerëzore, duke përfshirë këtu edhe veprimtarinë agresive e terrorizuese mediale.

Natyrën e pastër e njeriut, e programuar për një krijesë që është e mandaturuar si mëkëmbëse e Zotit në Tokë, nuk mund të sfidohet nga aktiviteti i veprave të njeriut, sepse në atë rast do të sfidohej vepra e Krijuesit. Do të krijohej hamendja se mos ajo natyrë e pastër e njeriut është e krijuar me ndonjë defekt. E vërteta, ndërkaq, është se ajo natyrë është e krijuar pa asnjë të metë dhe është programuar që të jetë e aftë ta realizojë mandatin e mëkëmbësit të Zotit në Tokë.

Pra, natyrshmëria në të cilën njeriu është i krijuar (fitra) mbetet e pacenuar deri në fundin e kësaj bote, përveç nëse Krijuesi vendos ndryshe. Por, për të mbetur e pacenuar, për të mbetur plotësisht e pastër, natyra njerëzore ka nevojë që të furnizohet me përmbajtjen esenciale, për hir të së cilës është krijuar ashtu e përsosur, pra, ka nevojë për shpalljen (vajhin). Nëse, natyra e pastër e njeriut furnizohet me shpalljen, shpallja e bën fitrën dëshmuar, e cila e fuqizon njohjen e realitetit dhe të asaj që është paralajmëruar me anën e shpalljeve.

Duke e pasur aftësinë e njohjes së realitetit të programuar dhe aktive, *fitra* me anën e shpalljes fiton fuqi që të përballojë çdo lloj provokimi që i bëhet nga projektet e njeriut, po edhe nga provokimet e djallit - armikut të përhershëm të njeriut. Pra, nëse njeriu i ka në mendje e në zemër udhëzimet, urdhrat, mesazhet, aksiomat e Shpalljeve Hyjnore, ai është i aftë të dallojë të vërtetën nga e pavërteta, të mirën nga e keqja, të drejtën nga e shtrembëta. Ato mësimë nga Shpalljet shndërrohen në mendjen dhe në zemrën e tij si diga që e pengojnë infiltrimin ose kontrabandimin e përmbajtjeve të dylshimita, neveritëse, të shëmtuara.

Fjala vjen, mjafton që lexuesi ta mbajë në mend ajetin 6 të sures **El Huxhurat**, që ta ketë të qartë se nuk duhet të pranojë e as të bartë informata pa i verifikuar: **“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”**

Pra, kërkohet që besimtarët të jenë të aftësuar që të shqyrtojnë përmbajtjen e lajmeve, e rrjedhimisht të mos veprojnë

me lajme të rreme dhe të mos i përhapin ato. Nëse i përmbahemi këtij urdhri, minimalisht do të dimë të mbrohemi nga lajmet e rreme dhe të mos i përhapim ato.

Natyrisht, ka edhe shumë këshilla e urdhëresa të tjera hyjnore që i referohen mënyrës së komunikimit, të kumtimit e të sjelljes së mirë, të cilat e ndriçojnë me mësimë të duhura natyrën tonë njerëzore dhe na ndihmojnë ta realizojmë ashtu siç kërkohet prej nesh nga Zoti – në misionin tonë si njerëz në këtë jetë.

DISKUTIMI, NGA KOMPETENTËT

Meqë raportet ndërmjet njerëzve janë të përditshme, komplekse dhe vazhdimisht me oscilime e me probleme që shfaqen edhe papritmas, ato raporte kërkojnë që krahas mbajtjes së tyre në korvizën e *fitras*, të vlerësimin me anën e shpalljeve, të analizohen e të vlerësohen edhe me mënyra konkrete të mendimit e të vlerësimin. Kësodore, për vlerësimin e informatave dhe aspekteve të tjera të raporteve të ndryshme njerëzore e shoqërore duhet të përdoret *ixhmaja*, pra, diskutimi nga ana e njerëzve kompetentë. Nëpërmjet diskutimeve dhe analizave, informatat dhe faktet përimitohen dhe vlerësohen në mënyrë kritike. Meqë në këtë proces marrin pjesë më shumë njerëz, kjo rrethanë ixhmanë e bën prodhuese të diversitetit dhe pluralizmit të mendimeve. Nëse ka komunikim, konsultime, polemika e dialog, mundësia e vlerësimin të informatave dhe të ngjarjeve është shumë më e madhe sesa në rast se njeriu bën monolog. Kjo do të thotë se njëra nga mundësitë e vlerësimin të informatave ose saktësisë së tyre është që të ketë diskutime për ato produkte, nga instanca kompetente të vlerësimin, por edhe ndërgjegjësimit të secilit konsumues të tyre për vlefshmërinë e tyre.

Fjala vjen, në disa vende, si në SHBA, Britani të Madhe e në disa vende të Bashkimit Evropian, ka filluar një proces interesant i ofrimit të informatave të verifikuara, të filtruara, të sakta, përkundrejt një pagese të veçantë. Ironia është se kjo ofertë jepet nga media e cila për publikun e gjerë publikon informata të paverifikuara dhe të pasakta, ndërsa për ata që bëjnë pagesë shtesë, e ka ofertën e informacionit të verifikuar. Nuk e di se sa e si mund ta zëvendësojë ixhmaja këtë ofertë të medias komerciale për informacion të saktë, por mbetet të hulumtohen në këtë drejtim nga ana e ekspertëve.

Për të mos e pritur epilogun e pasigurt të kësaj mundësie, secilit individ i mbetet në dispozicion arsyetimi i vet

logjik, pra *ixhtihadi*. Ixhtihadi është proces mendimi i domosdoshëm, në çdo rast, sepse ixhtihadi është brenda kornizës themelore të fitras, natyrshmërisë, brenda së cilës njeriu është i krijuar. Nëse secili prej nesh ka vetërespektin e duhur dhe përgjegjësinë e duhur, në pajtim me obligimet me të cilat na kanë ngarkuar shpalljet hyjnore, atëherë në çdo rast të ballafaqimit me leximin ose konsumimin e informatave e përdorim arsyen, logjikën. Në atë rast, shumë lehtë mund të detektohen informacionet e pasakta, sepse ato në mënyrë të paevitueshme kanë brenda vetes elemente sensacionalizmi, manipulimi, propagande, lufte speciale, indoktrinimi, spini, reklame, promovimi të pamerituar. Arsyja na sinjalizon në këto pika, nëse mbështetemi në të dhe nëse ne nuk e tradhetojmë, për ndonjë arsye mendjelehtësie. Thënë thjesht, nëse e fusim ixhtihadin si program detektues në procesin e konsumimit dhe të vlerësimin të informatave dhe të ngjarjeve, mundësia që mediat me produktet e veta të na manipulojnë e të na mashtrjnë bëhet minimale.

Sa i përket *kiasit*, pra, ngjashmërisë, ajo në rastin e mediave dhe të produkteve të tyre praktikisht nuk mund të zbatohet fare. Pse? Sepse kjo mënyrë e prodhimit, plasimit dhe konsumimit të informatave ka qenë e panjohur në kohët e kaluara. Ky është fenomen i ri, tipik për periudhën postmoderniste. Sigurisht që mund të nxirren asociacione të ndryshme, nga rasti në rast, por jo që të bëhen masë e vlerësimin ose e veprimit në bazë të kiasit. Analogjia nuk ofron ndonjë ndihmë të madhe në këtë fushë, sepse vetëm sa e zgjeron hapësirën për manipulim.

Një gjë që duhet ta kemi parasysh në gjithë këtë histori të edukimit medial është problemi ynë me *talfikun*, pra, me pasionin për ta imituar në çdo gjë Perëndimin. Veçmas në rastin e mediave, kjo është një qasje e gabueshme, sepse vetë Perëndimi është nën presion dhe viktimitë e agresiviteti të medias. Nën firmën e liberalizmit, konceptit liberal, *“laissez faire”* dhe vetërregullimit të medias, Perëndimi u ka lënë mediave dorë të lirë, deri në atë masë sa ato janë shndërruar në fuqi sfiduese ndaj vetë shtetit e shoqërisë, bile edhe ndaj lirisë. Prandaj, *talfikun* duhet të frenohet, duke i dhënë shtysë më shumë rigjallërimit të etikës islame, si fuqi integruar dhe universale. Pra, universalizmit islam, e jo produkteve provinciale. Jo dijeve të tejkaluara.

SHQIPJA NË PROCESIN E GLOBALIZIMIT

Shqipja që flitet në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut aktualisht nuk është futur në grupin e gjuhëve të rrezikuara. Përrashtim bëjnë variantet arvanitase në Greqi, të cilat në “Librin e kuq të UNESCO-s për gjuhët e rrezikuara” janë futur në kategorinë e “gjuhëve pothuajse të shuara” dhe variantet e arbëreshëve të Italisë, të cilat konsiderohen si gjuhë të rrezikuara.

Shkruan: Asllan Hamiti (Enkas për HeR)

Globalizimi si term ka filluar të përdoret qysh nga viti 1944, mirëpo ekonomistët kanë filluar ta përdorin aty nga viti 1981. Disa autorë në vend të termit globalizim parapëlqejnë termin internacionalizim. Termi globalizim është përfutur nga emri glob-i, që ka kuptimin e parmë rruzulli i tokës, lëmshi tokësor, bota. Fjala global (si mbiemër) ka kuptimin: i përgjithshëm, që përfshin gjithçka, tërësor, i plotë. Pra, me globalizim mund të kuptojmë ndërlidhjen shoqërore, ndërvarësinë, integrimin, ndërveprimin, kontrollimin dhe koordinimin e të gjitha veprimtarive njerëzore në rruzullin tokësor, veçmas në nivelin ekonomik, kulturor, teknik e juridik. Thjesht, globalizimi nënkupton “një botë pa kufi”, që e çon botën drejt homogjenizimit, drejt një kulture të vetme globale, ku njerëzit në të katër anët e botës jetojnë, punojnë e mendojnë në mënyrë të ngjashme. Ka autorë që mendojnë se globalizimi është duke krijuar një përzierje midis asaj që është lokale (të posaçmes) dhe asaj që është globale (universale). Shtytjen kryesore dukurisë së globalizimit i dha zhvillimi i teknologjisë, sidomos zhvillimi i teknologjisë së komunikimit dhe informimit. Lëshimi në përdorim i Internetit në fillim të viteve ‘90 të shekullit XX bëri që bota ta ketë në dorë mjetin me të cilin njerëzit në të katër anët e botës ishin më afër se kurrë më parë me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, bota u bë një hapësirë e vetme për shkëmbime ekonomike, sociokulturore dhe gjuhësore.¹

Në literaturën shkencore janë dhënë



përkufizime të ndryshme për globalizimin si dukuri shumëdimensionale. Në enciklopedinë www.wikipedia.org globalizimi (ang. globalization) përkufizohet si: “Proces i transformimit të gjërave ose të dukurive lokale a rajonale në dukuri globale. Mund të përkufizohet edhe si proces, në bazë të të cilit popujt e botës janë identifikuar në një shoqëri të vetme dhe funksionojnë bashkërisht. Ky proces është kombinim i forcave ekonomike, teknologjike, sociokulturore e politike.”

Në <https://sq.wikipedia.org/wiki/Globalizimi> gjejmë këtë përkufizim për globalizimin: Globalizimi i referohet një dukurie shumëplanëshe ekonomike dhe shoqërore që nisi diku ne fillim te viteve

‘90-të. Termi u fut shpejt në fjalorin e përgjithshëm, duke treguar lidhjen gjithnjë e më të ngushte midis shteteve nëpërmjet tregtisë në rritje, investimeve, shkëmbimit të informacionit, turizmit, ndikimit kulturor nëpërmjet mediave etj. Globalizimi ka edhe ndikim politik mbi vendet të cilat janë në integrimet ekonomike kryesore në botë, siç janë: Bashkimi Evropian (BE), Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC) etj.

(Kryhet në numrin tjetër)

1. Shkumbin Munishi, Shqipja në epokën e globalizimit, Zeroprint, Prishtinë, 2015, fq. 17.

PLAGËT TONA DHE SHËRIMI I TYRE

Të metat që duheshin riparuar ishin: mungesa e altruizmit dhe e solidaritetit; mospasja vlerë e jetës së njeriut; të flakej ndjenja për grabitje dhe lakmi, si pasojë e varfërisë; të shërohej egoizmi, që ishte si pasojë e gjeografisë së vendit, por edhe mungesa e dëshirës për të punuar tokën; përtacia dhe harbutëria; lufta për të tjerët dhe jo për vetveten; të jetuarit me rrëmbim dhe jo me djersën e ballit; urrejta dhe mosbindja ndaj ligjit; ndjenja e theksuar për aventura; mungesa e solidaritetit ndaj vëllezërve më të dobët; mungesa e ndjenjës dhe virtutit për kombin; përçarja me njëri-tjetrin; indiferenca ndaj përparimit; rrëmbimi, inati dhe zemërimi i tepruar, në vend të durimit, punës së qetë e me vazhdim metodik...

**Nga Salajdin Salihu
(Enkas për Her)**

Mid'hat Frashëri (25 mars 1880 - 3 tetor 1949), alias Lumo Skendo, apo Mali Kokojka, ishte ministër i Punëve Botore në qeverinë e parë shqiptare të Ismail Qemalit, delegat i Stambollit dhe i "Vatrës" në Konferencën e Paqes në Paris, pjesëmarrës në Konferencën e Mukjes (1943), kur mes forcave politike shqiptare u arrit marrëveshje për mbrojtjen e atdheut, por nuk u respektua për shkak të ndërhyrjes së komunistëve jugosllavë.

Pas triumfit të komunistëve ai u arratis në Amerikë, ndërkaq krijimtaria e tij u ndalua nga regjimi i kohës. Në "indeksin e armiqve" figuronte edhe Faik Konica, i cili Mid'hatin e quajti si "njëri nga

më të diturit e brezit të ri" ("Parashtresa", 1899).

Mid'hat Frashëri i drejtoi revistat: "Kalendari Kombiar", "Lirija", "Dituria". Botoi librat: *Jetëshkrimi për Naim Frashërin* (monografi), *Hi dhe shpuzë* (novelë), *Pritmi i Shqipërisë* (studimin mbi shqiptarët dhe të ardhmen e tyre), *Plagët tona* (ese sociopolitike dhe etnike), kurse në gjuhën frënge botoi librat:



L'affaire de l'Épire (1915), *La population de l'Épire* (1915), *Les Albanais chez eux et à l'étranger* (1919), *Albanais et Slaves* (1919). Gjithashtu përktheu veprat: *Guillaume Tell* nga Lamartin (1898), *Bëje të mirën pa hidhe në det* nga Franc Hofman (1900), *Robinson Crusoe* nga Daniel Defo (1909), *Psikologjia e edukatës* nga Gystav le Bon (1923). Vdiq më 3 tetor të vitit 1949 në Nju-Jork.

"PËR ATA QË SHIKOJNË DHE DËGJOJNË"

Në librin me ese *Plagët tona* ai i evidenton shkaqet e të metave të shqiptarit dhe ligësinë e shoqërisë shqiptare të kohës. Ky libër, sipas autorit, nuk ishte shkruar "as për ata që ankohen dhe mendojnë se qarja shëron lëngatën", "as për ata që nuk mendojnë dhe as nuk shohin", por ishte shkruar "për ata që shikojnë dhe dëgjojnë, që duan të lodhen dhe të kuptojnë përgjegjësitë personale".

Te shkrimi "Këndonjësvet" thekson se shërimi i ligësisë mund të bëhej nëpërmjet njohjes së shkaqeve që e shkaktonin atë, kurse si burime të së keqes brenda qenies shqiptare veçonte: shmangien nga faji; mungesën e gatishmërisë së shqiptarit për të marrë përgjegjësi personale; dëshirën për ta shfrytëzuar një të tretë; mungesën e gatishmërisë për t'u mbështetur në fuqitë personale; mungesën e strategjisë për t'i shfrytëzuar pasuritë e vendit; përtacinë e theksuar etj.

Zhvillimi i një kombi dhe i një shoqërie, sipas tij, mund të arrihej me baraspeshën ndërmjet konditës materiale dhe morale: "Rrojta e një populli nuk varet vetëm nga kondita materiale, por edhe morale. Kërkon një fuqi mendjeje dhe shpirti, përparimi dhe qytetërimi, që mundësojnë pushtet material dhe mirëshkuarje fizike", kurse "shërimi i plagëve shqiptare bëhet me aktivitet material dhe moral".

Te "Plagët tona" ai flet për idealet që duhej t'i kishte bota shqiptare, sepse një shoqëri nuk rron dhe nuk ka dot përparim pa ideale. Pa një fuqi morale, pa një pikë drejt së cilës duhet të rendim së bashku, njerëzit dhe popujt vdirren, shuhen. Kur humbet ideali, trupi bëhet si kufomë: "I sëmurë që mbërthehet në shtrat, i burgosuri që dënohet të mos dalë jashtë odës, bien në mërzi dhe melankoli. Burgimi në vetvete është një nga më të mundimshmit. Njeriu duhet të ecë, të lodhet, të punojë, të flasë."

Secili popull, sipas Mid'hat Frashërit, i kishte idealet e tij. Anglezi kishte si ideal që të rronte mirë, të ishte i lirë dhe

ta sundonte botën. Ky ideal i jepte bashkim e forcë; i bashkonte shkrimtarët, gazetarët, politikanët, njerëzit e thjeshtë. Romakët e vjetër kishin si ideal zaptimin e botës, të ishin zotë dhe urdhërues të popujve të tjerë. Edhe popujt tjerë kishin idealet e tyre. Pra, të udhëhequr nga ideali, kombet synojnë "një të pritme të shkëlqyer", që mund të realizohet me punë dhe me bashkëpunim të përbashkët.

CILËT DUHEJ TË ISHIN IDEALET SHQIPTARE, SIPAS TIJ?

Duhej të ekzistonte ideali për lartësimin e nderit të shqiptarit; të krijoheshin ndjenja për njësi dhe bashkim të popullit; për lumturi dhe përparim të përgjithshëm. Shqiptari duhej të bindej se mund të bëhej faktor qytetërimi në Ballkan; ta bënte vendin tokë të lulëzuar; të ishte i pasur moralisht dhe ekonomikisht; ta përmendte kombin me nderim e lëvdatë; të kishte dëshirë për të zënë vend nderi në histori dhe në qytetari; të kishte letërsi, art dhe prosperitet lëndor; ta synonte lumturinë materiale; të kishte durim dhe metodë në punë; të mos binte në dëshpërim dhe zemërim; të krijonte ndjenjë vëllazërimi në përpjekjen për ta ngritur godinën e shëndoshë të madhërisë shqiptare.

"TË METAT TONA. TË VEPROJMË"

Frashëri foli edhe për të metat shqiptare në shkrimin "Të metat tona. Të veprojmë". Ai gjykonte se një prej të metave më të mëdha ishte mungesa e virtutit për t'i njohur të metat. Duke njohur të metat, pendohemi. Kur pendohemi, na zgjohet dëshira për ta ndrequr shtrembësinë. Sipas tij, populli dhe shoqëria shqiptare kishin plot faje të trashëguara nga stërgjyshërit, që nuk duhej t'ua trashëgonte brezave të ardhshëm. Të metat që duheshin riparuar ishin: mungesa e altruizmit dhe e solidaritetit; mospasja vlerë e jetës së njeriut ("Pushka kërcet vetvetiu. Ai që vdes në një ferrë nuk quhet fatkeq. Ai që vret nuk ndjehet i turpëruar, por mburret dhe hiqet krenar"); të flakej ndjenja për grabitje dhe lakmi, si pasojë e varfërisë; të shërohej egoizmi, që ishte si pasojë e gjeografisë së vendit, por edhe mungesa e dëshirës për të punuar tokën ("Shqiptari nuk ka pasur dëshirë të punojë tokën. Punën e ka shikuar si një turp, mëkat, mallkim, përbuzje"); përtacia dhe harbutëria; lufta për të tjerët dhe jo për vetveten; të jetuarit me rrëmbim dhe jo me djersën e ballit; urrejta dhe mosbindja ndaj ligjit; ndjenja e theksuar

për aventura; mungesa e solidaritetit ndaj vëllezërve më të dobët; mungesa e ndjenjës dhe virtutit për kombin; përçarja me njëri-tjetrin; indiferenca ndaj përparimit; rrëmbimi, inati dhe zemërimi i tepruar, në vend të durimit, punës së qetë e me vazhdim metodik.

Frashëri në shkrimin "Dedikuar të pasurve, djalërisë, intelektualvet" shkruan se në shmangien e këtyre të metave duhej të angazhoheshin të pasurit, rinia dhe intelektualët, sepse ishin shtresa më e përgjegjshme dhe kishin më shumë kohë për të menduar rreth interesit të përbashkët të Shqipërisë.

Populli, llauzi, plebeu, duke menduar vetëm për bukën, nuk e dinte se çfarë ishte dituria, prandaj kishte më pak përgjegjësi se ata që kishin më shumë kohë dhe nuk vuanin për kafshatën e bukës, sikurse shtresat e sipërpërmendura: "Ai që mund të shohë dhe ka kohë të mendohet, je ti, o djalëri e Shqipërisë, o intelektual, o i pasur, o i fisëm. Populli tek ti ka vënë besimin: ty vjen dhe të pyet kur ka një hall, tek ti qahet kur e gjen një e zezë; ty të ndihmon kur ke ti nevojë; ty të nderon kur vjen radha; ty të jep votën kur vijne zgjedhjet... A pandeh se do të mund të rrosh ti në qoftë se vdes kjo Shqipëri? A pandeh se do të mund të rrosh jashtë kësaj Shqipërie, pa një vend tëndin, pa një strehë, pa një vatër? Ahere, ç'bën ti për ta ndaluar rrezikun?"

Kjo shtresë nuk kish bërë dhe nuk bënte asgjë për të mjerët, që nuk kishin nevojë për lëmoshë, por të organizoheshin dhe të punonin me metodë e durim.

Mid'hat Frashëri mendonte se i pasuri duhej të sakrifikohej për të varfrin, i dituri për të paditurin, i lumturi për fatziun; ai që gëzon, për atë që vuan: "Ndihma s'është vetëm me të holla: është më tepër me punë, me akte, me vepra; është më mirë të marrësh një të sëmurë prej dore dhe ta shpiësh në spital, se sa t'i japësh dhjetë korona dhe ta lësh në rrugë. Është më të zësh për dore një djalë të varfër dhe ta shpiësh në shkollë, se sa t'i hedhësh një ovull; është më mirë t'i gjesësh një punë një lypsi dhe ta bësh të punojë, se sa t'i japësh një lëmoshë."

Ai kërkonte nisima personale dhe qytetare, sepse veprat solidare mund të bëheshin edhe pa ndihmën e qeverisë.

Mid'hat Frashëri, nëpërmjet librit *Plagët tona*, jo vetëm i detekton problemet dhe të metat e shoqërisë shqiptare, por ofron edhe zgjidhje. Shumica e këtyre problemeve dhe të metave vazhdojnë ta shoqërojnë botën shqiptare, prandaj ky libër duket aktual si në kohën kur u shkrua.

MID'HAT FRASHËRI SULJOTËT

Kam një javë këtu në Zafranboll, në këtë qytet të Anadollit, të humbur në gropë, të nxehtë dhe plot konupe tani në verë.

Lumtërisht kam fatnë të gjej një ndënjtje të mirë me një kopsht të bukur rreth e rrotull në këtë mëhallë të krishterë, që njerëzia – ngaqë të dy fetet s'piqenë dot – e shikojnë si një fshat veçan dhe e quajnë Keran-Qoj. Nga penxheret shoh dy vargje malesh të ndarë me një grykë, atë që kam përpara të zhveshur dhe gurishte, me anë të djathtë male të zez tërë drurë, pyje të thellë. Nga penxherja tjetër shoh majën e kishës Shënt Stefan, Aja Theodhora e moçme, e cila dhe mbase i ep emërin e qytetit (Theodhorian Polin – Zafranboll).

Kajmekami, miku im z. Kadri Përmeti, më tha që dje se do të vemi në shkollë greqisht të çupavet, të ndodhemi në provimet e tyre, dhe me gëzim e pranova fitimin e tij...

Në sallë të shkollës janë radhitur nja tridhjetë çupa, në rreshtat e para; prapa tyre janë djemtë, në mes të tyre disa gjashtë apo shtatë vjeç, po dhe dymbëdhjetë e trembëdhjetë. Provimet rrjedhin mi dhe shkronjë, gjuhë tyraqisht, frëngjisht, orthografi; nxënësit përsëriten përpara pllakës së zezë dhe kushdo prej të ftuarvet ka të drejtë të pyesë.

Unë po vë re. “Çupat që kam përpara janë të krehura mirë, të kujdesura, të veshura të gjitha me një mënyrë: rroba të bardha me kordhela të kaltërta: ngjyrat e Greqisë! Edhe më vjen keq për këto çupa, për këta djem dhe për mëmat e atërit e tyre që janë radhitur afrë murit, më të djathtë e më të mëngjër, më vjen keq për këtë njerëzi pa kombësi, pa gjuhë: flasin vetëm tyraqisht, janë thjesht anadollakë, s'di njeriu nga ç'kombësi janë, dhe duan të rrëfihen grekër! S'kanë as histori, as kujtime të moçme, as nonjë ndjenjë të tanishme, dhe duan të ngushëllohen me një shtet të vogël atje poshtë, me Greqinë e largët, se ashtu ua do feja, ashtu u ka thënë kisha dhe dhaskali. Edhe vërtet më vjen keq si për jetimë, si për djem pa mëmë, pa baba, pa shtëpi, dhe them: kur s'janë gjësend, dobare le të



thonë që janë grekër.

Po dal! Çupat tani më s'po pyeten, kanë zënë e kërcëjnë. Ç'është kjo valle, kjo këngë e njohur? “Lamtumirë o jetë e ëmbël”.... Suljotka!... “në gjuhë greqisht”.

Këng e Sulit! Këng e shqipëtarëve, këng e vendit tim edhe krahërori më fryhet, zemra më mallohet, më vjen dhe mua t'ia dredh një herë, a t'ia marr me to.

Këng e Sulit! Po shoh ato shqipëtarë trimëresha, ato gra zemër luane-she, vallen e tyre mi shkëmpt, varur mi rripët, një valle vdekjeje, një zë i qiellit dhe i varrit! Ushtarët e Ali Tepelenës po afrohen, po sulen, po gratë këndojnë, dridhen, të zëna prej dore, dhe ay vark më çdo grimë humbet nga një shpirt, edhe një nga një gratë lëshohen poshtë shkëmbit, hidhen në greminë, në skëterrë, në gojë të vdekjes që i kapërcen një nga një. Edhe vdesin me këngë në gojë, pa u dredhur zemra e tyre!

Më mirë vdekje e lirë se sa turp dhe robëri, na fjala e këtyre shqipëtarëve, e suljotkave me kujtim të pavidrshëm, që i apin një emër të përmotshëm kombit tonë, që trimëri e tyre do të inspirojnë gjithnjë poetët e gjithë kombevet! Suljotët, një grusht njerëz, që kanë mbushur me famën e tyre faqet më të shkëlqyera të historisë së tanishme, që kanë lënë kujtime trimërie të paharuar!

Edhe e ndjeva veten time fatore të jem nga kjo racë, nga ky popull, nga ky dhe, nga këta shkëmbinj që nxjerrin të tillë njerëz, të tilla gra. Edhe krahërori m'u fry edhe një herë duke dëgjuar këtë këngë, këta emra, duke parë këtë valle këtu në këtë qytet të Anadollit.

Po pse zemra ime përnjëherë më

ngushtohet dhe mejtime të hidhur më sulen në mendje? A është pse këta suljotë kanë derdhur gjakun e tyre kaq të famshëm për një çështje të huaj, për një komp që s'ish i tyre? – Jo, s'është ky mejtim që më hidhëron kështu, se e di, e kam ditur, dhe gjithë bota e di që dhe këta shqiptarë, si kaq të tjerë, si edhe Sinan Pasha, a Qypruliu, a Mehmed Aliu, kanë shërbyer një kauzë jo të tyren!

Ajo që më hidhëron është Suli i sotmë.

Ku je, o Sul? N'ato rripat e tua ata njerëz trima a e kanë akoma atë zemër trime, a e dinë që janë shqiptarë, që gjaku shqiptar rreh në rrembat dhe në zemrat e tyre?

Tre vjet po bëhen, kur qeshë në Shqipëri vajçë nga Llura në Llakë të Lelovës, në këtë copë të Sulit. Po sa një helm i madh më pritte: atje pashë një të keqe, një mëkat që s'rrëfhehet, atje pashë fshatra ku, jo shqipëtarëria, po dhe shqipja ka zënë të harrohet! Si tani po e shoh atë djalë mi mur të Papadhatës, kur m'u përgjigj greqisht fjalës shqipe. - Kush të tha që të mos dish shqip, or bir? – O dhaskalos, më tha djaloshi, pa ditur se ç'të vërtetë të helmshime po thosh!

Ah, jo! E kuptoj që këta anadollakë të gjoërë, këta jetimë të varfër të thonë se janë grekër. Po ne, ne shqiptarët, me kujtime, me histori të shkëlqyer, me fytyra dhe emër të ndershëm, ne të themi se jemi grekër, këtë s'ma pret dot mendja!

Edhe nuk di, në duhet të kem një cmir të vdekshim për atë “o dhaskalos”, apo në duhet të më vijë keq për atë djalosh edhe për prindët e tij?

(Zafranboll, 30 qershor 1912)

LIBRA TË RINJ

“MUHAXHIRËT, DOSJA BRITANIKE” NGA BEJTULLA DESTANI


Studiuesi **Bejtulla Destani** kësaj here vjen me botimin më të ri “**Muhaxhirët, dosja britanike**”. Spastrimi etnik i Toplicës, i Nishit, Prokuplës, Kurshumlisë, Leskovcit, Vranjës pas Luftës së Krimës, ishte objektivi i Serbisë dhe i politikave shtetërore serbe për shpërnguljen e popullatës shqiptare dhe myslimane nga Serbia qendrore dhe jugore. Autori na jep një pasqyrë të shpërnguljeve në rrethinën e Nishit, të Sanxhakut, të Kurshumlisë dhe të vendbanimeve ku shqiptarët historikisht kishin banuar në hapësirën e dikurshme të Perandorisë Osmane, e cila tokë tashmë kalonte nën juridiksionin e Serbisë. Dobësimi i Perandorisë Osmane solli disa marrëveshje mes Turqisë dhe Rusisë dhe gjendja e re ndërkombëtare shkoi në favor të Serbisë, për të fituar pavarësinë nga Porta e Lartë.

Me pavarësinë nga Perandoria Osmane, shteti serb filloi spastrimin etnik - politikë e cila filloi të kundërshtohet nga Austro-Hungaria. Libri i Destanit fillon me gjendjen e shqiptarëve në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe vendbanimet e tyre në Serbi, duke filluar nga fshatrat e Sanxhakut të Nishit. Pjesa dërrmuese e familjeve shqiptare që u detyruan të shpërnguleshin ishin nga *Qarku i Toplicës*, që përfshinte rrethin e Jabllanicës, Kosanicës, Prokuplës dhe qytetin e Prokuplës; *Qarkun e Nishit*, që përfshinte rrethet e Vllasotincës, Leskovcit, Nishit dhe qytetin e Nishit; *Qarkun e Vranjës* me rrethin e Masuricës, Polani-

cës, Pçinjit dhe qytetin e Vranjës dhe *Qarkun e Nishavës*.

Banorë shqiptarë kishte edhe në vende të tjera, sidomos në qytetet si: Qupri, Paraçin, Uzhiçë, Krushec, Aleksinc, Kralevë, por edhe në Beograd. Sipas statistikave osmane, në Sanxhakun e Nishit jetonin rreth 240.000 banorë shqiptarë të shpërndarë në mbi 700 vendbanime, por të përzier edhe me popullatë ku jetonin edhe popuj të tjerë. Që nga viti 1833, kur Serbia kishte fituar autonomi nga Perandoria Osmane, kishin filluar planet për pushtimin e tokave shqiptare. “Naçertanija” e Ilija Garashaninit ishte një platformë dhe program për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e veta. Ky program u konstruktua në vitin 1844, ndërkohë që nisi të realizohet gjatë dhjetorit të vitit 1877 dhe janarit të 1878-tës, duke vazhduar më vonë, në vitin 1912. Pas 16 dhjetorit të vitit 1877, ushtria serbe do ta fillonte fushatën kundër popullsisë së pambrojtur shqiptare të Sanxhakut të Nishit. Divizionet serbe të Danubit dhe Moravës sulmojnë popullsinë civile, duke vrarë e masakruar pleq, gra, fëmijë. Serbia në këtë luftë ushtroi një spastrim masiv të popullsisë shqiptare, ku në këtë krim u mbështet edhe nga forcat ruse.

Autori Destani na sjell dokumente origjinale të kohës dhe libri ka disa faqe dokumentesh të kohës që zbërthejnë politikat serbe të gjenocidit, ku me dhjetëra mijëra shqiptarë të moshave të ndryshme



vriten nga forcat serbe. Nëpër lumenjtë Moravë, Nishavë, sipas botimit, notonin me qindra kufoma shqiptare të hedhura nga forcat ushtarake. Nga vrasjet e shumta u hapën varre masive - që nga Nishi e deri në Kurshumli. *Princi serb Millan Obrenoviq, për të arritur këtë qëllim, ushtarëve të vet serbë u kishte shpërndarë proklamata në të cilën thuhej: “... sa më pak shqiptarë që të mbetën në teritorit e çliruara nga Turqia, aq më shumë do të kontribuoni për shtetin. Sa më shumë shqiptarë të shpërngulur, aq më të mëdha meritat për atdhe.”*

Libri, me nëntitullin e dytë: Spastrimi etnik i Toplicës, Nishit, Kurshumlisë, Leskovcit, Vranjës 1878-1884, është botuar në vitin 2019 nga “Artini”, Prishtinë, dhe ka gjithsej 620 faqe - gjysma me dokumente të vlefshme për historianët dhe studiuesit.

Selim Ibrahim (nergut për HeR)

PYETJE-PËRGJIGJE

LOJA NËPËR BASTORE

Pyetje: Ju lutem, një përgjigje: cili është qëndrimi i fesë islame për bastoret sportive?

Përgjigje: Lojërat nëpër bastoret sportive sipas jurisprudencës islame konsiderohen lojëra të fatit, të cilat sipas Islamit janë të ndaluara dhe të cilësuar si lojëra të djallit, kurse pasuria e fituar nga këto lojëra konsiderohet **haram** dhe për të do të ketë përgjegjësi para Allahut (xh. sh.). Allahu (xh. sh.) ka thënë në Kuran: “O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar.” (El-Maide: 90)

Mendojmë se imperativi nga ky ajet është shumë i qartë për të gjithë lexuesit, e këtë çdo ditë e më shumë po e dëshmon praktika e çrregullimeve dhe e devijimeve të shumta që po krijojnë lojërat e fatit në shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe atë islame në veçanti.

Prej numrit të tetorit, 2020, revista “Hëna e Re” hap rubrikën “Pyetje-përgjigje”. Pyesin lexuesit, përgjigjet studiuesi i njohur, **prof. Jusuf Zimeri**. Pyetjet i dërgoni në këtë adresë: henaerebfi20@gmail.com. Ato botohen ekskluzivisht sipas kërkesave të lexuesve, duke ruajtur në maksimum amanetin e tyre. Ju na shkruani, ne ju përgjigjemi.



BËJMË BARTJEN E KUFOMAVE:

- Prej të gjitha spitaleve dhe shtëpive të shëndetit në tërë territorin e vendit,
- Prej aeroportit të Shkupit,
- Prej aeroportit të Prishtinës
- Prej aeroportit të Tiranës
- Prej portit detar të Durrësit
- Prej një vendi të caktuar (shtëpia e pleqve, burgje, banja, etj.)

Jemi në shërbim për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë 24/7.
Mund t`na kërkonit në telefonat vijues:

Adresa: Bashkësia Fetare Islame në RM,
rr. Çairska, nr.52, Shkup.

i-meil: er.rahatu.bfi@gmail.com

Tel: ++ 389 2 3117 410; ++ 389 2 3117 412

Mob: ++ 389 75 374 402; ++ 389 75 374 411



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.